

KOALICIONI PËR KOMRA

SQARIME

**LIDHUR ME STATUTIN E KOMISIONIT RAJONAL PËR
PËRCAKTIMIN E FAKTEVE MBI KRIMET E LUFTËS DHE
SHKELJEVE TË RËNDA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË
TERRITORIN E JUGOSLLAVISË SË DIKURSHME**

DRAFT

09 mars 2011

Përmbajtja

PJESA I – DOMETHËNIA E NOCIONEVE NË KËTË STATUT

Neni 1 - Kuptimi i shprehjeve (nocioneve) në këtë Statut

PJESA II – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 2 - Definicioni

Neni 3 - Simbolet

Neni 4 – Selia dhe Sekretariati Ekzekutiv

Neni 5 – Statusi juridik

Neni 6 – Periudha e veprimit

Neni 7 – Përfaqësimi dhe prezantimi (paraqitja)

Neni 9 – E drejta për pjesëmarrje në punën e Komisionit

Neni 10 – Parimet e veprimtarisë së Komisionit

PJESA III – Obligimi për bashkëpunim me Komisionin

Neni 11 – Obligimi i palëve kontraktuese për bashkëpunim me Komisionin

Neni 12 – Bashkëpunimi i Komisionit me shtetet tjera dhe me organizatat ndërkombëtare

PJESA IV. – Qëllimet dhe detyrat e Komisionit

Neni 13 - Qëllimet

Neni 14 - Detyrat

PJESA V – Kompetencat e Komisionit

Neni 15 - Periudha dhe territori i hulumtimit

Neni 16 – Shkelja e të drejtave në kompetencën e Komisionit

PJESA VI – Kompetencat e Komisionit

Neni 17 – Marrja e deklaratave

Neni 18 – Grumbullimi i dokumentacionit dhe burimeve tjera

Neni 19 – Hulumtimet dhe vizitat në terren

Neni 20 – Dëgjimet publike të viktimave dhe personave të tjerë

Neni 21 – Mbajtja e sesioneve tematike

Neni 22 – Rregulloret e Komisionit

PJESA VII – Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

Neni 23– Përbërja e Komisionit

Neni 24– Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

Neni 25 – Njëjtësia e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

Neni 26 – Kandidimi i anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

Neni 27 – Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit seleksionues

Neni 28 – Zgjedhja e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim në Komision nga ana e Panelit zgjedhor

Neni 29 - Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit nga ana e kryetarit/kryesisë së palëve kontraktuese

Neni 30 – Mbledhja konstitutive

Neni 31 – Zgjedhja e kryesuesit/kryesueses dhe miratimi i Rregullores

Neni 32 – Kuorumi dhe vendimmarrja

Neni 33 – Pushimi i mandatit të anëtarit/anëtares së Komisionit

Neni 34 – Largimi i përkohshëm nga detyra e anëtarit/anëtares të Komisionit

PJESA VIII – Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve/anëtareve dhe personelit të Komisionit

Neni 35 – Ndërgjegjja, pavarësia dhe paanshmëria

Neni 36 – Privilegjet dhe imuniteti

Neni 37 – Mbrojtja e burimeve të të dhënave konfidenciale

Neni 38 - Statusi i anëtarëve/anëtareve dhe personelit të Komisionit

PJESA IX – Struktura e Komisionit

Neni 39 – Sekretariati ekzekutiv dhe departamentet tematike

Neni 40 – Zyrat e Komisionit në palët kontraktuese

Neni 41 – Arkivi

PJESA X – Financimi i Komisionit

Neni 42 – Financimi

Neni 43 – Raportimi financiar

PJESA XI – Raporti përfundimtar i Komisionit

Neni 44 – Hartimi dhe publikimi i Raportit përfundimtarë

Neni 45 – Përmbajtja e Raportit përfundimtarë

Neni 46 – Gjetjet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtës njerëzore

Neni 47 – Obligimet e parlamenteve dhe qeverive për shqyrtimin e Raportit përfundimtarë

PJESA XII – Të ndryshme

Neni 48– Dispozitat ndëshkuese (Dënimet)

Neni 49 – Roli i Komisionit në procedimin penal

PJESA XIII – Dispozitat përfundimtare

Neni 50 – Përfundimi i punës së Komisionit

Aktet themeluese të komisioneve tjera për të vërtetën , të cituara në Sqarimet

- Gana** - *The National Reconciliation Commission Act, 2002* (Ligji për Komisionin nacional për pajtim)
- Gvatemala** - *Agreement on the establishment of the Commission to clarify past human rights violations and acts of violence that have caused the Guatemalan population to suffer* (Marrëveshja për themelimin e Komisionit për sqarimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe dhunës në të kaluarën, që ka shkaktuar vuajtje për banorët e Guatemalës), 23. qershor 1994.
- Timori Lindorë** - *UNTAET Regulation No. 2001/10 on the Establishment of a Commission for Reception, Truth and Reconciliation in East Timor* (Urdhëresa e UNTAET-s, nr. 2001/10, për themelimin e Komisionit për pranimin, të vërtetën dhe pajtimin në Timorin Lindorë), 13. korrik 2001.
- Afrika e Jugut** - *Promotion of National Unity and Reconciliation Act 1995* [Act 95-34] (Ligji për unitetin nacional dhe pajtimin), 26. korrik 1995.
- Kanada** - *Schedule "N", Mandate for the Truth and Reconciliation Commission* (Aneksi "N": Mandati i Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin), 8. maj 2006.
- Kenia** - *The Truth, Justice and Reconciliation Commission Bill, 2008* (Ligji për themelimin e Komisionit për të vërtetën, drejtësinë dhe pajtimin, 2008)
- Liberia** - *An Act to Establish the Truth and Reconciliation Commission (TRC) of Liberia* (Ligji për themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në Liberi), 12. maj 2005.
- Maroku** - *Dahir n° 1.04.42 Du 19 safar 1425 (10 avril 2004) Portant approbation des Statuts de L'Instance Equité et Réconciliation* (Dahir nr. 1.04.42, dt.19. Safara 1425 (10. prill 2004.) me të cilin vërtetohet Statuti i Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin)
- Mauriciusi** - *The Truth and Justice Commission Act 2008* (Ligji për Komisionin për të vërtetën dhe drejtësinë, 2008), 22. gusht 2008.
- Paraguai** - *Ley Nº 2225 Por La Cual se Crea La Comision de Verdad y Justicia* (Ligji për themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin nr. 2225), 16. tetor 2003.
- Peru** - *Decreto Supremo N° 065-2001-PCM* (Dekreti suprem nr. 065-2001 - PCM), 2. qershor 2001.
- Sijera Leone** - *The Truth and Reconciliation Commission Act 2000* (Ligji për themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin 2000.)
- Ujdhesat Solomone** - *Truth and Reconciliation Commission Act 2008* (No. 5 of 2008)(Ligji për themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin 2008. (nr. 5-2008))

PJESA I. – KUPTIMI I SHPREHJEVE NË KËTË STATUT

Neni 1

Kuptimi i shprehjeve (nocioneve) në këtë Statut

Sqarim

Luftëtarët

Luftëtarët (anglisht: combatants, e kur është fjala për pjesëtarët e forcave rebele në konfliktin e armatosur të brendshëm – fighters janë personat të cilët nuk e gëzojnë mbrojtjen nga sulmi, siç e gëzojnë civilët.¹

Në kontekstin ndërkombëtarë të konfliktit të armatosur, si luftëtarë vlerësohen pjesëtarët e forcave të armatosura të palëve në konflikt.² Megjithatë, siç theksohet në përkufizimin civil në Protokollin I Shtesë (neni 50), përpos pjesëtarëve të forcave të armatosura ekzistojnë edhe kategori tjera të cilat nuk janë civilë. Të gjitha ato kategori, së bashku me pjesëtarët e forcave të armatosura në konflikt, paraqesin luftëtarët në konfliktin e armatosur ndërkombëtarë.³ Këtu bëjnë pjesë:

- „pjesëtarët e policive tjera dhe pjesëtarët e njëjësive tjera vullnetare,, duke nënkuptuar këtu edhe pjesëtarët e rezistencës së organizuar” me kusht që ato polici apo njësi vullnetare ti plotësojnë kushtet si në vijim:

- a) që në udhëheqje ta kenë personin i cili është përgjegjës për vartësit e tij;
- b) ta kenë një shenjë dalluese, dhe e cila mund të vërehet nga distanca;;
- c) që haptazi ti mbajnë armët;
- d) që të kryejnë operacionet e tyre në pajtim me ligjet dhe zakonet e luftës”;

- “pjesëtarët e formacioneve të rregullta të armatosura të cilët deklarojnë se i përkasin njëres qeveri apo pushteti, të cilin nuk e ka pranuar Forca, nën qeverisjen e të cilës gjenden”;

- “popullata e territorit të paokupuar të cilët, në rastin e afrimit të armikut, vullnetarisht marrin armët që të ofrojnë rezistencë ndaj sulmit të armikut, e të cilët nuk kanë pasë kohë që të organizohen si forcë e rregullt e armatosur, nëse ata haptazi i mbajnë armët dhe nëse i respektojnë ligjet dhe zakonet e luftës ”⁴

¹ International Committee of the Red Cross (ICRC), *Study on customary international humanitarian law* (2005), pravilo 3 (*Definition of Combatants*).

² Protokollin Shtesë I, nën Konventën e Gjenevës (1977), neni 43, paragrafi 2 (“Pjestarët e forcave të armatosura të palëve në konflikt (përpos personelit mjekësorë dhe priftërinjëve, të përfshirë në nenin 33, konventa III) janë luftëtarët...”).

³ ICRC, *Study on customary international humanitarian law* (2005), poglavlje 33, pravilo 106 (*Conditions for Prisoner-of-War Status*).

⁴ Protokollin Shtesë I, nën Konventën e Gjenevës (1977), neni 50, paragrafi 1, (duke udhëzuar në Konventën e tretë të Gjenevës, neni 4, A(2), dhe (6)).

Si luftëtarë, në konfliktet jo ndërkombëtarë, padyshim vlerësohen pjesëtarët e forcave të armatosura të shtetit.⁵ Përpos tyre, në radhët e luftëtarëve vlerësohen edhe “pjesëtarët e forcave të armatosura disidente dhe të grupeve tjera të armatosura të organizuara, të cilat nën komandën përgjegjëse, bëjnë kontrollin ndaj një pjese të territorit, gjë që u mundëson të zhvillojnë operacione ushtarake sporadike dhe të përbashkëta [Protokolli II].”⁶

Nga të paraqiturat më lartë, rrjedhë se, si në konfliktin e armatosur ndërkombëtarë ashtu edhe në atë jondërkombëtarë, kategoria “luftëtarë” është më e gjerë se sa ajo “pjesëtarë i forcave të armatosura”, sepse “luftëtarë” përfshinë – përpos pjesëtarëve të forcave të armatosura – edhe kategoritë tjera :

- në kushtet e konfliktit të armatosur ndërkombëtarë: pjesëtarët e grupeve të organizuara të rezistencës; pjesëtarët e forcave të rregullta të armatosura të cilët deklarojnë se i përkasin ndonjëres qeveri apo pushtet të cilën nuk e ka pranuar Fuqia, nën qeverisjen e të cilës gjenden; dhe popullata e territorit të paokupuar e cila, me rastin e afrimit të armikut, vullnetarisht i marrin armët (*levee en masse*);
- në kushtet e konfliktit të armatosur ndërkombëtarë: pjesëtarët e forcave të armatosura disidentë apo grupeve të tjera të armatosura të organizuara.

Civilët

Civilët janë definuar, si në konfliktin e armatosur ndërkombëtarë si në atë jondërkombëtarë, negativisht, kjo do të thotë si persona të cilët nuk i përkasin forcave të armatosura të shtetit apo grupeve tjera të armatosura.

Kur është fjala për konfliktin e armatosur ndërkombëtarë, koncepti “civilë” është i definuar në mënyrë eksplicite në Protokollin Shtesë I, (nga viti 1977) në konventën e Gjenevës:

„Civilë është secili person i cili nuk i takon njëres nga kategoritë e cekura në nenin 4 (A) (1), (2), (3) dhe (6) të konventës së Tretë të Gjenevës dhe neni 43 i këtij Protokollit”⁷

Siç e ka cekë Dhoma e Apelit të ICTY në lëndën Blaškić, definicioni për civilë nga neni 50 i Protokollit I Shtesë të konventës së Gjenevës “në masë të madhe mund të vlerësohet si një shprehje e të drejtës zakonore.”⁸

Prandaj, civilë janë, në kushtet e konfliktit të armatosur ndërkombëtarë, personat të cilët nuk i përkasin asnjëres kategori të cekur në konventën e Tretë të Gjenevës, neni 4 (A), paragrafët (1), (2), (3) dhe (6):

- Paragrafi 1) forcave të armatosura të njëres palë në konflikt, si dhe as policisë dhe njërive vullnetare të cilët hynë si pjesë përbërëse e atyre forcave të armatosura
- Paragrafi 2) policisë tjetër apo njërive tjera vullnetare, duke nënkuptuar këtu edhe lëvizjet e organizuara të rezistencës, të cilat i përkasin njëres palë në konflikt dhe të cilët veprojnë jashtë apo në kuadër të territorit të tyre, madje edhe poqese ai territor është i okupuar, me kusht që ato njësi të

⁵ ICRC, *Interpretive Guidance on the Notion of Direct Participation in Hostilities Under International Humanitarian Law* (2009), str. 27.

⁶ Njejtë, fq. 30 (duke marrë dispozitën nga Protokollin Shtesë II, nga konventat e Gjenevës (1977), neni. 1).

⁷ Protokollin Shtesë I, nga konventat e Gjenevës (1977), neni. 50, paragrafi 1 (*Definicioni për civilët*).

⁸ Vendimi i Gjykatës së Tribunalit, në lëndën *Blaškić* (korrik 2004), paragrafi. 110.

policisë apo njësi vullnetare, duke nënkuptuar këtu edhe këto lëvizje të organizuara të rezistencës, përbushin kushtet si në vijim:

- a) që në udhëheqje të tyre të kenë personin përgjegjës për vartësit e tij;
- b) të kenë shenjën e caktuar dalluese e cila vërehet nga distanca;
- c) që ti mbajnë armët haptazi;
- d) që me rastin e veprimeve të tyre, ti respektojnë ligjet dhe zakonet ushtarake;

- Paragrafi 3) forcat e armatosura të rregullta, të cilat deklarojnë se i përkasin ndonjëres qeveri apo pushtet të cilin nuk e ka pranuar Forca, nën qeverisjen e të cilës gjenden;

- Paragrafi 6) popullata e territorit të paokupuar, të cilët me rastin e afrimit të armikut, i marrin armët për t'i bërë rezistencë sulmit të armikut, e të cilët nuk kanë pasë kohë të organizojnë njëri të rregullta të armatosura, nëse ata haptazi i mbajnë armët dhe nëse i respektojnë ligjet dhe zakonet ushtarake (të ashtuquajtur. *levee en masse*).

(Kur bëhet fjalë për nenin 43, të protokollit Shtesë I, i përmendur në definicionin për civilët, neni 50 i Protokollit, ai nen (43) nuk sjellë ndonjë kategori të re, përpos atyre që janë cekë në paragrafët (1), (2), (3) dhe (6) nga neni 4(A) të konventës së Tretë të Gjenevës. Neni 43 vetëm i definon ato të definuarat më parë “forcat e armatosura të njëres palë në konflikt”.⁹)

Në konfliktin e armatosur jo-ndërkombëtarë, koncepti “civilë” sërish është definuar negativisht, dmth; dallimin e saj nga kategoritë tjera.¹⁰ Në konfliktin ndërkombëtarë, këto kategori tjera janë:

- forcat e armatosura të shtetit,
- forcat e armatosura disidente, dhe grupet e tjera të armatosura (të cilat i plotësojnë kushtet të cilat i referohen komandës përgjegjëse, kryerja e aksioneve ushtarake të rregullta dhe të harmonizuara, kontrolli ndaj një pjese të caktuar të territorit, dhe aftësia që të veprojnë në pajtim me dispozitat e të drejtës ndërkombëtare humanitare të cilat kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur ndërkombëtarë.¹¹

Anëtarë/anëtare të Komisionit

Edhe pse puna e Komisionit do të përfshinë një numër të madh të personave në funksione të ndryshme, “Anëtarët/anëtares e Komisionit” është termin i cili ka të bëjë vetëm në 20 personat që janë emëruar, nga kryetarët e palëve kontraktuese, për të shërbyer në ato funksione në Komision. Personat tjerë i përkasin personelit të Komisionit dhe kryejnë punët në emër të Komisionit.

Vendi i burgimit

Definicioni i “vendit të burgimit” në Statut, nuk mbështetet në definicionin nga cilido dokument ligjor ndërkombëtarë, duke pasur parasysh se burimet relevante ligjore ndërkombëtare, përfshijnë Konventën e tretë të Gjenevës (për të burgosurit e luftës) dhe Konventën e katërt të Gjenevës (për mbrojtjen e civilëve në konfliktet e armatosura) *nuk* përmbajnë definicionin e shprehjeve siç janë “vendi i burgosjes”,

⁹ Neni 43, paragrafi 1, Protokollit Shtesë I, thotë: “Forcat e armatosura të palës në konflikt përbëhen nga të gjitha forcat e armatosura të organizuara, grupet dhe njësitë, të vëna nën komandën e cila është përgjegjëse për atë palë dhe për udhëheqjen e vartësve të saj, madje edhe kur ajo palë është e përfaqësuar me qeveri apo ndonjë pushtet të cilin pala kundërshtarë nuk e pranon.”

¹⁰ ICRC, *Interpretive Guidance on the Notion of Direct Participation in Hostilities Under International Humanitarian Law* (2009), str. 30.

¹¹ Njejtë.

dhe as “kamp përqendrimi” dhe “qendër grumbullimi”, dy terme apo shprehje këto të cilat shpesh përdoren gjatë diskutimeve në palët kontraktuese, me besimin e përhapur (të gabuar) se këto terme janë të definuara në të drejtën ndërkombëtare.

Në konfliktet e armatosura në territorin e ish RSFJ-së, në vendet e burgosjes shpesh kanë qenë personat burgosja e të cilëve ka qenë kundërligjore, por ka pasë edhe persona burgosja e të cilëve ka qenë në bazë ligjore. Baza ligjore ka ekzistuar në lidhje me robërit e luftës, si dhe personat tjerë, për të cilët ka ekzistuar dyshimi apo besimi se kanë qenë të angazhuar në aktivitete kundër sigurisë së shtetit.¹² Ato aktivitete përfshijnë spiunimin, sabotimin, apo dhënien e informatave shtetit armik ose personave të shtetit armik. (Nga ana tjetër, qëndrimi armiqësor ndaj shtetit, përderisa nuk shndërrohet në veprim aksioni, nuk paraqet bazë ligjore për arrestimin apo burgosjen e atij personi.¹³) Burgosja e civilëve duhet të jetë absolutisht e nevojshme (*absolutely necessary*) në mënyrë që të jetë e ligjshme.¹⁴ Përveç kësaj, madje edhe nëse burgosja (arrestimi) në fillim ka qenë në pajtim me ligjin, ai bëhet i paligjshëm nëse atij personi nuk i mundësohet që gjykata kompetente apo organi administrativ të mos e hulumtojë burgosjen (arrestimin) sa më parë, dhe që gjykata apo organi administrativ ta bëjë këtë edhe më vonë, në intervale të rregullta.¹⁵

Pa marrë parasysh a ekziston apo jo baza ligjore për burgosje, ndaj personave të burgosur duhet të ketë sjellje humane (njerëzore), që nënkupton ndalimin e torturimit dhe sjelljeve tjera të dhunshme dhe nënçmuese apo dënimin dhe përfshinë obligimin e kujdesit për të sëmurët dhe të plagosurit, furnizimin me ushqim dhe ujë dhe mbrojtje nga kushtet e vështira atmosferike.

Personi i zhdukur

Definicioni i personave të zhdukur në këtë Statut mbështetet në pjesën më të madhe në definicionin nga Konventa Ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave të zhdukur me dhunë, e cila ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2010. Por, përderisa definicioni nga Konventa e kufizon termin e zhdukjes së dhunshme në situata në të cilat përgjegjësinë e bartin organet shtetërore, gjegjësisht personat apo grupet personash të cilët veprojnë sipas urdhrave, me mbështetje dhe pëlqimin e organeve shtetërore, sipas definicionit të Statutit me personin e zhdukur nënkuptojmë edhe ata persona për zhdukjen e të cilëve janë përgjegjëse edhe ato forca të cilat në konfliktin e armatosur luftojnë kundër forcave

¹² Vendimi i Këshillit të Apelit të MKTJ, në lëndën *Čelebići* (shkurt 2001), para. 321 (duke cituar Konventën IV të Gjenevës, neni 5).

¹³ Vendimi i Këshillit të Apelit të MKTJ, në lëndën *Čelebići* (shkurt 2001), para 280 (duke u thirrur në Komitetin Ndërkombëtarë të Kryqit të Kuq, Koment nga Konventa IV e Gjenevës, fq. 56)

¹⁴ Vendimi i Këshillit të Apelit të MKTJ, në lëndën *Čelebići*, para. 320; vendimi i Këshillit të Apelit të MKTJ në lëndën *Kordić i Čerkez*, para. 70.

¹⁵ Vendimi i Këshillit të Apelit të MKTJ, në lëndën *Čelebići*, para. 320; Vendimi i Këshillit të Apelit të MKTJ, në lëndën *Kordić i Čerkez*, para. 70 (citon Konventën e Gjenevës IV, neni 43(1): “Secili person i mbrojtur i cili është internuar apo është dërguar në qëndrim të detyrueshëm, ka të drejtë të marrë vendimin në lidhje me të, që vendimi i marrë për të më parë, në kohën sa më të shkurtë të marrë në rishqyrtim, gjykata apo organi administrativ, e cila në atë rast do të konstatojë forcën e cila e mbanë atë person. Nëse vendimi për internim apo për qëndrim të detyrueshëm, ka mbetë në fuqi, gjykata apo organi administrativ, do ti qaset përkohësisht apo kohë pas kohe, së paku dy herë në vit, do ti qaset hulumtimit të rastit të atij personi, me qëllim që vendimi i parë të ndryshohet në të mirë të tij, nëse rrethanat e lejojnë një gjë të tillë”).

shtetërore.¹⁶ Ky zgjerim i termit “personi i zhdukur” është i domosdoshëm në kontekstin e ish RSFJ-së së dikurshme, nëse merret parasysh se në të shumtën e rasteve përgjegjëse për zhdukjen e personave kanë qenë formacionet të cilat kanë përfaqësuar çfarëdo pushteti, e as nuk kanë vepruar në emër të qeverisë shtetërore.

Pjesëtarët e forcave të armatosura

termi “pjesëtarë i forcave të armatosura” në konfliktin ndërkombëtarë është definuar në Protokollin Shtesë I, (nga viti 1977), dhe katër konventave të Gjenevës, në nenin 43, dhe atë si në vijim:

“Forcat e armatosura të palës në konflikt përbëhen nga të gjitha forcat e armatosura të organizuara, grupet dhe njësitë, të vëna nën komandën e cila është përgjegjëse për atë palë dhe për udhëheqjen e vartësve të saj, madje edhe kur ajo palë është e përfaqësuar me qeveri apo ndonjë pushtet të cilin pala kundërshtarë nuk e pranon” (paragrafi 1).

Pra, pjesëtarë i forcave të armatosura është pjesëtari i ndonjërit formacion të cekur më lartë në nenin 43, paragrafi 1, të Protokollit Shtesë I. Në të njëjtin nen theksohet edhe ajo se “sa herë që pala në konflikt përfshinë organizatën paramilitare apo ndonjë shërbim të armatosur për mbajtjen e rregullit në radhët e saja të armatosura, ajo është e obliguar që për ketë t’i njoftojë palët tjera në konflikt” (paragrafi 3). Prandaj, edhe forcat paramilitare dhe policia mund të përfshihen në forcat e armatosura të shtetit.

Termi “forcat e armatosura” në konfliktin e armatosur ndërkombëtarë, për dallim nga konflikti ndërkombëtarë nuk është definuar shprehimisht në ndonjë dokument të të drejtës humanitare ndërkombëtare. Mirëpo, sipas interpretimit autoritativ të Komitetit Ndërkombëtarë të Kryqit të Kuq, definicioni “konflikti i armatosur” i cili vlenë për konfliktet ndërkombëtare është i zbatueshëm edhe në kontekstin e konflikteve jo-ndërkombëtare, kështu që në te janë edhe “pjesëtarët e forcave të armatosura” pjesëtarët e forcave të rregullta ushtarake shtetërore, pastaj grupet dhe njësitë e vëna nën komandën e cila është përgjegjëse për shtetin.¹⁷

Siç është thënë në sqarimin për termin “luftëtarët”, kategoria “pjesëtarë i forcave të armatosura” është më e ngushtë së sa kategoria “luftëtarë”, në kuptimin që, përpos “pjesëtarëve të forcave të armatosura” në kategorinë e luftëtarëve bëjnë pjesë edhe:

- në kushtet e konfliktit të armatosur ndërkombëtarë: pjesëtarët e grupeve të organizuara të rezistencës; pjesëtarët e formacioneve të rregullta të armatosura të cilët deklarojnë se i takojnë ndonjë qeverie apo pushteti, të cilën nuk e pranon Forca, nën qeverisjen e të cilës gjenden; dhe popullata e territorit të paokupuar e cila, më rastin e afrimit të armikut, vullnetarisht i marrin armët për rezistencë (levee en masse);
- në kushtet e konfliktit ndërkombëtarë: pjesëtarët e forcave të armatosura disidente dhe grupeve të armatosura të organizuara.

¹⁶ Sipas Konventës Ndërkombëtare për mbrojtjen e personave nga zhdukjet e dhunshme, ,e “zhdukje të dhunshme” nënkuptohet “burgosja, parburgimi, rrëmbimi apo çfarëdo formë tjetër e privimit nga liria nga ana e organeve shtetërore apo personit apo grupeve të personave të cilët veprojnë sipas urdhërit, me mbështetje dhe pëlqimin nga organet shtetërore, pas së cilës refuzojnë të pranojnë veprën e kryer të privimit nga liria të personave tjerë, apo nuk trgeon për fatin e personave të zhdukur, apo për vendet ku ndodhen ata, me ç’rast ai person vihet jashtë mbrojtjes ligjore” (neni 2 i Konventës).

¹⁷ ICRC, “Interpetive Guidance on the Notion of Direct Participation in Hostilities Under International Humanitarian Law” (2009), fq. 30-31.

Lufta ose forma tjera të konfliktit të armatosur

Termi "*Lufta ose forma tjera të konfliktit të armatosur*" (nga neni 12 (c) – (e) neni 14, dhe neni 20 të Statutit) duhet kuptuar në mënyrën se si Paneli i Apelit i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (TPNJ), e ka definuar si "*konflikt i armatosur*".

Konflikti i armatosur ekziston kudo ku ka ardhur te përdorimi i forcës së armatosur në mes shteteve ose në dhunën e vazhdueshme të armatosur në mes të pushtetit dhe të grupeve të armatosura të organizuara, ose në mes të grupeve të tilla brenda një shteti. (Vendimi i Panelit të Apelit, në lëndën Tadic, sipas ankesës së mbrojtjes mbi kompetencën e Gjykatës (tetor 1995, paragrafi 70). Definicioni i përmendur ka të bëjë si me konfliktin e armatosur ndërkombëtarë, po ashtu edhe me konfliktin e armatosur të karakterit jo ndërkombëtarë.

Gjatë procesit konsultativ, shume prej pjesëmarrësve kanë shprehur bindjen që për konfliktin e armatosur në vendin e tyre do të duhej shfrytëzuar termi "*luftë*" gjegjësisht që termi "*konflikt i armatosur*" nuk do të ishte adekuat për shkak se, kinse ka të bëjë vetëm me konfliktet e brendshme dhe e zvogëlon dimensionin real të asaj se çfarë ka ndodhur. Një bindje e tillë nuk ka mbulesë në të drejtën ndërkombëtare, i cili shfrytëzon terminin "*konflikt i armatosur*", pavarësisht nga ajo se a ishte ai ndërkombëtar ose i brendshëm, dhe pavarësisht nga intensiteti i konfliktit. TPNJ në të gjitha aktgjykimet, në mënyrë konsistente ka shfrytëzuar terminin "*konflikti i armatosur*" me ç'rast ka pasuar terminologjinë nga marrëveshjet ndërkombëtare juridike të datës më të re (dy Protokolle plotësuese nga viti 1977, nga Konventa e Gjenevës) dhe kanë sqaruar që koncepti i "*luftës*", me fjalë të tjera ka m mbisunduar në të kaluarën, por, në ndërkohë, në masë të madhe është zëvendësuar me nocionin më të gjerë "*konflikti i armatosur*" (Vendimi i Panelit të Apelit në lëndën Tadic, sipas ankesës së mbrojtjes në kompetencën e gjykatës (tetor 1995), paragrafi 87). Statuti i Gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare, gjithashtu shfrytëzon terminin "*konflikti i armatosur ndërkombëtar*" (neni 8 (2) (b)), dhe "*konflikti i armatosur me karakter jo-ndërkombëtar*" (neni 8 (d) (c)). Edhe pse formulimi "*konflikti i armatosur*" e absorbon atë se çfarë në mënyrë tradicionale nënkupton me luftën, formulimi i propozuar ("*lufta ose forma të tjera të konfliktit të armatosur*") në Statutin e Komisionit, si kompromis shfrytëzohet termi "*lufta*", duke marrë parasysh në bindjen e fuqishme në disa palë kontraktuese, se vetëm ai term në mënyrë adekuate tregon atë se çfarë ka ndodhur në vendet e tyre gjatë viteve të nëntëdhjeta.

Krimi i luftës

Për nevojat e këtij Statuti, për shkak të thjeshtësimit në formulime, termi "*krim lufte*" shfrytëzohet në kuptimin më të gjerë, kështu që përfshinë si krimet e luftës në kuptim të ngushtë juridik, poashtu edhe krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin. Zgjidhjes së tillë i mungon saktësia e plotë ligjore, duke qenë se gjenocidi dhe krimi ndaj njerëzimit mund të kryhen edhe në situatat kur nuk ekziston konflikti i armatosur, dhe atëherë as nuk paraqesin *krime të luftës*. Por, kjo zgjidhje nga Statuti ka një precedent, psh, në rastin e emërtimit (gjithashtu për shkaqe praktike) "Departamenti për krime lufte" të departamenteve të Gjykatës në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Prokurorinë e Bosnjë e Hercegovinës, të

cilat merren me procesimin e krimeve të luftës në kuptimin e ngushtë, por edhe më krimin ndaj njerëzimit dhe gjenocidin.

Krimi i luftës, sipas të drejtës penale ndërkombëtare, përfshinë shkeljet e rënda të Konventës së Gjenevës nga viti 1949.¹⁸, si dhe shkeljet serioze të Konventave dhe rregullave zakonore të cilat, sipas të drejtës kontraktuese ose zakonore, kërkojnë përgjegjësinë individuale penale.¹⁹

Krimi kundër njerëzimit dhe gjenocidi përmbajnë elemente në bazë të cilëve dallojnë nga krimet e luftës. Njëri prej dallimeve të rëndësishme ka të bëjë me atë se, për dallim nga krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidi mund të jenë të kryer në kohë paqeje, gjegjësisht në mungesë të konflikteve të armatosura. Gjenocidi nënkupton cilëndo prej veprave në vijim, të kryera me qëllim që në tërësi ose pjesërisht të shkatërrohet ndonjë grup nacional, etnik, racor ose fetar si të tillë: (a) vrasja e pjesëtarëve të grupit; (b) shkatërimi i lëndimeve të rënda trupore ose lëndimeve shpirtërore të pjesëtarëve të grupit, (c) imponimi i qëllimshëm për pjesëtarët e grupit kushte jetese, të llogaritura që ti sjellin deri te shkatërimi i plotë ose shkatërimi i pjesërisht fizik; (d) vendosja e masave të cilat kanë për qëllim pengimin e lindjeve brenda grupit; dhe, (e) shpërngulja e dhunshme e fëmijëve të atij grupi në një grup tjetër.²⁰ Krimet kundër njerëzimit janë veprat penale si vijon, kur janë kryer si pjesë e përhapur ose e sulmit sistematik kundër popullsisë civile, me dijeninë të kryerësit se veprat e tilla hynë brenda kornizave të atij sulmi: (a) vrasja; (b) shfarosja; (c) robërimi; (d) deportimi; (e) burgosja; (f) tortura; (g) dhunimi; (h) përndjekja në bazë politike, racore dhe fetare; dhe (i) veprat tjera johumane.²¹

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

Data e themelimit e të ashtuquajturës “Jugosllavia e dytë”, ose Jugosllavia Demokratike Federative (JDF), (29. nëntor 1943) ndërlidhet me mbledhjen e dytë të AVNOJ-it në Jajce, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Pas zgjedhjeve nën kontrollin e PKJ, Asambleja Kushtetuese, me 29 nëntor 1945, solli shpalljen për Deklarimin e Republikës, e cila në Deklaratë u quajt “Republika Popullore Federative e Jugosllavisë” (RPFJ), Sipas Kushtetutës së vitit 1963, emri zyrtar i shtetit u shndërrua në “Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë” RSFJ. Edhe pse emri RSFJ është shfrytëzuar zyrtarisht që nga data 27 prill, 1992, kur Serbia dhe Mali i Zi edhe e themeluan Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ), tanimë treguan se, me shpalljen e deklaratave të pavarësisë nga ana e Sllovenisë dhe Kroacisë, me 25. qershor. 1991, *de facto* erdhi edhe deri te fundi i ish shtetit të përbashkët.

Shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut

Edhe pse definicioni pranuar sheshazi mbi shkeljet e rënda e të drejtave të njeriut nuk ekziston,²² shkeljet e caktuara të të drejtave, në burimet ndërkombëtare – juridike zakonisht theksohen si forma

¹⁸ Statuti i Tribunalit penal ndërkombëtar për ish Jugosllavin, (1993), neni 2; Statuti i Romës i Gjykatës penale ndërkombëtare (1998), i hyrë në fuqi në vitin 2002), neni (8) (2) (a).

¹⁹ Vendimi i panelit të apelit i TPNJ mbi kompetencën në lëndën *Tadic*, sipas mbrojtjes për kompetencën e gjykatës (tetor 1995) paragrafi 89 dhe 94. po ashtu, shiko Aktgjykimin e Panelit të apelit të TPNJ në lëndën *Kunarac dhe të tjerët* (qershor 2002).

²⁰ Konventa për pengimin dhe dënimin e krimit dhe gjenocidit (1948, ka hyrë në fuqi 1951), Neni II.

²¹ Aktgjykimin e panelit gjykues i TPNJ në lëndën *Kunarac dhe të tjerët* qershor 2002), paragrafi 85; Statuti i Tribunalit penal ndërkombëtar për ish Jugosllavinë neni 5.

²² Për shembull shiko Stephan Parmentier, “*International Crimes and Transitional Justice: ëhere does organised crime fit*” *Rivista di Criminologia, Vittimologia e Sicurezza* Vol. III – N. 3, Vol. IV – N. 1 – Settembre 2009 – Aprile 2010, www.vittimologia.it/rivista/articolo_parmentier_2009-03_2010-01.pdf, faqe 91

“të rënda të shkeljeve të të drejtave të njeriut” (angl. *Gross violations of human rights*):²³ Vrasjet; robërimet; burgimi i kundërligjshëm; tortura; zhdukjet e dhunshme; dhe depërtimi dhe shpërngulja e dhunshme e popullsisë, si dhe diskriminimi sistematik. Në dokumentet juridike ndërkombëtare dhe literaturë nuk ekziston konsensus lidhur me atë se a paraqesin shkelje e të drejtave të njeriut shkeljet e të drejtave tjera (për shembull, atyre ekonomike dhe sociale).

Kryerësi

Termi “kryerësi” përfshinë kryerësin dhe bashkëkryerësin, dhe gjithashtu edhe pjesëmarrësin (nxitësin), ndihmësin, dhe me të Drejtën penale ndërkombëtare edhe urdhërdhënësin, ndërsa sipas disa autorëve edhe personin i cili ka të ashtuquajturën “përgjegjësinë komanduese”). Nocioni “kryerësi” në kuptim të gjerë është në përputhje me çfarë përcaktojnë ligjet penale dhe Kodeksi penal i Serbisë, dhe Kodeksi penal i Malit të Zi, të cilët shprehimisht krijojnë destinkcionin ndërmjet “kryerësit”, si kuptim i gjerë, dhe “ekzekutorit”, si kuptim i ngushtë.²⁴ Ligji penal i BH shfrytëzon terminin “počinilac” dhe “učinitelj” (“bërës” dhe “kryerës”), për kategorinë e cila në ligjet e Serbisë dhe Malit të Zi karakterizohet si “kryerës”; më pastaj Ligji penal i Kosovës shfrytëzon termin “ekzekutuesi”, ndërsa Ligji penal i Kroacisë me termin “bërësi” (“počinitelj”).

Viktimat

Definicioni për viktimat në Statut është marrë nga dokumenti *Parimet dhe Udhëzimet themelore për të drejtën dhe shërimin ligjor dhe kompenzimin për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të të drejtës humanitare ndërkombëtare*, të miratuara në Rezolutën e Përgjithshme të Asamblesë së OKB-së në vitin 2005.²⁵ Nga definicioni del se për statusin e viktimës është e domosdoshme që dëmi të jetë shkaktuar nga veprimi ose veprimi, i cili paraqet shkelje të drejtave të njeriut apo shkelje të të drejtës humanitare ndërkombëtare.

²³ Burimet më së shpeshti të cituara, në të cilat numërohen këto forma të shkeljeve të rënda e të drejtave të njeriut janë: “*Conclusions of the Masstricht Seminar on the Right to Restitution, Compensation and Rehabilitation for Victims of Gross Violations of Human Rights and Fundamental Freedoms*”, e publikuar në publikimin *Seminar on the Right to Restitution, Compensation and Rehabilitation for Victims of Gross Violations of Human Rights and Fundamental Freedoms*, SIM Special, No.13, Utrecht, Netherlands Institute of Human Rights, 1992, faqe 16-21, dhe “*Definition of gross and large-scale violations of human rights as an internacional crime*” (raport i Stanislava Chernichenka, raportues special i K.B., Komisionit për të drejtat e njeriut), UN Doc.E/CN.4/Sub.2/1993/10(1993).

²⁴ Kodi penal, sl. Lista e rep. Serbisë, nr. 85/2005, pos.ndryshimet 119/09, neni 112; Kodi penal, sl.lista Mali i Zi, nr. 70/2003, pos. ndryshimet 25/2010, neni 142.

²⁵ Rezoluta nr. 60/147 prej 16. dhjetor 2005., paragrafi. 8.

PJESA II. – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 2.

Definicioni

Sqarim

Dokumenti i propozuar, Statuti i KOMRA-së, është i natyrës ligjore si kontratë ndërkombëtare. Nga palët kontraktuese (nënshkruese) pritet që pas nënshkrimit të Statutit, atë ta miratojnë në Parlamentet e tyre. Në të njëjtën mënyrë është themeluar edhe Gjykata Ndërkombëtare Penale me seli në Hagë²⁶. Gjithashtu edhe Agjensioni Ndërkombëtarë për ripërtëritje të energjisë (IRENA) është themeluar me statutin e organizatës, si marrëveshje ndërkombëtare (në aneksin me kontratë)²⁷.

Neni 3.

Simbolet

Sqarim

Për shembull, Gjykata Penale Ndërkombëtare është “e autorizuar të vendos flamurin, emblemën dhe shenjat e saja në hapësirat, automjetet dhe në mjetet tjera transportuese, të cilat do të shfrytëzohen për qëllime zyrtare”²⁸. Dispozitat për vulën i kishin për bazë aktet e disa komisioneve, për të vërtetën, siç është ai në Keni²⁹.

²⁶ Neni 1, Gjykata, Statutit Romak të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (*Sl. list SRJ – Marrëveshjet ndërkombëtare nr. 5/2001*) parasheh si në vijim: “Gjykata ndërkombëtare Penale (në tekstin në vijim „Gjykata” themelohet me këtë akt juridik. Themelohet si organ i përhershëm juridik dhe është kompetent për zbatimin e procedurës penale kundër personave për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se kanë kryer vepra të rënda penale të rëndësisë ndërkombëtare, në mënyrën si është paraparë me këtë Statut, dhe do të plotësohet sipas kompetencave ndërkombëtare penale të shteteve. Kompetenca e Gjykatës dhe funksionimi i saj janë të rregulluara sipas dispozitave të këtij Statuti.”

²⁷ Neni 1, i Statutit të Agjencionit Ndërkombëtarë për ripërtëritje të energjisë (përkthimi sipas *Sl. Thënsëi i Rep. Sërbisë*, nr. 105/09): „Palët e këtij Statuti me këtë caktojnë Agjencionin Ndërkombëtarë për ripërtëritjen e energjisë (në tekstin në vijim: Agjensioni) në pajtim me kushtet dhe dispozitat në vijim” Statuti është hartuar me 26. janar 2009. dhe hyn në fuqi ,e 8. korrik 2010.

²⁸ Neni 5, Ligji për vërtetimin e marrëveshjes mbi lehtësirat dhe imunitetit të Gjykatës penale ndërkombëtare, Gazeta Popullore e Republikës së Kroacisë, Nr 10/04

²⁹ Kenia, Neni 31 (“Vula e Komisionit).

Neni 4.

Selia dhe Sekretariati Ekzekutiv

Sqarim

Selia e Komisionit gjendet në kryeqytetin e Bosnjës dhe Hercegovinës (BH), për shkak të vlerave simbolike të Sarajevës, si vend në të cilin është zhvilluar lufta drejtpërdrejtë, si dhe intensitetit të luftës dhe pasojave të sajë në numrin e njerëzve të humbur në territorin e BH-së. Gjithashtu, është e rëndësishme për kryerje të suksesshme të detyrave nga ana e Komisionit sepse, kemi të bëjmë me qytetin i cili mund të sigurojë kushtet e domosdoshme për punën e tij. Në konsultimet e gjertanishme mbi themelimin e Komisionit nuk kishte kundërshtime të mëdha lidhur me këtë zgjidhje.

Se selia e Komisionit gjendet në Sarajevë, do të thotë se aty ndodhet Zyra qendrore e Komisionit, me emërtimin Sekretaria ekzekutive (shih nenin, 39 të Statutit). Gjithashtu, anëtarët e Komisionit, sipas rregullores, do të mbajnë takimet në Sarajevë. Komisioni, megjithatë, do të ketë zyrat e tij në të gjitha palët kontraktuese (nënshkruese) sipas nenit 40, të Statutit.

Neni 5.

Statusi juridik (ligjor)

Sqarim

Komisioni si organizatë ndërkombëtare, do të ketë subjektivitet ligjor. Kjo dispozitë mundëson konstituimin e Komisionit si person ligjor i cili mund të gëzojë të drejta dhe detyrime në sistemin ligjor, gjegjësisht të lidhë kontrata, të gëzojë të drejtën e disponimit me pronë të tundshme dhe të patundshme, dhe të iniciojë procedura ligjore. Sa për krahasim, marrëveshja për bashkëpunim mes shteteve të Këshillit për bashkëpunim rajonal (organizatave ndërkombëtare e cila është arritur në muajin Shkurt 2008, si pasuese e Paktit të Stabilitetit të dikurshëm për Evropën Juglindore) dhe Këshillit të ministrave të Bosnjë e Hercegovinës (vendit mikpritës) përcakton që Sekretariati i Këshillit për bashkëpunim rajonal të ketë identitet ligjor të aftë për realizimin e detyrës.³⁰ *Po ashtu*, Gjykata Penale Ndërkombëtare të Romës, në nenin 4 përcakton se *“Gjykata disponon me subjektivitet Ligjor Ndërkombëtar. Do të ketë edhe një aftësi*

³⁰ Marrëveshja mes Këshillit të ministrave BeH dhe qeverive të shteteve tjera pjesëmarrëse të Këshillit për bashkëpunim rajonal, Misionit të administrimit të përkohshëm të KB në Kosovë, në emër të Kosovës, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB, numër 1244, për aranzhmanin e shteteve mikëpritëse të Këshillit të Sekretariatit për bashkëpunim rajonal, *SI, zëri BeH*, nr. 4/08, neni. 3. (Marrëveshja është arritur me 14. shtator 2007. ka hyrë në fuqi me 22. prill 2008)

të tillë ligjore, e cila është e nevojshme për kryerjen e funksioneve të saja dhe realizimin e qëllimeve të saja”.³¹

Me dispozitën e paragrafit 2, Komisionit i jepet e drejta që në mënyrë të pavarur të rregullojë mënyrën e organizimit të punëve. Komisioni, me qëllim të përmbushjes me sukses të detyrave, do të nxjerr një seri rregullash me të cilat në detaje do të rregullohet kryerja e punëve të përditshme (shiko nenin 22 të Statutit).

Në paragrafin 3, përcaktohet obligimi i Komisionit, si organizatë ndërkombëtare me seli në Bosnje dhe Hercegovinë, që të lidhë kontratë të veçantë me Bosnjën dhe Hercegovinën. Në bazë të përvojave të ngjashme të bashkëpunimit të organizatave ndërkombëtare me shtetet-nikoqire, mund të pritet që me marrëveshjen, do të rregullohet veprimtaria e lirë e Komisionit, pacenueshmëria e hapësirave të saja, evidencës dhe arkivit të Komisionit, si dhe ekskluzivitet në pikëpamje të ekzekutimit dhe marrjes së pronës së tundshme dhe të patundshme. Përveç kësaj, kontrata do të përmbajë edhe dispozita lidhur me atë se me cilat procedura Komisioni (Sekretariati Ekzekutiv, anëtarët/anëtares dhe të punësuarit) nuk do të jenë të përjashtuar nga procedura gjyqësore dhe ekzekutimet në Bosnje e Hercegovinë (p.sh. Kontestet ligjore për punë, kontestet për shkaktim të dëmeve materiale, kundërvajtjet në komunikacion etj.). Me këtë marrëveshje do të rregullohet edhe mënyra e ofrimit dhe pagesës së shërbimeve komunale, pagesës dhe liritimit nga pagesa për dogana dhe tatime, sigurimi social, si dhe çështje tjera të domosdoshme për kryerjen efikase të punëve të Komisionit.³²

Neni 6.

Periudha e veprimit

Sqarim

Paragrafi 1.

Periudha e propozuar e veprimit të Komisionit prej tri vitesh përfaqëson tentimin që të gjendet baraspesha në përmbushjen e dy interesave: që të sigurohet kohë e mjaftueshme që Komisioni në mënyrë kualitative të kryej punën e vet të vëllimshme, dhe që puna e Komisionit të jetë sa më e shkurtër që të mbahet vëmendja e opinionit dhe të parandaloj që veprimi i Komisionit të jetë qëllim i vetëm i tij.

³¹ Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare (1998, ka hyrë në fuqi në vitin 2002), Neni 4 (Përkthimi: qendra për të drejtën ndërkombëtare dhe organizata ndërkombëtare të Fakultetit të Shkencave politike në Beograd, në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtarë të Kryqit të Kuq, Deklarata në Beograd).

³² P.sh. shiko Marrëveshjen në mes të Këshillit të Ministrave të BH dhe Qeverive të vendeve tjera pjesëmarrëse SEECP, Misioni i Qeverisjes së Përkohshme të KB në Kosovë dhe në emër të Kosovës, në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB Nr 12 44 mbi aranzhmanet me vendin nikoqir për Sekretariatit e Këshillit për bashkëpunim regional, Gazeta zyrtare BH, 4/08 gjithashtu Neni 3 i Statutit Romak të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“Gjykata lidh kontratë për selinë qendrore të Gjykatës me vendin nikoqir”).

Përvojat nga shtetet tjera tregojnë që periudha e veprimit të Komisionit varion, por që, edhe në shtetet me histori të re të konflikteve të armatosura, komisionet për të vërtetën, zakonisht kanë vepruar përgjatë dy viteve (Peru, Gana), ose tre viteve (Timori Lindorë).

Gjatë procesit konsultativ disa pjesëmarrës kanë paraqitur mendime që Komisioni do të duhet të vepronte katër, pesë ose më shumë vite, sepse në të kundërtën nuk do të ketë mundësi që të kryej punën e vet. Por, grupi punues për hartimin e Projekt Statutit, lidhur me këtë, tërheq vëmendjen se ekzistojnë komisione për të vërtetën, për të cilat gjithashtu, kishin punë voluminoze, mirëpo edhe përkundër kësaj kanë vepruar dy vite ose më pak, me çka kanë dëshmuar se – edhe atje ku krimet kanë qenë të përhapura – është e mundur që në afat të shkurtër dhe të arsyeshëm të bëhen hulumtime, të bëhen dëgjime të shumta publike dhe të hartohen raporte përfundimtare.

- Për shembull, Komisioni peruan për të vërtetën dhe pajtimin, ka filluar punën në muajin korrik të vitit 2001, dhe ka shpallur raportin përfundimtarë në muajin gusht të vitit 2003³³. Raporti kishte 8,000 faqe³⁴. Mbi vëllimin e punëve me të cilat është ballafaquar Komisioni Peruan, dëshmon fakti që Komisioni, ndër të tjera, ka mbledhur të dhëna mbi 23,969 raste të vrasjeve ose të humbjeve të dhunshme, si dhe 6,400 raste të torturave dhe veprimeve jo humane ose përbuzëse³⁵.
- Komisioni në Guatemalë ka vepruar 18 muaj. Raporti përfundimtarë i Komisionit, është shpallur në muajin shkurt të vitit 1999, në më shumë se 4.000 faqe, ka identifikuar dhe emëruar gjithsej 42,275 viktima, duke përfshirë 23,671 viktima të ekzekutimit jashtë gjyqësorë, si dhe 6,159 viktima të humbura në mënyrë të dhunshme³⁶.

Supozimi për kryerjen me sukses të mandatit në afat prej 3 vitesh është në atë se një numër i madh i individëve do të veprojnë si personel i Komisionit. Sa për krahasim, në Komisionin e lartë përmendur në Peru, më shumë se 800 njerëz, në periudha të ndryshme kanë punuar për Komisionin³⁷.

Në raport me komisionet në Peru, Guatemalë, dhe gjetkë, Komisioni do të ishte në një pozitë më të volitshme në kuptimin që tani ekziston një sasi mjaft e madhe e materialeve në të cilat do të mund të mbështetej për punën e tij, dhe me të cilin sigurisht do të shkurtohej edhe koha e nevojshme për hulumtime. Në këto materiale bëjnë pjesë numër i madh i aktgjykimeve të gjykatave, raportime të medieeve dhe organizatave joqeveritare, arkivi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë i cila është publikisht i hapur në faqen e internetit të Tribunalit, si dhe listat e të vrarëve dhe personave të

³³ Amnesty International, Peru: *The Truth and Reconciliation Commission – a first step towards a country without injustice*, Gusht 2004, Faqe 4, Fusnota 11.

³⁴ US Institute of Peace, "Truth Commissions – Peru 01", <http://www.usip.org/resources/truth-commission-peru-01>.

³⁵ Amnesty International, op. Cit. Faq.5 dhe 10.

³⁶ *Memory of Silence: Report of the Commission for Historical Clarification (Conclusions and Recommendations)*, Kapitulli 4. (Conclusions), pjesa 1. (The Tragedy of the Armed Confrontation), paragrafi 1., <http://aaas.org/guatemala/ceh/report/english/concl.html>. Komisioni ka vlerësuar se numri i përgjithshëm i të vrarëve dhe të humburve është rreth 200,000.

³⁷ Amnesty International, op. Cit. Faq.3.

humbur/zhdukur, të cilat janë hartuar nga agjencionet qeveritare dhe organizatat jo qeveritare në palët kontraktuese brenda hapësirave të ish Jugosllavisë dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Paragrafi 2.

Në periudhën trevjeçare të veprimit të Komisionit nuk përfshihet periudha e përgatitjeve, e cila fillon me mbajtjen e seancës konstituive dhe mund të vazhdojë më së gjati gjashtë muaj. Gjatë kësaj periudhe, siç tregojnë përvojat e komisioneve të tjera, KOMRA do duhej të merrej me çështjet si vijon:

- Gjetja e hapësirave për Sekretariatit Ekzekutiv, dhe zyret e Komisionit;
- Organizimi i Sekretariatit ekzekutiv dhe ndarja në njësi,
- Përgatitja e buxhetit,
- Komunikimi me donatorët,
- Punësimi i Sekretarit Ekzekutiv dhe personelit,
- Vendosja e metodologjisë, gjegjësisht nxjerrja e Rregullores dhe rregullave të domosdoshme,
- Përgatitja e fushatës dhe strategjisë për informimin e opinionit për punën e Komisionit, duke përfshirë edhe thirrjen për të interesuarit që të ofrojnë deklaratimet,
- Vendosja e bazës së të dhënave, (*data base*),
- Ndërmarrja e hulumtimeve preliminare,
- Grumbullimi i librave, artikujve dhe materialeve tjera relevante,
- Vendosja e prioriteteve në kryerjen e punëve, dhe
- Ndërmarrja e aktiviteteve tjera.³⁸

Paragrafi 3.

Mundësia që KOMRA të zgjasë (vazhdojë) periudhën e veprimit të vet edhe për gjashtë muaj krijon një fleksibilitet me të cilin Komisioni i shmanget situatave që të vihet në pozitë për të mos arritur përfundimin e hulumtimeve dhe hartimin e raportit përfundimtarë. Akti themelues i numrit më të madh të komisioneve përmban dispozita mbi mundësinë e vazhimit të mandatit, njëherësh ose, më rrallë shumë herë. Me atë rast, sipas rregullave, janë Parlamenti, Kryetari i shtetit – Presidenti, ose Kryetari i qeverisë – Kryeministri, ata të cilët kanë autorizime për të zgjatur (vazhduar) periudhën e veprimit.³⁹ Mirëpo, në disa raste vetë komisionit i është dhënë mundësia që ta vazhdojë periudhën e veprimit të vet.⁴⁰

KOMRA, në këtë pikëpamje, i takon grupit të dytë të komisioneve, sepse do të gëzojë të drejtën që ta vazhdojë mandatin e vet. Arsyeja kryesore për këtë zgjidhje është e natyrës praktike. Nëse vendimin mbi zgjatjen e mandatit do e merrnin shtetet të cilat edhe e kanë themeluar KOMRA-në, do të mund të

³⁸ Shiko statutet e komisioneve në Siera Leone, neni 5 (3) dhe (4), Timorin Lindor, neni 12 (1), në Ujdhesat Solomone, neni 4 (3), disa prej të rrallëve të cilët kanë precizuar obligimin e Komisionit në periudhën përgatitore.

³⁹ Siera Leone, neni 5 (1); Gana neni 5 (1), Liberia neni IV, kapitulli 6; Peru, neni 7; Ujdhesat e Solomonit neni 4 (1); Timori Lindorë neni 2 (4).

⁴⁰ Guatemala, neni .”*Installation and duration*”; Kanada, neni 8 (b); Paraguai (2003), neni 9.

ndodhte që ato të mos kenë pajtueshmëri për këtë, dhe që do të sillte deri te paralizimi, gjegjësisht pamundësia që Komisioni të përfundojë punën e vet.

Neni 7.

Përfaqësimi dhe paraqitja

Sqarim

Me këtë dispozitë në mënyrë të qartë theksohet se Komisionin e përfaqëson dhe paraqet kryetari/ja, nëse Komisioni nuk merr vendim që atë ta përfaqësojë ndonjë anëtarë/e tjetër.

Neni 9.

E drejta për të kontribuar në punën e Komisionit

Sqarim

Realizimit të qëllimeve të Komisionit, gjithsesi, do duhej ti kontribuonin njohuritë dhe dokumentet e shkruara, të cilat i disponojnë qytetarët ose personat ligjor, duke përfshirë dhe organet shtetërore. Në këtë kuptim, Komisioni, përmes fushatave publike do të inkurajojë të gjithë ata që janë në posedim të të dhënave të tilla që ti ofrojnë apo dërgojnë ato. Interesin shoqërorë për paraqitjen e informacioneve të cilat tregojnë vepër penale të krimit të luftës dhe kryerësve të tyre, e potencojnë edhe të gjitha ligjet penale në rajon, të cilat sanksionojnë si vepër penale mosparaqitjen e informatave të tilla⁴¹. Është e mundur që disa prej qytetarëve e konsiderojnë më të rëndësishme që disa të dhëna të ia dërgojnë Komisionit, ndoshta edhe në mënyrë anonime, se sa atë ta bëjnë ndaj organeve kompetente shoqërore. Edhe pse çdokush ka të drejtë të ofrojë pjesëmarrje në punën e Komisionit, në mënyrën e cila më së miri i përgjigjet interesave të tija (saja), mbetet që anëtarët e Komisionit të vlerësojnë për çdo rast lidhur me atë se a do të pranojnë pjesëmarrjen e ofruar, me qëllim të realizimit të detyrave të Komisionit.

Neni 9, nënkupton se organet shtetërore janë të obliguara që nëpunësve të tyre t'ua lejojnë dhënjen e deklaratave Komisionit, në rast të ftesës nga ai apo në bazë të iniciativës së tyre. (Kjo, megjithatë, nuk ka të bëjë më dhënien e fshehtësive zyrtare apo shtetërore Komisionit, përpos nëse bëhet fjalë për situatën sipas nenit 11, paragrafi 3, i Statutit.)

⁴¹ Ligji penal, Gazeta zyrtare e Malit të Zi nr. 70/2003, ndryshimet e fundit, 25/2010, neni 386 ("mosparaqitja e veprës penale dhe kryerësit"); Kodeksi penal, Gazeta zyrtare e Rep. Serbisë nr. 85/2005, ndryshimet e fundit, 119/09, neni 332; Ligji penal, Narodne novine Rep. Kroacisë nr. 110/97, ndryshimet e fundit 152/08, neni 300; Ligji penal, Gazeta zyrtare e BH, nr. 3/03, ndryshimet e fundit 8/10, neni 230.

Neni 10.

Parimet e veprimit të Komisionit

Sqarim

Veprimi i Komisionit bazohet në përkushtimin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, prandaj, këto parime gjenden në mesin e më të rëndësishmëve në këtë nen⁴².

Qëllimi i veprimit të Komisionit është që në mënyrë të vërtetë të vërtetojë provat (faktet) mbi shkeljen e të drejtave të njeriut. Anëtarët e Komisionit marrin pjesë në punën e Komisionit pavarësisht nga prejardhja e tyre nacionale, dhe nuk përfaqësojnë interesat e shteteve të tyre, por udhëhiqen me përkushtimin e tyre personal ndaj të vërtetës. (shiko nenin 35 të Statutit)

Puna e hapur e Komisionit, pavarësia dhe paanshmëria e anëtarëve të tij janë parimet që mundësojnë që Komisionin ta pranojnë të gjitha shtetet dhe të fitojë legjitimitet në mesin e qytetarëve në rajon. Karakteri rajonal i Komisionit, vetvetiu kontribuon në paanshmërinë e tij.

Komisioni, njëkohësisht, duhet të fitojë besimin e individëve dhe institucioneve të cilët bashkëpunojnë me të, dhe në këtë kuptim, burimet në të cilat Komisionit i është mundësuar qasja në të dhëna ose dokumente konfidenciale nuk do të jenë të publikuara, nëse ata/ato nuk dëshirojnë. (shiko nenin 11, 17 dhe 18 të Statutit).

Aktet themeluese të komisioneve paraprake kanë inkorporuar mekanizma që anëtarët dhe anëtarët e komisionit të zgjidhen në bazë të autoritetit dhe integritetit të tyre moral.

Cilësitë e komisionerëve janë të një rëndësie qenësore për legjitimitetin e Komisionit, gjegjësisht për pranimin e të njëjtit në shoqëri.

Posaçërisht, për shkak të natyrës së rëndë të krimeve të kryera ndaj fëmijëve dhe viktimave të dhunës seksuale, Komisioni, gjatë punës së tij, kujdes të veçantë do i kushtojë mbrojtjes së këtyre kategorive, me rastin e marrjes së deklaratave, shënimit të vendit të kryerjes së krimit dhe publikimit të raporteve.

Ky nen, në masë të dukshme, adopton përmbajtjen e nenit gjashtë, nga projektligji mbi të vërtetën, të drejtën dhe pajtimin (projekti i shoqërisë civile), i cili në muajin Nëntor të vitit 2008, ishte i përgatitur nga eksperti i Qendrës ndërkombëtare për të drejtën tranzicionale (Neë York), dhe Organizatës për të drejtat e njeriut në Keni.

⁴² Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *Rule of Law Rules from Post-Conflict States: National Consultations on Transitional Justice* (2009), <http://www.ohchr.org/Documents/Publications/NationalConsultationsTJ> En. pdf.

PJESA E III – OBLIGIMI I BASHKËPUNIMIT ME KOMISIONIN

Neni 11.

Obligimi i bashkëpunimit të palëve kontraktuese me Komisionin

Sqarim

Paragrafi 1.

Veprimi i organeve shtetërore në përputhje me obligimin nga neni 11 paraqet parakusht themelor për veprim efikas të Komisionit. Bashkëpunimi i shteteve me Komisionin është diçka që nënkuptohet, duke pasur parasysh që mu shtetet të cilat kanë themeluar Komisionin, edhe me atë rast Komisionit i kanë dhënë autorizime të definuara në mënyrë precize, duke përfshirë edhe marrjen e deklaratave (neni 17), mbledhjen e dokumentacionit dhe burimeve të tjera (neni 18), si dhe kryerjen e hulumtimeve dhe vizitave në teren (neni 19). Ato autorizime do të mbeteshin pa përmbajtje reale nëse shtetet do të pamundësonin Komisionit të merr deklaratat, të mbledh dokumentacione, të kryej hulumtime në teren. Krahas kësaj, për Komisionin do të jetë i domosdoshëm edhe bashkëpunimi i organeve shtetërore siç janë policia dhe gjykata në procedurën për ftuar dëshmitarët si dhe sigurimin e prezencës së dëshmitarëve, çka në detaje është paraparë në nenin 17, si dhe në disa raste të tjera. KOMRA mund të lidhë marrëveshje të veçanta për bashkëpunim me palët kontraktuese, në të cilat do të precizoheshin këto forma të bashkëpunimit.

Është e dukshme ngjashmëria në mes bashkëpunimit me KOMRA-në nga neni 11 i Statutit, nga njëra anë, dhe obligimit të organeve shtetërore të bashkëpunojnë me parlamentet e *komisioneve hulumtuese*, nga ana tjetër. Kroacia dhe Kosova kanë ligje të veçanta për këto komisione, me obligime të qarta të organeve shtetërore për bashkëpunim me komisionet. Ligji Kroat parasheh që „komisioni hetimor” (komisioni) „do të kërkojë me kompetencë nga të gjitha organet shtetërore... që t’ia ofrojnë në shikim të gjitha dokumentet të cilat do të mund të ishin të rëndësishme së veçantë, për realizimin e detyrës së saj. [Këto] organe... janë të obligueshme që të veprojnë sipas kërkesës së komisionit hetues.”⁴³ Gjithashtu, „udhëheqësit dhe zyrtarët tjerë të organeve shtetërore... janë të obliguar të dëshmojnë para komisionit hetues, apo tu tregojnë për faktet të cilat i dinë dhe tua ofrojnë dokumentet të cilat i posedojnë.”⁴⁴ Ligji në Kosovë parasheh që „me qëllim të realizimit të hetimit parlamentar, komisioni ka të drejtë (të) thërrasë ushtruesit e pozitive publike në dëgjim para komisionit; ... që të ketë qasje të pakufizuar në të gjithë dokumentet;⁴⁵ pastaj, „të gjithë personat fizik dhe juridik janë të obliguar që t’ia ofrojnë komisionit të gjitha dokumentet, të cilat kërkohen nga ata”⁴⁶, ndërsa organet publike janë të obliguara që punonjësve të tyre t’i lejojnë dhënien e dëshmisë para komisionit, përpos në rastet kur përcaktohet ndryshe me ligj.”⁴⁷

⁴³ Ligji për Komisionet hetimore, Gazeta popullore Rep. Kroacisë, nr. 24/96, čl. 15.

⁴⁴ Njejtë, neni. 16.

⁴⁵ Ligji nr. 03 L-176, për hetimet parlamentare, 4. qershor 2010., Sl. list Rep. Kosovës, nr. 74/2010, 20. gusht 2010., neni. 13, neni. 1, pika 1.

⁴⁶ Njejtë, neni. 18, pika. 4,

⁴⁷ Njejtë, neni. 19, pika. 9,

Ngjashëm me këtë, Rregullorja e Punës e Kuvendit të Malit të Zi, parasheh që „këshilli anketues ka të drejtë që, me qëllim të realizimit të hetimit parlamentar, të kërkojë nga organet shtetërore... të dhënat, dokumentet dhe informatat, si dhe të marrë deklaratat nga personat individual, nëse një gjë të tillë e vlerëson si ët nevojshme. Organet shtetërore... janë të obliguara ti ofrojnë dokumentet e vërteta, të dhënat e sakta, informatat dhe deklaratat të cilat kërkohen nga këshilli anketues”.⁴⁸ Rregullorja e Kuvendit nacional të Republikës së Serbisë, e autorizon Këshillin anketues që të „kërkojë nga organet shtetërore dhe organizatat të dhënat, dokumentet dhe informatat, si dhe të marrë deklaratat nga individët, të cilat janë të nevojshme. Përfaqësuesit e organeve shtetërore dhe institucioneve, janë të obliguar që të përgjigjen në ftesat nga këshilli anketues, gjegjësisht komisionit, dhe të japin deklaratat të vërteta, të dhëna, dokumente dhe informatat.”⁴⁹

Rregulla themelore që organet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Komisionin nuk dallon nga obligimi i cili është paraparë me ligjet për avokatin e popullit – ombudsmanin (mbrojtësit e qytetarëve, popullatës/avokatit të popullit) në rajon, që shtetet janë të obliguara që ombudsmanit ti mundësojnë qasje në hapësirat zyrtare, bisedim me çdo të punësuar në organet e administratës, dhe të ofrojnë në disponim të dhënat të cilat i disponojnë, dhe të cilat janë të rëndësishme për procedurën e cila procedohet, gjegjësisht për realizimin e qëllimeve të veprimtarisë së tij.⁵⁰ Në të dyja rastet, obligimi për bashkëpunim ekziston në raport me trupat të cilat shteti i ka themeluar, vet apo në bashkëpunim me shtetet tjera.

Të gjithë këta shembuj tregojnë se rregullativat ligjore në palët kontraktuese, kanë hyrë në masë të madhe në detyrimin e shtetit për të bashkëpunuar plotësisht, jo vetëm në raport me gjykatat, por edhe në lidhje me organet hetuese në organet specifike, si zyrat e Avokatit të Popullit dhe komisioni parlamentar hetimor. Detyra e bashkëpunimit me KOMRA-në, nuk do të duhej të paraqiste ndonjë gjë të pazakontë për palët kontraktuese. Ky detyrim ekziston në shtetet me demokraci të etabluar, prej nga gradualisht janë krijuar shtetet ligjore nga territori i ish RSFJ-së.

Statuti i Komisionit paraqet kontratë ndërkombëtare, të cilën e kanë ratifikuar shtetet, dhe me këtë e kanë bërë pjesë të sistemit ligjor vendor. Nga kjo buron karakteri detyrimor i dispozitës nga Statuti, prandaj edhe obligimi nga dispozita për bashkëpunim me Komisionin. Për shembull, obligimin e përgjithshëm të bashkëpunimit të shteteve në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, të paraparë edhe me Statutin Romak, kontratë ndërkombëtare në bazë të së cilës është themeluar edhe Gjykata Penale Ndërkombëtare në Hagë.⁵¹

Duhet pasë parasysh se praktikisht, të gjitha Statutet e të gjitha komisioneve për të vërtetën përcaktojnë obligueshmërinë e të gjitha organeve shtetërore për bashkëpunim me ta.

⁴⁸ Rregullorja e Kuvendit të Malit të Zi, *Sl. list Rep. Mali i Zi*, nr. 51/06 dhe 66/06, neni. 81.

⁴⁹ Rregullorja e Kuvendit Popullor të Asamblesë të Republikës së Serbisë, 28. korrik 2010., neni. 68, pika. 6 dhe 7.

⁵⁰ Ligji për Avokatin e Popullit, gazeta popullore REP. Kroaci nr. 60/92, neni 11; Ligji për mbrojtjen e qytetarëve, gazeta zyrtare REP Serbi, nr. 79/2005 i 54/2007, neni 21; Ligji për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive, *Sl. Lista Mali i Zi*, nr. 41/2003, neni 40; Ligji për Avokatin e Popullit dhe të drejtat e njeriut në BeH. Galsnik BeH nr. 19/02, 35/04, 32/06, neni 25; Ligji për Varuhu Clovekovih, *Uradni List Rep. Sllovenisë*, br. 33/91 – I, 42//97, 66/2000, 24/03, 69/04, neni 34 dhe 35.

⁵¹ Statuti Romak i të Gjykatës Ndërkombëtare, *Sl. list SRJ – Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 5/2001, Glava IX, neni. 86 (“Obligimi i përgjithshëm për bashkëpunim”).

Paragrafi 2 dhe 3.

Sqarim

Të dhënat, ndaj të cilave Komisioni ka qasje, përfshinë dokumentacionin, por edhe të dhënat deri te të cilat mund të vijë me marrjen e deklaratave nga ish zyrtarët ose zyrtarët aktual qeveritarë, si dhe nga persona të tretë, dhe të dhënat deri te të cilët mund të vijë në bazë të kryerjes së hulumtimeve në teren.

Shteti ka mundësi që Komisionit t'ia kufizoj qasjen në të dhëna, nëse në atë mënyrë do të shkeleshin dispozitat ligjore mbi konfidencialitetin e të dhënave, ose do të rrezikohej procedimi i procedurës penale. Mirëpo, Statuti, precizon se nuk konsiderohen sekrete shtetërore, ushtarake ose zyrtare të dhënat ose dokumentet të cilat tregojnë për kryerje të krimeve të luftës, gjegjësisht të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, dhe/apo në kryesit e mundshëm, si dhe në dokumentet e hartuara me qëllim të fshehjes së krimeve të kryera, gjegjësisht shkeljeve të të drejtave të njeriut. Këto kufizime të shprehjes "sekret" janë bërë me qëllim që të pengohet tendenca eventuale e pushtetit në ndonjë shtet që, duke u fshehur pas këtij nocioni, të pengojë përcaktimin legjitim të Komisionit të arrijë deri te njohuritë e vlefshme. Dispozita është e bazuar edhe në shembujt e ligjeve penale të Republikës së Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnjës e Hercegovinës, të cilat në të njëjtën mënyrë kanë ngushtuar kuptimin e "sekretit" shtetërorë, ushtarak, dhe "zyrtarë"⁵², dhe në ligjet mbi konfidencialitetin e të dhënave në Mal të Zi, Kroaci, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, kanë paraparë që nuk mund të shpallet si sekret e dhëna, me qëllim të fshehjes së veprës penale⁵³.]

Paragrafi 2 përmban këtë dispozitë për shkak të vlerësimit të grupit punues për hartimin e Statutit për të iu imponuar obligimin absolut shteteve që të dërgojnë të gjitha të dhënat sekrete, për të shtyer këto shtete që të fitojnë idenë për themelimin e Komisionit. Njëkohësisht nevoja për dispozitën e cila do të impononte një obligim të tillë shteteve realisht nuk ekziston, dhe në këtë kuptim që shumëllojshmërinë e të dhënave të disponueshme mbi krimet e luftës në hapësirat e ish RSFJ-së i bën më pak të besueshëm, në mënyrë që në bazë të përdorimit për herë të parë, të dokumenteve sekrete, Komisioni do të zbulonte një numër të konsiderueshëm për faktet, deri tani të panjohura, dhe të rëndësisë kruciale, për provat mbi krimet.

Paragrafi 4.

Komisioni mund të kërkojë nga shteti të dërgojë të dhëna të cilat me vendim të organit kompetent të shtetit janë shpallur konfidenciale (sekrete), ndërsa shteti mban të drejtën që të refuzojë të dërgojë të dhëna të tilla. Për raste të tilla është paraparë procedura e tejkalimit të situatave kontestuese me

⁵² Kodi Penal, zyrtare, Sl. Glasnik Rep. Serbisw, nr. 85/2005, ndryshimet e fundit 72/09, neni 316 (6), neni 369 (5), dhe neni 415 (5); Kodi Penal zyrtarë Sl. List Mali i Zi, nr 70/2003, 13/2004, 47/2006 dhe Sl List Cne Gore nr. 40/2008 dhe 25/2010, neni 369, paragrafi 5; Kodi Penal BeH, Sl. Zyrtare BeH, nr. 3/03, ndryshimet 8/10, neni 164, paragrafi 9.

⁵³ Ligji për të dhënat konfidenciale, Sl. list Mali i Zi, nr. 14/2008, ndryshimet e fundit 41/2010, neni. 4; Ligji për të dhënat konfidenciale, Gazeta Popullore Rep. Kroacisë, nr. 79/07, neni. 3; Ligji për të dhënat konfidenciale, Sl. glasnik Rep. Serbisë, nr. 104/2009, čl. 3; Ligji për të dhënat konfidenciale, Sl. glasnik BeH, nr. 54/05, neni. 9.

marrëveshje ndërmjet Komisionit dhe shtetit. Duhet pasur parasysh faktin e lartpërmendur që legjislacioni i palëve kontraktuese përjashton konfidencialitetin e të dhënave për krimet e luftës dhe lidhur me shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve të luftës.⁵⁴ Ligjet shprehimisht theksojnë, ose nënkuptohet që konfidenciale do të mund të jenë vetëm ato të dhëna në raport me të cilin janë të domosdoshme në shoqëritë demokratike, kur mbrojtja e interesave shtetërore është më e rëndësishme se interesat personale për qasje të lirë në të dhëna.⁵⁵ Duke pasur parasysh që Komisionin e themelojnë shtetet për të kryer punë për interes publik, nënkuptohet që do të ekzistojë vullneti i mirë që në procedurën e paraparë të harmonizimit, të gjenden zgjidhje kompromisi që do të mundësojnë mbrojtjen e interesave të shtetit dhe të Komisionit. Kjo dispozitë është hartuar sipas shembullit në dispozitën e nenit 72 të Statutit Romak të Gjykatës penale Ndërkombëtare.⁵⁶ Janë propozuar disa modalitete për arritje të marrëveshjes, duke përfshirë edhe mundësinë që Komisioni të obligohet për të ruajtur konfidencën e të dhënave të pranuar.

Nëse institucioni kompetent, si rezultat i pajtueshmërisë, i dërgon të dhënat e kërkuara Komisionit me kusht që para hartimit të raportit përfundimtarë, ose në aktivitete tjera të mos e zbuloj burimin – dokumentin e pranuar nga organi shtetëror, të dhënat e tilla gjithsesi janë të dobishme për punën e Komisionit. Komisioni, në bazë të tyre, mund të kuptojë në mënyrë më të plotë përmbajtjen – kuptimin e të dhënave të tjera të cilat tani më i ka siguruar, dhe përsëri të verifikojë bazueshmërinë e pohimeve që përmbajnë burimet tjera (publike), ose që të arrijë deri te njohuritë fillestare të cilat më vonë mund ti begatojë me të dhënat nga burimet publike. Ashtu siç vepron edhe Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, Komisioni mundet që, në raportin përfundimtarë, në fusnota të cilat theksojnë burimet për faktet e shtruar në pjesën narrative, të thirret në burimet e theksuara si “konfidenciale”, por, duke mos dhënë emrin e tij (saj), ose të dhëna tjera.

Është me rëndësi të shihet se neni 4 ka për qëllim që të rris efikasitetin e bashkëpunimit të shtetit me Komisionin, në mënyrë që të mos arrihet në situatën ku organet shtetërore, me zvarritjen e veprimit sipas kërkesës, të pengojnë që Komisioni, në afat të paraparë të mos e përfundoj punën e vet.

Neni 12

Bashkëpunimi i Komisionit me shtetet tjera dhe me organizatat ndërkombëtare

Sqarim

Me qëllim të mbledhjes së të dhënave për rastet e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të dhënave për fatin e të zhdukurve dhe vendet e burgosjeve, të hartimit të listës së

⁵⁴ Shiko më lartë fusnotat 19 dhe 20.

⁵⁵ Për shembull, shiko, Ligji për të dhënat konfidenciale Mali i Zi neni 10, al. 1. Të gjitha shtetet në regjion kanë ligjet për të drejtën në qasje të lirë në informata, dhe nënkuptohet që pretendohet në vendosjen e përmasave ndërmjet të drejtës në qasje të lirë dhe nevojës së shtetit që, në rrethana të jashtëzakonshme, të dhënat ti bëjë kofidenciale.

⁵⁶ Statuti i Romës Gjykata penale ndërkombëtare, Sl. List SRJ – marrëdhëniet ndërkombëtare nr. 5/2001

humbjeve në njerëz dhe listës së personave të arrestuar në mënyrë joligjore dhe viktimave të torturave, Komisioni ka të drejtë të lidhë marrëveshje për bashkëpunim me shtetet jashtë territorit të ish RSFJ-së, gjegjësisht me organizatat ndërkombëtare. Më lidhjen e marrëveshjes për bashkëpunim me shtetet tjera do ti mundësohet një numri të konsiderueshëm të personave, të cilët gjenden në shtetet jashtë territorit të ish RSFJ-së, të japin deklarata Komisionit, siç është paraparë me nenin 17, paragrafi 10 (d), të Statutit. Marrëveshjet për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë mbledhë numër të madh të fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut, i mundëson Komisionit ta shfrytëzojë dokumentacionin të cilin e kanë mbledhë ato organizata.

PJESA E IV. – QËLLIMET DHE DETYRAT E KOMISONIT

Neni 13.

Qëllimet

Sqarim

Qëllimet e KOMRA-së mund të ndahen në dy grupe: njërin e përbëjnë qëllimet, realizimi i të cilave mund të arrihej me veprimin e drejtpërdrejtë të Komisionit, ndërsa të dytin e përbëjnë qëllimet, në realizimin e të cilave kontributi i Komisionit është në mënyrë indirekte, gjegjësisht, në realizimin e të cilave, përmes veprimit të vet ofron një kontribut më të madh ose më të vogël.

Në grupin e parë bëjnë pjesë vërtetimi i fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, si dhe për rrethanat politike dhe shoqërore të cilat kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave si dhe për pasojat të cilat janë rrjedhojë e këtyre krimeve dhe shkeljeve, si dhe pranimi i padrejtësisë së shkaktuar ndaj viktimave.

Në grupin e dytë (qëllime këto për realizimin e të cilave Komisioni ofron kontribute indirekte) bëjnë pjesë: pranimi i fakteve, nga ana e qeverive të palëve kontraktuese mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut; ndriçimi i fatit të humburve – pagjeturve, krijimi i një kulture solidariteti dhe dhembshurie për viktimat; realizimi i të drejtave të viktimave; si dhe pengimi në kryerjen përsëri të krimeve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Kjo ndarje del nga natyra e veprimit të Komisionit, si dhe natyra e qëllimeve të përmendura. Grumbullimi i fakteve dhe dëgjimet publike paraqesin aktivitetet themelore të komisionit. Qëllimi i drejtpërdrejtë i grumbullimit të fakteve është që faktet të vërtetohen në mënyrë kredibile, ndërsa qëllimi i drejtpërdrejtë i dëgjimeve publike është pranimi i mundimeve dhe padrejtësive që ju shkaktuan viktimave. Në raport me qëllime tjera shoqërore të theksuara në nenin 13 – ndriçimi i fatit të humburve, pranimi i fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, krijimi i një kulture dhembshurie për viktimat dhe solidariteti me viktimat, realizimin e të drejtave të viktimave, si dhe mos përsëritja e krimeve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut – qëllimi i Komisionit është

që me mbledhjen e fakteve dhe dëgjimeve publike, të ofrojë kontribut në realizimin e tyre, por jo që vetë Komisioni me veprimet e veta të sjellë deri te realizimi i tyre. Për realizimin e këtyre qëllimeve, është i nevojshëm dhe i rëndësishëm së njëjtë, nëse jo edhe më i rëndësishëm, kontributi të cilin e ofrojnë aktorë të tjerë. Ndër këta aktor të tjerë bëjnë pjesë: trupat shtetërore për kërkimin e të humburve; agjencionet qeveritare detyra e të cilëve është që të sigurojnë reparacione për viktimat; dhe pushteti dhe publiku në kuptimin më të gjerë, në të gjitha palët kontraktuese.

Neni 13 është i pari në radhën e dispozitave të Statutit, në të cilat përdoret definicioni, sipas të cilit KOMRA duhet të “vërtetojë faktet”. Disa pjesëmarrës të procesit konsultativ, kanë shprehë kritikë lidhur me përdorimin e shprehjes së tillë, me argumentin se “faktet mund t’i vërtetojë vetëm gjykata me vendim të plotfuqishëm të gjykatës.”⁵⁷ Kjo kritikë, nuk e ka parasysh se Komisioni nuk do të vërtetojë faktet e përgjegjësive së krimit individual, gjë që është detyrë vetëm e gjykatës, dhe se Komisioni nuk është gjykatë. Nga ana tjetër, në palët kontraktuese, si dhe në shtetet tjera, me ligje dhe me dispozita tjera janë organet *jashtë-ligjore* decidivisht të caktuara si përgjegjëse për vërtetimin e fakteve. Ka shumë shembuj lidhur me këtë:

- Ligji Kroat për Komisionet Hetimore (“Në hetimet që i zhvillon, komisioni hetues vendos *gjendjen e vërtetë*, si dhe të gjitha *faktet* tjera të rëndësishme, të rëndësishme për vërtetimin e të vërtetës dhe për sjelljen e vendimit të drejtë. Në procesin e *vërtetimit të fakteve* komisioni hetimor do të përdorë të gjitha faktet për të vërtetuar gjendjen faktike të situatës...”),⁵⁸
- Ligji për hetim parlamentar i Kosovës, (“[Anketimi] Komisioni [në parlament] formohet për shkak të *vërtetimit të fakteve* dhe përshkrimit të rrjedhës të asaj ngjarjeje ...”),⁵⁹
- Rregullorja e Punës së Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë (“Kuvendi popullor krijon këshillin anketues, gjegjësisht komisionin, për të shqyrtuar situatën aktuale në fushën e caktuar dhe *vërtetimin e fakteve* për dukuritë individuale të caktuara dhe ngjarjet”);⁶⁰
- Rregullorja e UNTAET-së për themelimin e komisionit për të vërtetën në Timorin Lindor („qëllimet e komisionit përfshijnë: ... *vërtetimin e të vërtetës* për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën”);⁶¹
- Akti i themelimit të komisionit për të vërtetën në Marok (“aktivitetet e Komisionit [zhvillohen] ... në kuadër të një qasjeje gjithëpërfshirëse, qëllimi i së cilës është ti shërojë plagët nga e kaluara, të kompensoj dëmet, të *vërtetojë faktet* dhe ti mësojë leksionet nga e kaluara”);⁶²
- Raporti përfundimtar I komisionit për të vërtetën në Republikën Jugoafrikane (“kompetencat sipas nenit 29 janë ... shpesh I lejon Komisionit të *vërtetojë faktet* lidhur me zhdukjet e dhunshme”);⁶³

⁵⁷ Ky argument është në konsultimet Rajonale me komunitetin juridik mbi Statutin, me 11 qershor 2010, në Zagreb, të cilin e ka paraqitë një avokat me përvojë punë në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë.

⁵⁸ Ligji për Komisionet hetimore, *Narodne novine Rep. Krocisë*, nr. 24/96, neni. 10, paragrafet 2 i 3.

⁵⁹ Ligji, nr. 03 L-176, për hetimin parlamentar, *Sl. list Rep. Kosovës*, nr.74/2010.,20.gusht 2010., neni. 2.

⁶⁰ Rregullorja e punës së Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë, 28. korrik 2010., neni. 68, prg. 1.

⁶¹ Rregullorja UNTAET-a nr. 2001/10 për themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në Timorin Lindor), 13. korrik 2001., kapitulli 3: Qëllimet dhe detyrat e Komisionit, neni. 3.1 (b).

⁶² Dahir nr. 1.04.42, prej 19. Safara 1425 (10. prill 2004.) me të cilin vërtetohet statuti i Komisionit për drejtësi dhe pajtim në Marok, Preambula.

- Komisioni inter-amerikan për të drejtat e njeriut, organ ndërkombëtar me kompetencë që të hulumtojë rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në shtetet e Amerikës Jugore dhe Veriore, ka pranuar “rolin e rëndësishëm të komisionit për të vërtetën”[në Kili] *në vërtetimin e fakteve* dhe sigurimin e kompensimit”,⁶⁴ si dhe “kontributin e veçantë të komisionit për të vërtetën [në El Salvador] *në vërtetimin e fakteve* lidhur me shkeljet jashtëzakonisht të rënda [të të drejtave të njeriut]”.⁶⁵

Qëllimet e Komisionit realizohen me plotësimin e detyrave konkrete të cekura në nenin 14 të Statutit (Detyrat e Komisionit). Çdonjërit prej qëllimeve iu përgjigjet ndonjëra prej detyrave. Për shembull, qëllimit të theksuar në nenin 13, nën e. (kontributi në ndriçimin e fatit të të humburve) i përgjigjet detyra b në nenin 14 (grumbullimi i të dhënave mbi fatin e të humburve dhe bashkëpunimi me trupat kompetente, të cilat në palët kontraktuese, merren me hulumtime për të humburit), ndërsa arritjes së qëllimit të dhënë nën c. (kontributi në realizimin e të drejtave të viktimave) i përgjigjet detyra g, neni 14, (rekomandimi i masave të cilat kanë të bëjnë, ndër të tjera, me kompensimin për viktimat). Gjithashtu, qëllimet dhe detyrat janë të ndërlidhura me autorizime konkrete të Komisionit, të parapara në nenet 17-22 të Statutit. Vërtetimi i fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut (qëllimi (a), në nenin 13), arrihet me grumbullimin e të dhënave nga neni 14 (pika a–d), ndërsa të dhënat grumbullohen përmes marrjes së deklaratave, hulumtimit të dokumentacioneve si dhe hulumtimeve në teren, meqë të gjitha paraqesin autorizimet e Komisionit nga neni 17, 18 dhe 19 të Statutit.

Neni 14.

Detyrat

Sqarim

Kryerja e detyrave konkrete, të dhëna në këtë nen (14) duhet të çoj deri te realizimi i qëllimeve thelbësore të Komisionit, të parapara në nenin paraprak (13) në këtë kuptim ekziston lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet këtyre dy neneve në Projekt Statut: Disa prej detyrave nga neni 14 kontribuojnë në realizimin e njërit ose të më shumë qëllimeve konkrete nga neni 13. Për shembull, detyra e cila ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave për fatin e të humburve kontribuon në realizimin e dy qëllimeve: vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, por edhe në ndriçimin e fatit të të humburve, nëse Komisioni, paraprakisht, siguron të dhëna të panjohura mbi lokalitetet me mbetjet mortore.

⁶³ Raporti përfundimtar i Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në Republikën Jugoafrikane, 6, pjesa 4, kapitulli 1, prg. 40.

⁶⁴ Komisioni inter-amerikan për të drejtat e njeriut, *Garay Herosilla et al. v. Chile*, Lënda nr. 10.843, Raporti nr 36/96 (1997.), prg. 75.

⁶⁵ Komisioni inter-amerikan për të drejtat e njeriut, *Ignacio Ellacuría et al.* (El Salvador), Lënda nr. 10.488, Raporti nr. 136/99 (1999.), prg. 229-230.

Disa paragrafë në këtë nen shfrytëzojnë termin “grumbullimi” (i të dhënave). “Grumbullimi” këtu ka një kuptim më të gjerë nga kompilimi dhe përpunimi i të dhënave deri te të cilat tani më, kanë ardhur institucione, organizata, media etj. Kështu për shembull, edhe marrja e deklaratave nga viktimat dhe dëshmitarët paraqet një formë të grumbullimit të të dhënave.

Pika a.

Detyra themelore e secilit Komision për të vërtetën është që të grumbulloj të dhëna mbi rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut, gjegjësisht të krimeve të luftës. Mirëpo, në situatat e shkeljeve masive të të drejtave, dhe duke pasur parasysh periudhën e kufizuar të Komisioneve për të vërtetën, asnjë Komision nuk mund të grumbullojë të gjitha të dhënat për të gjitha rastet veç e veç të shkeljeve, në atë mënyrë siç e bëjnë gjykatat. Në vend të kësaj, komisionet fokusohen në formularët e shkeljes së të drejtave, gjegjësisht, në ato të numrit më të madh të shkeljeve individuale, identifikojnë dhe i përshkruajnë në mënyrë të drejtë mbi kryerjen e krimit.

Pika b.

Detyra e KOMRA-s për të grumbulluar të dhëna për fatin e të humburve nuk do të thotë që Komisioni do të zëvendësojë punën dhe të merr kompetencat e komisioneve për hulumtimin e personave të humbur, komisione të cilat ekzistojnë në numrin më të madh të palëve kontraktuese. Ato komisione do e vazhdojnë punën e tyre ndërsa KOMRA do të bashkëpunoj me to përmes dorëzimit të të dhënave të cilët do arrijë me punën e vet, dhe të cilat do mundësojnë gjetjen e lokacioneve në të cilat janë varrosur trupat e të humburve.

Pika c.

Njëra prej detyrave të Komisionit është që të hartojë regjistrimin e personave që kanë humbur jetën në ndërlidhje me konfliktin e armatosur. Termi “*në ndërlidhje*” është një termin më i gjerë se sa ai “*gjatë*”, kështu që Komisioni në regjistrim do i rendis personat të cilët kanë humbur jetën, ose kanë humbur, pas përfundimit të konfliktit të armatosur, nëse deri te vrasja, gjegjësisht, zhdukja e dhunshme, ka ardhur nga ndërlidhja me konfliktin e armatosur të sapo përfunduar.

Dispozita për regjistrimin e personave të cilët kanë humbur jetën në ndërlidhje me konfliktin e armatosur nuk shfrytëzon termin “*viktima*”, për shkak se në numrin më të madh të rasteve Komisioni do ta ketë të vështirë që me siguri të plotë të vërtetojë se a thua personi që ka humbur jetën ka pasur status të viktimës, në kuptimin e asaj me çfarë ky termin është definuar në të drejtën ndërkombëtare:

Viktimat janë persona të cilët, në mënyrë individuale ose kolektive kanë pësuar dëme, duke përfshirë lëndimet fizike ose mendore, mundime emocionale, humbje ekonomike ose kufizime të dukshme të drejtave të tyre përmes veprimeve ose mosveprimeve të cilat paraqesin shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare, të drejtave të pranuar të njeriut ose shkelje të rëndë të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Kur kjo është e mundshme dhe në përputhje me të drejtën vendore, termi viktimë gjithashtu përfshinë edhe anëtarët e familjes së ngushtë ose personat ndaj të cilëve viktimat ka qenë në

marrëdhënie të varura.⁶⁶, si dhe personave që kanë pësuar me rastin e intervenimit, qëllimi i të cilit ka qenë tu ndihmohet viktimave apo parandalimi i shkeljeve tjera.

Nga ky definicion rrjedh që për statusin e viktimës është e domosdoshme që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin ose mosveprimin që paraqet shkelje të së drejtës së njeriut, ose të drejtës humanitare ndërkombëtare. Në të shumtën e rasteve, Komisioni do të ballafaqohet me pamundësinë që të vërtetojë se a kishte me të vërtetë shkelje të tilla në rastin kur një person ka humbur jetën, ose shkelje nuk kishte për atë që personi civil ka humbur jetën gjatë zbatimit të ligjshëm të operacionit ushtarak nga ana e kundërshtarit (rastet e ashtuquajtura “*dëme kolaterale*”) gjegjësisht për shkak se personi ka vdekur si luftëtar gjatë veprimeve ushtarake. Përveç kësaj, për tu vërtetuar se a është personi “viktimë” kërkon një sasi informacionesh dhe kohë të cilën Komisioni – i ballafaquar me më së paku 130,000 raste të humbjes së jetëve gjatë veprimeve luftarake në hapësirat e ish RSFJ-së – nuk do ti ketë në disponim.

Për shkak të arsyeve praktike, do të ishte më e udhës që lista e hartuar nga ana e Komisionit, të bënte me të gjithë personat që kanë humbur jetën, ose që kanë humbur në mënyrë të dhunshme. Në këtë rast, kjo listë do të jetë e strukturuar në atë mënyrë që në të të inkorporohen, nga njëra anë, humbjet civile, dhe nga ana tjetër, humbjet ushtarake. Komisioni, në këtë aspekt të punës së tij, nuk do të hyjë në atë se a është personi viktimë në kuptimin e saktë ligjor.

Me rastin e tentimit për të vërtetuar se personi që ka humbur jetën a ishte civil ose luftëtarë, Komisioni, në të shumtën e rasteve do të ballafaqohet me vështirësitë të cilat dalin nga numri i kufizuar i informacioneve dhe i kohës së kufizuar për hulumtime. Prapë se prapë këto vështirësi do të jenë dukshëm më të vogla nga ato me të cilat do të ballafaqohet Komisioni nëse do të vërtetonte se a ka ardhur deri te vdekja si pasojë e shkeljes së të drejtave. Me fjalë të tjera, më thjeshtë është që të vërtetohet statusi i personave (si luftëtarë ose civil), se sa rrethanat precize me të cilat personi ka humbur jetën, kualifikimi ligjor i cili del nga vërtetimi i rrethanave. Në rastet kur Komisioni nuk do të jetë në gjendje të vërtetojë statusin e personave, ai do të ketë mundësinë që në listë të shfrytëzoj kategorinë “statusi i panjohur”.

Pritet që Komisioni të paraqes të gjitha faktet relevante të cilat i ka përcaktuar lidhur me rrethanat e vrasjeve. Kjo çështje do të rregullohet më afër në bazë të Rregullores mbi krijimin e regjistrit të humbjeve njerëzore.

⁶⁶ Parimi themelor i udhëzimeve për të drejtën në apelim dhe reparacion për viktimat e shkeljeve të rënda të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe shkeljeve serioze e të drejtës humanitare ndërkombëtare, të miratuara me Rezolutën e Asamblesë së përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (K.B.), nr. 60/147, nga 16 dhjetori 2005, par. 8. Ky definicion, në masë të madhe bazohet në definicionin për viktimën nga K.B. Deklarata për parimet themelore e të drejtës për viktimat e krimeve dhe keqpërdorimit të pushtetit, të cilën Asambleja e Përgjithshme e KB, ka miratuar me Rezolutën 40/34, dt. 29 Nëntor 1987. Dallimi ka të bëjë vetëm në atë që parimi themelor nga viti 2005 shfrytëzon terminin “veprimet ose mosveprimet” që paraqesin shkelje të rëndë e të drejtës Ndërkombëtare për të drejtat e pranuar të njeriut, ose shkelje të rëndë e të drejtës humanitare ndërkombëtare”, ndërsa deklarata e vitit 1985 flet për “veprimet ose mosveprimet të cilat janë në kundërshtim me ligjet penale në fuqi në shtetet anëtare”.

Pika d.

Grumbullimi i informacioneve në vendet e burgimit, dhe personave të cilët janë burgosur në mënyrë joligjore, dhe/apo u janë nënshtruar torturave dhe sjelljeve jonjerëzore, të ndërlidhura me konfliktin e armatosur, dhe hartimi i regjistrimit gjithëpërfshirës të vendeve të tilla dhe viktimave, është ndarë si detyrë e KOMRA-së për të respektuar faktet që në dhjetëra mijëra njerëz në hapësirat e ish RSFJ-së kanë qenë të burgosura në mënyrë të kundërligjshme, ose janë – pavarësisht nga ajo se a ka ekzistuar arsyeja për burgosjen e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare – dhe se i janë nënshtruar torturave apo veprimeve jonjerëzore, dhunës seksuale, ose shkeljeve tjera të së drejtës.

Kur është fjala për vendet e paraburgimit, Komisioni do të duhej të mbledhë të dhënat për të gjitha ato vendet. Nëse detyra e Komisionit do të kufizohet vetëm në mbledhjen e të dhënave për vendet e burgimeve dhe paraburgimeve, duke i lënë anash edhe të dhënat për vendet ku kanë qenë personat edhe personat e burgosur me bazë ligjore, në të shumtën e rasteve do të tregohet se është vështirë të bëhet ndarja strikte e tyre, gjegjësisht që në të shumtën e vendeve – në periudha të njëjta apo të ndryshme, kanë qenë edhe personat e burgosur në mënyrë joligjore, por edhe personat e burgosur me bazë ligjore.

Kur bëhet fjalë për statusin e personave të burgosur, ekziston dallimi thelbësor mes asaj, se a është burgosur personi i caktuar sipas arsyeve të lejuara, në bazë të drejtës humanitare ndërkombëtare, apo ndoshta asi arsyesh nuk ka pasë. Komisioni do të duhej të mbledhë të dhëna për ata persona të cilët janë burgosë në mënyrë joligjore, dhe në bazë të kësaj ta paraqesin viktimën, në kuptimin sipas të cilit Statuti e përdorë atë term. (shih nenin 1, *Kuptimi i termeve në këtë Statut*).

Dallimi tjetër qenësorë është edhe ai lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut për personat e burgosur (posaçërisht e drejta në jetë dhe integritet psiko-fizik), nga njëra anë, dhe shkelja e të drejtave, nga ana tjetër. Krahas kësaj, Komisioni ka për detyrë të mbledhë faktet për personat të cilët kanë qenë viktimat të shkeljeve të të drejtave, gjegjësisht të torturave dhe sjelljeve jo njerëzore, në vendet ku kanë qenë të burgosur.

Pika e.

Nevoja që KOMRA të vërtetoj faktet për rrethanat politike dhe historike të cilat bindshëm kanë kontribuar në shpërthimin e konflikteve të armatosura, si dhe deri te kryerja e krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut, rrjedh nga qëllimi i Komisionit (nga neni 13), që “të kontribuojë në parandalimin e përsëritjes së krimeve dhe shkeljeve tjera të rënda të drejtave të njeriut”. Numri më i madh i Komisioneve për të vërtetën janë munduar që të ndriçojnë shkaqet të cilat kanë sjellë deri te shkelja e të drejtave të njeriut në të kaluarën. Ky përkushtim rrjedh nga nevojat e shoqërisë për të penguar që të njëjtat shkaqe që krijuan klimën politike dhe sociale e cila solli deri te krimet, të vazhdojnë ta bëjnë të njëjtën edhe në të ardhmen. Edhe pjesëmarrësit në konsultimet për themelimin e Komisionit e kanë njohur këtë raport në mes të nevojës që krimet të mos përsëriten, nga njëra anë, si dhe nga domosdoshmëria për të kuptuar se çfarë solli në të kaluarën deri te krimi në anën tjetër. Me fjalët e një pjesëmarrësi, “pasojat do të përsëriten gjithmonë, absolutisht gjithmonë, për derisa nuk

eliminohen shkaktarët e dukurive të tilla, çfarë do që të jenë pasojat”.⁶⁷ Arsye tjetër për shkak të së cilës Komisioni do të duhet të hulumtonte “shkaqet”, qëndron në nevojën e natyrshme të njerëzve që të kuptojnë se përse erdhi deri te ngjarjet të cilat në mënyrë të vendosur – dhe negative – kanë formësuar jetët e tyre.

Për këto arsye, ekziston nevoja reale që në mandat të Komisionit të hyjë edhe hulumtimi i rrethanave të cilat bindshëm sollën deri te shpërthimi i konflikteve të armatosura dhe te kryerja e krimeve të luftës në ish RSFJ. Me këtë rast, kërkesa në Statut për tu vërtetuar rrethanat të cilat sollën deri te “shpërthimi i konflikteve të armatosura” nuk duhet të kuptohet si përcaktim që Komisioni të merret me konfliktet e armatosura, si të tilla (duke përfshirë, për shembull, strategjitë ushtarake të zbatuara në konflikte). Fjala është vetëm për atë se krimet e luftës (në kuptim të ngushtë) ndodhin në kontekst të konflikteve të armatosura, gjegjësisht, në mungesë të konflikteve të armatosura nuk do të kishte as krime lufte. Nëse, me mirëkuptim, rrethanat të cilat sollën deri te konfliktet e armatosura, zvogëlojnë mundësinë që konfliktet të shpërthejnë përsëri në të ardhmen, zvogëlohet edhe mundësia për kryerjen e krimeve të luftës.

Përkundër argumenteve të theksuara më lartë, një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve në procesin konsultativ janë deklaruar kundër asaj që Komisioni të hulumtojë “shkaqet e konflikteve dhe krimeve”. Dy janë prej arsyeve themelore për këtë kundërshtim: (1) fakti që përbrenda grupeve të ndryshme etnike ekzistojnë botëkuptime diametralisht të kundërta lidhur me atë se çfarë solli deri te shpërthimi i konflikteve të armatosura dhe deri te kryerja e krimeve të luftës, me çrast ekziston edhe frika se as anëtarët e Komisionit nuk do të kenë sukses të arrijnë deri te një qëndrim i përbashkët lidhur me këtë çështje, dhe as shtetet nuk do të kenë vullnetin që të pranojnë gjetjet eventuale të Komisionit ; dhe, (2) frika që hulumtimi i shkaqeve do të mund të sillte deri te marrja me një periudhë të largët historike, çka Komisionit do ti merrte shumë kohë dhe do e pengonte që të fokusohet në detyrën e tij themelore – hulumtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Grupi punues për hartimin e Statutit, i ka respektuar të dyja këto arsye, por ka ardhur deri te përfundimi se numri më i madh i pjesëmarrësve në konsultime, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike është përcaktuar për atë që Komisioni të hulumtojë edhe “shkaqet e konflikteve të armatosura”.

Rreziqet që lindin me renditjen e shkaqeve në lëndën hulumtuese të komisionit janë reale dhe nuk ka garancione që Komisioni do të jetë në gjendje që ti tejkalojë me sukses. Prapëseprapë, kur kemi të bëjmë me njërën prej dy rreziqeve – mundësia eventuale që anëtarët e Komisionit të arrijnë deri te qëllimi i përbashkët – është e nevojshme të merret në konsideratë që shumica e komisioneve tjera, të krijuara në shoqëri mjaft të ndara, gjithashtu, në mandatin e tyre kanë pasur marrjen me shkaktarët, dhe se po thuaj në të gjitha rastet anëtarët e atyre komisioneve kanë pasur sukses të arrijnë deri te qëndrimi i përbashkët në raportin përfundimtarë.⁶⁸ Për shembull, Komisioni nacional për të vërtetën

⁶⁷ *Ekrem Hadzic*, konsultimet me përfaqësuesit e shoqatave të viktimave në Serbi, Beograd, 3 qershor 2010.

⁶⁸ Për shembull, Komisioni nacional për të vërtetën dhe pajtimin (Komisioni *Retting*) në Çile (1990-1991), i përbërë nga katër përkrasës dhe nga katër oponent në ish kryetarit Pinoçe, ia kushtuan një pjesë të raportit përfundimtarë analizës konkrete të situatës e cila solli te puçi ushtarak me 11 shtator 1973 dhe, menjëherë pas kësaj, një pjesë e raportit për hulumtimin e karakteristikave të sistemit politik në periudhën nga viti 1973 deri në vitin 1988

dhe pajtimin (komisioni *Rettig*) në Kil, (1990-91), e përbërë me nga katër anëtarë që pajtoheshin, dhe nga katër që ishin kundër kryetarit Pinoqe, ia ka kushtuar një pjesë të raportit përfundimtar analizës konkrete të situatës e cila ka sjellë deri te puqi ushtarak, me 11 shtator 1973, dhe menjëherë pas kësaj, një pjesë të raportit ia ka kushtuar hulumtimit të karakteristikave të sistemit politik të periudhës prej vitit 1973 deri 1988 (koha e sundimit të Pinoqes) të cilat e kanë praktikuar shkeljet e te drejtave të njeriut.⁶⁹ Si dhe në raport me aspekte të tjera të punës së KOMRA-së, lidhur me këtë çështje, vendimtare do të jetë edhe ajo që për anëtarë të Komisionit të jenë të zgjedhur individët me integritet, të cilët me punën e tyre do të jenë të udhëhequr me përkushtim ndaj të vërtetës (shiko nenin 9, Parimet e veprimit të Komisionit), dhe jo dëshira që përmes veprimit në KOMRA të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të caktuara politike.

Në raport me rrezikun e dytë, mundësia që hulumtimi i shkaqeve të sjellin deri te marrja me periudhën e largët historike, çka Komisionit do ti merrte shumë kohë – Statuti në vete përmban dy variante, të cilat janë pasqyruar në detaje, në sqarimin e nenit pasues në Statut (neni 15, “periudha kohore dhe kompetenca territoriale e Komisionit”). Duhet theksuar se këtu nuk kemi të bëjmë me vërtetimin e shkaqeve të cilat sollën deri te shkatërrimi i RSFJ-së, por me vërtetimin e shkaqeve të konflikteve të armatosura dhe kryerjes së krimeve të luftës, dhe atë, për ato shkaqe të cilat bindshëm kontribuuan në shpërthimin e konflikteve. Ngushtimi apo zvogëlimi i rrethanave të cilat i hulumton KOMRA, të atyre të cilët bindshëm kanë kontribuar në shpërthimin e konfliktit dhe kryerjen e krimeve, i largon nga fushëveprimi i hulumtimit të Komisionit, hulumtimin e rrethanave tjera të cilat nuk kanë qenë të rëndësishme.

Pika g.

Detyra e Komisionit për te rekomanduar masat të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljes së të drejtave të njeriut ka të bëjë, para së gjithash me rekomandimet mbi reformat në institucione dhe legjislacion, posaçërisht në raport me reformat me përmbajtjet arsimore – edukative. Përveç kësaj, *pika g.* shtron për detyrë të Komisionit edhe hartimin e rekomandimeve të cilat kanë të bëjnë me reparacionet materiale (kompensimet me të holla, rehabilitimi psiko-fizik, riparimi dhe kthimi i pasurisë, e të tjera), dhe reparacione simbolike (ngritja e përmendoreve, shndërrimi i vendeve të burgosjes ose i vendeve të vrasjeve në qendra memoriali, komemorative etj.), me çka do të arrihej qëllimi i Komisionit – “kontribut në realizimin e të drejtës së viktimave” (neni 11, paragrafi e).

(periudha e pushtetit të Pinoçetit) që gjeneruan praktikën e shkeljes së te drejtave të njeriut (*konsulto Corporacion Nacional de Reparacion y Reconciliacion, informe de la Comision Nacional de Verdad y Reconciliacion (Andros Impresores, reedicion 1996)*, Vëllimi I., kreu 2, pjesa 1, faqe 27-46, http://www.ddhh.gov.cl/ddhh_rettig.html).

⁶⁹ Videti Corporacion Nacional de Reparacion y Reconciliacion, *Informe de la Comision Nacional de Verdad y Reconciliacion* (Andros Impresores, reedicion 1996), tom I, kapitulli 2, pjesa 1, fq. 27-46, www.ddhh.gov.cl/ddhh_rettig.html.

PJESA E V. – KOMPETENCA E KOMISIONIT

Neni 15.

Kompetencat kohore dhe territoriale

Sqarim

Periudha në të cilën janë kryer krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut nga domeni i hulumtimeve të KOMRA-së fillojnë nga data 1 Janar 1991, dhe përfundojnë me datën 31 Dhjetor 2001. Kjo kornizë kohore përfshinë të gjitha vitet në të cilat, gjatë dhe pas shkatërrimit të ish Jugosllavisë, janë zhvilluar konflikte të armatosura, qoftë të karakterit ndërkombëtar (“lufta”), qoftë edhe konfliktet e brendshme. Konflikti i parë i armatosur, në kuptimin e plotë të këtij nocioni, ka filluar kah mesi i vitit 1991 në Kroaci dhe Slloveni, ndërsa i fundit – ai në Maqedoni – ka përfunduar në nëntor të vitit 2001.

Gjatë procesit konsultativ, disa pjesëmarrës ishin të mendimit që Komisioni do të duhej të merrej me hulumtimin e krimeve të luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut duke filluar nga viti 1990, me argumentin që qysh nga muaji Qershor i të njëjtit vit, në Kroaci ka ekzistuar gjendja e konfliktit të armatosur (gjegjësisht, se ka filluar “*Domovinski rat*” – “Lufta atdhetare”).⁷⁰

Mirëpo, qëndrimi i këtillë nuk është në përputhje me gjetjet e Tribunalit penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, në lëndët të cilat janë marrë me krimet e luftës në Kroaci, po ashtu as me definicionet e konflikteve të armatosura në të drejtën ndërkombëtare humanitare. Me fjalë të tjera “konflikti i armatosur”, në domethënien që e ka në të drejtën ndërkombëtare, nuk përfshinë situatat e trazirave dhe acarimeve të brendshme, siç janë të izoluarat edhe aktet sporadike të dhunshme, trazirat (Angl. *Riots*), dhe akte të tjera të natyrës së ngjashme.⁷¹ Për të folur për ekzistimin e konfliktit të armatosur, është e nevojshme që të ekzistojë një intensitet i dukshëm material i konfliktit, si dhe të organizuarit e dukshëm i formacioneve të armatosura në bazë të të cilave konflikti i armatosur dallon nga kryengritjet afatshkurtra, rregullimet ose banditizmi.⁷² Grupi punues për hartimin e Statutit është në pajtim me vlerësimet nga aktgjykimet e TPNJ-së që kushtet dhe intensiteti i organizimit, të cilat duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, ashtu që do të mund të flitej për ekzistimin e konfliktit të armatosur, në Kroaci, janë plotësuar në mesin e vitit 1991.⁷³ Kjo nuk do të thotë që Komisioni nuk do të mund ti vërtetojë

⁷⁰ Deklarimet e përfaqësuesve të shoqatave kroate të veteranëve të luftës Konsultimet nacionale dhe organizimi i shoqërisë civile, Zagreb, 1 qershor 2010.

⁷¹ Aktgjykimi i këshillit gjyqësor i TPNJ, në lëndën *Limaj dhe të tjerët* (nëntor 2005), paragrafi 87.

⁷² Aktgjykimi i këshillit gjyqësor i TPNJ, në lëndën *Tadić*, maj 1997 paragrafi 562; ⁷² Aktgjykimi i këshillit gjyqësor i TPNJ, në lëndën *Limaj dhe të tjerët* (nëntor 2005), paragrafi 84.

⁷³ Aktgjykimi i këshillit gjyqësor i TPNJ, në lëndën *Mrksić dhe të tjerët* (shtator 2007), paragrafi 422 konkludon që “konflikti ka filluar fund të muajit gusht të vitit 1991”, por nga teksti nuk është plotësisht e qartë se, këshilli gjyqësor me këtë rast a kishte parasysh fillimin e konfliktit në tërë Kroacinë, ose fillimin e konfliktit në Sllovinë lindore, territor në të cilin kanë ndodhë krimet nga akt akuzat kundër *Mileta Mrksić dhe të akuzuarve të tjerë*. Nga ana tjetër, aktgjykimi ITPNJ në lëndën e Milan Martić (qershor 2007) në paragrafin 344, thuhet që “betejat e armatosura në mes të Serbëve dhe Kroatëve kanë shpërthyer në muajin prill të vitit 1991, në territorin e Kroacisë. Nga muaji gusht i vitit 1991, armiqësitë janë intensive me kycjen direkt të APJ dhe forcave serbe SAO Krajina”.

faktet lidhur me ngjarjet nga viti 1990, nëse vlerëson se ato janë relevante për të ndriçuar “rrethanat politike dhe sociale të cilat bindshëm kanë kontribuar në shpërthimin e luftërave ose i formave të tjera të konflikteve të armatosura, si dhe kryerja e krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut”.

Kur është fjala për kufirin “e epërm” të mandatit kohor (data 31 dhjetor 2001), nuk është e kontestueshme që pas vitit 2001 në asnjë pjesë të shteteve të dala nga territori i ish RSFJ-së nuk kishte “konflikte të armatosura” në kuptim të drejtës ndërkombëtare. Mirëpo, edhe pas kësaj periudhe kishte raste të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut lidhur me konfliktet e armatosura nga periudha 1991 – 2001. Për shembull, intensiteti i dhunës masive kundër serbëve dhe romëve në Kosovë, në muajin mars të vitit 2004, me siguri se mund të sqarohet pjesërisht si reaksion në dhunën kundër shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve 1998 -1999 dhe më herët. Komisioni nuk mund të merret me këtë ngjarje, si dhe me kundër – dhunën ndaj Shqiptarëve dhe Goranëve në Serbi gjatë ngjarjeve të marsit në Kosovë, në bazë të asaj pjese të nenit 15 i cili ka të bëjë me hulumtimin e pasojave, krimet dhe shkeljet e të të drejtave të cilat janë shfaqë në periudhën pas vitit 2001.

Neni 16.

Shkeljet e ligjit në kompetencën e Komisionit

Sqarim

Shkelja e të drejtave nga kompetenca e Komisionit përfshinë veçanërisht format serioze – lidhur me konfliktet e armatosura në territorin e ish RSFJ-së – posaçërisht të shpërndara në formë të krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut. Siç është sqaruar në nenin 1 të Statutit (*Kuptimi i termeve në këtë Statut*), termi „krim luftime”, për shkak të kuptueshmërisë së formulimit, shfrytëzohet në kuptimin e gjerë, kështu që përfshinë si krimet e luftës në kuptim të ngushtë, po ashtu edhe krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin.

Krimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, me të cilat do të merret Komisioni, janë në nenin 16 të përfshira me formulim të përgjithshëm. Krimet konkrete dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, janë të dhëna në nenin 1 të Statutit, me ç’rast lista e krimeve dhe shkeljeve të radhitura nuk është e përmbyllur.

Komisioni do të vendosë në lidhje me atë se a do të kualifikoj krimet ligjërisht. Komisioni do të thirret në aktvendimet e gjykatës në të cilat krimet konkrete janë të kualifikuara ligjërisht (shih nenin 46 të Statutit).

Përveç krimeve të kryera në kontekstin e konflikteve të armatosura, Komisioni mund të merret edhe me ato shkelje të të drejtave të njeriut të cilat nuk paraqesin krime të luftës, e të cilat në rrethinat e caktuara kanë qenë shumë serioze dhe të përhapura. Psh; në Slloveni ka qenë shumë e shprehur çështja e të „shlyerëve“ të shtetasve jo Slloven – me prejardhje nga pjesët tjera të ish RSFJ-së – nga lista e

personave me vendbanim me shtetin e ri të pavarur. Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut, ka vërtetuar se refuzimi i autoriteteve sllovene për tua rregulluar statutin „të shlyerëve“, në rastin konkret me të cilin është marrë Gjykata, ka paraqitë ndërhyrja e paarsyetueshme e shtetit në të drejtën për jetë private, nga neni 8 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut.⁷⁴ Edhe pse në bazë të dokumenteve dhe literaturës ndërkombëtare ligjore, nuk mund të konstatohet me siguri se shkelja e të drejtës në jetë private paraqet „shkelje të rëndë ët ët drejtave ët njeriut“ (shih më lartë sqarimin e nenit 1, të Statutit), mund të argumentohet se në atë rast, me të vërtetë bëhet fjalë për shkelje të rëndë, kështu që „shlyerja“ e qytetarëve jo Slloven nga lista e qytetarëve me vendbanim, ka hyre në fushën e hulumtimit nga ana e Komisionit. Argumenti tjetër i mundshëm ne dobi të „të shlyerëve“ në mandatin e Komisionit është që më „shlyerjen“ apo fshirjen kanë qenë të goditura më së shumti pakicat, shtetet amë të të cilave gjenden në territorin e ish RSFJ-së, pastaj Romët, gjegjësisht që ka qenë një diskriminim sistematik në bazë etnie, që padyshim do të paraqet shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.⁷⁵

Përfshirja e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në mandatin e KOMRA-së, në praktike nuk do të paraqet ndonjë ngarkesë të madhe për Komisionin, me detyrat shtesë në krahasim me ato që Komisioni i ka lidhur me mbledhjen e fakteve për krimet e luftës. Siç është sqaruar në Sqarimin e nenit 1 (*Kuptimi i termeve në këtë Statut*), rrethi i shkeljeve të ët drejtave për të cilat ekziston koncenzusi që të hynë në kategorinë e „shkeljeve të rënda“ është i kufizuar në vrasje, robërim, burgosje jo ligjore, torturim, zhdukje të dhunshme, deportimin dhe zhvendosje të detyrueshme ët popullatës, dhe diskriminimi sistematik. Pasi që këso veprimesh ka pas në shtetet e dala nga ish RSFJ, në periudhën prej 1991 deri 2001, kanë karakteristikat e krimeve të luftës (përfshirë – në kuptimin e këtij Statuti – edhe krimet kundër njerëzimit), ato hynë në fushën e hetimeve të KOMRA-së në bazë të termit „krime të luftës“, në nenin 16. Me fjalë tjera, Komisioni gjithsesi do të duhej të merrej me këto vepra, gjegjësisht edhe nëse „shkeljet e rënda të ët drejtave“ nuk do të ishin në mandat. Përrjashtimet e rralla, gjegjësisht veprimet ët cilat kanë qenë lidhura me konfliktet e armatosura, por në fushën e gjerë të angazhimit të Komisionit do të mund të futeshin vetëm si „shkelje të rënda të të drejtave“, duke përfshirë disa nga krimet e kryera ndaj shqiptarëve në Kosovë pas muajit qershor 1999, diskriminimi sistematik (për të cilin do të mind të argumentohej se është zbatuar në disa pjesë të ish RSFJ-së, dhe me atë rast nuk ka paraqitë krim të luftës apo krim kundër njerëzimit), dhe eventualisht edhe ndonjë rast tjetër, por gjithsesi të kufizuara në sasi.

⁷⁴ Lënda Kurić dhe të tjerët kundër Sllovenisë (lënda br. 26828/06), gjykimi, 13. jul 2010., paragrafi 361 i 376.

⁷⁵ Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut, në lëndën Kurić, nuk ka hyrë në atë se a është në ndryshme trajtimi i qytetarit të ish –Yu në krahasim me trajtimin me shtetasit e huaj të tjerë, nga ana e Sllovenisë, paraqet diskriminim, sipas nenit 14 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Në fakt, Gjykata Evropiane, sipas rregullores, nuk hulumton se është shkelë neni 14 i Konventës nëse Gjykata paraprakisht ka vërtetu disa fakte tjera, rregullores substitutive nga shkelja e Konventës, (siq është në rastin Kurić, është shkelë neni 8). Gjykata e ka marrë këtë vendim në lëndën *Dudgeon kundër UK*, 4 E.H.R.R. 149 (1981), para. 67, dhe më vonë e ka përsëritë në gjykimet të shumta. Por, Gjykata e ka përmendë vendiminë Gjykatës Kushtetuese ët Sllovenisë, në ët cilën ajo gjykatë ka vërtetuar „se nuk ka pasë arsye objektive për trajtim ndryshe“ të qytetarëve të ish Yu, në krahasim me trajtimin që u bëhet shtetasve të huaj të tjerë. „Kjo është“ sipas Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, „gjithashtu e ka shkelë parimin e barazisë, nga neni 14 i Kushtetutës“ (cituar sipas paragrafit 368, lenda Kurić).

PJESA VI. – AUTORIZIMET E KOMISIONIT

Neni 17.

Marrja e deklaratave

Sqarim

Paragrafi 1.

Marrja e deklaratave është metoda themelore me të cilën, Komisioni për të vërtetën, arrin deri te njohuritë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Deklaratat në numrin më të madh, por jo kryesisht, merren nga viktimat. Në punën e KOMRA gjithashtu marrja e deklaratave do të jetë prej rëndësie të madhe edhe pse, për dallim po thuaj nga të gjitha Komisione tjera, KOMRA do të ketë në disponim një sasi të madhe të materialeve të shkruara (aktgjykimeve gjyqësore, dokumentacioni voluminoz të cilin e ka grumbulluar Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë , i cili gjendet në ueb faqen e Tribunalit, raportet e organizatave për të drejtat e njeriut etj.), të cilat tani më përmbajnë të dhëna mbi krimet e kryera si dhe shkelje të tjera. Edhe përkundër, tani më, gjykimeve të shumë numërta për krime lufte para gjykatave ndërkombëtare dhe vendore, një numër i madh i viktimave dhe dëshmitarëve nuk e kishin rastin për të dhënë deklaratë para cilit do trupi zyrtar. Prandaj, Komisioni do të ketë rastin që të hulumtojë (në kontekstin jashtë gjyqësorë), edhe krimet të cilat nuk janë proceduar para gjykatave, bile edhe krimet të cilat kanë mbetur të panjohura për mediet dhe organizatat për të drejtat e njeriut. Marrjen e deklaratave nga viktimat, do të iket nga mundësia që shumë prej mijëra dëshmimeve të rëndësishme të mbesin të paidentuara.

Përveç nga viktimat, Komisioni do merr deklarata edhe nga dëshmitarët, kryerësit (në masën me të cilën do të kenë vullnet të flasin), dhe, përfaqësuesit e institucioneve. Me termin “pjesëmarrës”, sipas *Kuptimit të termeve në këtë Statut (neni 1)*, mendohet në personat e dënuar sipas ligjit. Përkundër kësaj, personat për të cilët nuk është vërtetuar fajësia e tyre me procedurë ligjore, në këtë nene janë përfshirë në kategorinë “dëshmitarë”. Ata persona kanë të drejtë të mos përgjigjen në disa pyetje, nëse ato përgjigje do ti qonin ata në ndjekje penale (shih paragrafin 5, të këtij neni, dhe sqarimin).

Paragrafi 2.

Paragrafi 2 paraqet njërën ndër idetë themelore pas themelimit të KOMRA-së: që ai organ të nxjerrë autoritetin e tij nga qëllimet të cilat duhet ti realizojë dhe nga mënyra e kredibilitetit në të cilin vepron. Prandaj paragrafi 2, e vënë theksin në të priturën që personat të cilët ftohen nga Komisioni për të dhënë deklaratë, të përgjigjen në mënyrë vullnetare. Njëkohësisht, Komisioni duhet ta ketë në dispozicion *mundësinë* që dikush të paraqitet para Komisionit, edhe nëse ai i kundërvihet kësaj. Paragrafi 2 e autorizon Komisionin që të organet kompetente të prokurorisë të iniciojë procedurën për sigurimin e paraqitjes se personit apo shqiptimin e dënimit nëse ai person refuzon të japë deklaratë.

Dispozitat mbi detyrimin e dhënies së deklaratës janë të zakonshme në themelimin e akteve të komisionit për të vërtetën.⁷⁶ Dispozita të ngjashme përmbajnë edhe ligjet dhe rregulloret parlamentare në palët kontraktuese, Ligji në Kroaci për këshillet hetuese parasheh që „udhëheqësit dhe zyrtarët e tjerë të organeve shtetërore, personat përgjegjës dhe juridik dhe qytetarë tjerë janë të obliguar të dëshmojnë para komisioneve hetuese apo ti dhënë deklaratë për faktet që i kanë të njohura”.⁷⁷ Ligji i Kosovës për hetimet parlamentare parasheh që „dëshmitarët janë të obliguar të përgjigjen në ftesën me shkrim nga komisioni, për të dëshmuar”.⁷⁸ Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Malit të Zi, „organet shtetërore dhe organizatat tjera, si dhe individët janë të obliguar të japin të dhënat ... për të vërtetën, informatat dhe deklaratat të cilat i kërkon këshilli hetues, nga ”.⁷⁹ Rregullorja e Kuvendit Popullor i republikës së Serbisë, e autorizon Këshillin Anketues që „të kërkojë nga organet shtetërore dhe institucionet të dhënat ... dhe informatat, si dhe të marrë deklarata nga individët, të cilat u duhen atyre. Përfaqësuesit e organeve shtetërore dhe të institucioneve, janë të obliguar të përgjigjen në ftesën e Këshillit Anketues, gjegjësisht komisionit, të japin deklaratat, të dhënat dhe.”⁸⁰

Obligimi i dhënies së deklaratës nuk është absolute, gjegjësisht ekzistojnë përjashtime në rastet e kategorive të veçanta për persona të caktuar, si dhe në lidhje me çështje të veçanta në të cilat personat kanë të drejtë të mos japin përgjigje. (shih më poshtë, sqarimi në nenin 5)

Paragrafi 3.

Në obligimin e dhënies së të dhënave, është paraparë një përjashtim për viktimat, kur bëhet fjalë për vuajtjet e tyre dhe të familjarëve të tyre. Rregulli për vullnetin e mirë, pason nga ideja themelore për këtë Komision, si organ qëllimi i të cilit është që tu ndihmojë viktimave. Detyrimi i viktimave, që kundër vullnetit të tyre të flasin për ndodhitë e tyre traumatike, do të mund ti antagonizojë.

Paragrafi 4.

Shih më lartë, sqarimi i nenit 11, paragrafi 3 dhe 4.

Paragrafi 5.

Në ligjet për procedurat penale të të gjithë palëve kontraktuese janë paraparë rregulloret për (1) atë se cilët persona nuk mund të dëgjohen si dëshmitarë: personi i cili do ta shkelë detyrën e ruajtjes së fshehtësisë shtetërore, mbrojtësi i të akuzuarit për atë se çfarë i ka treguar i akuzuari atij si mbrojtësit të tij; personi të cilin e obligon profesioni i tij në ruajtjen e fshehtësisë – rrëfyesi fetar, avokati, mjeku, gazetari, etj, i mituri i cili nuk e kupton rëndësinë e të drejtës se nuk ka obligim të dëshmojë; (2) cilët janë personat e liruar nga obligimi për të dëshmuar; bashkëshorti ligjor dhe joligjor; rrethi i ngushtë familjarë; i adaptuari dhe adaptuesi; si dhe (3) të drejtën për të mos dëshmuar, në formën e përgjigjeve

⁷⁶ Obligimi i dhënies së deklaratës, mes tjerash, në aktet themeluese të komisionit: Afrika e Jugut, neni 39, prg e; Siera Leone, neni. 8, prg. 1, pika (d) i neni. 8., prg. 2; Timori Lindor, neni. 20, prg. 1; Gana, neni. 22, prg. 1; Paraguaji, neni. 5; Kenia, neni. 7, prg. 5; i, Mauriciusi, neni. 11 dhe 16.

⁷⁷ Ligji për këshillet hetuese, *Narodne novine Rep. Kroacisë*, nr. 24/96, neni. 16, prg. 1.

⁷⁸ Ligji nr. 03 L-176, për hetime parlamentare, *Sl. list Rep. Kosovë*, nr. 74/2010., 20. gusht 2010., neni. 19, prg. 6.

⁷⁹ Rregullorja e Kuvendit të Malit të Zi, *Sl. list Rep. Mali I Zi*, nr. 51/06 dhe 66/06, neni. 81.

⁸⁰ Rregullorja e punës së Parlamentit të Republikës së Serbisë, 28. korrik 2010., neni. 68, prg. 6 i 7.

në pyetjet e caktuara, nëse ajo përgjigje do ta ekspozonte personin apo të afërmit e tij ndaj turpits apo ndaj ndjekjes penale⁸¹

Komisioni do të, në pajtim me parimet e procedurës së drejtë, (neni 10, paragrafi (f), i Statutit), respektoje këto parime të procedurës penale. Pos kësaj, në pajtim me paragrafin 4 (në nenin 17), në rastin kur sipas vendimit organit zyrtarë është deklaruar si informatë e fshehtë, dhe nëse personi thirret në obligimin ligjor të ruajtjes së fshehtësisë, ai megjithatë ka obligim të japë deklaratë para Komisionit nëse bëhet fjalë për të dhënat të cilat *nuk vlerësohen* si fshehtësi, sepse kanë të bëjnë me krimet e luftës apo shkeljet e rënda të ët drejtave të njeriut.

Paragrafi 6.

Mbrojtja e konfidencialitetit është njeri nga parimet e veprimtarisë së Komisionit, nga neni 10, i Statutit. Në pajtim me këtë parim, Komisioni ka të drejtën të garantojë mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve, të cilët kanë frikë të bazuar nga ajo se jeta e tyre do të mund të rrezikohet, integriteti fizik dhe psikik apo pasuria e tyre, do të mund të rrezikohen, nëse identiteti i tyre do të publikohet në shkresat apo raportet e Komisionit. Ky lloj i mbrojtjes së identitetit, i mundëson Komisionit të marrë numër më të madh të deklaratave dhe dëshmitë për ngjarjet e caktuara, me hulumtimin e të cilëve merret, me ç'rast sjellja e tillë e Komisionit nuk është në kundërshtim me ligjet ekzistuese në shtetet kontraktuese. Në fakt, të gjitha shtetet i parashohin veprat penale „mosparaqitja e veprës penale dhe pjesëmarrësit”,⁸² me atë vepër penale nuk është paraparë obligimi i paraqitjes së *identitetit* të burimit prej nga është personi i caktuar, në këtë rast personi i cili vepron në emër të Komisionit, i cili ka mësuar për veprën penale dhe kryesin e saj.

Paragrafi 7.

Komisioni i fton dëshmitarët për të dhënë deklaratat në përputhje me rregullat për të ftuar dëshmitarët, të sanksionuara në ligjet për procedurat penale në palët kontraktuese, që nënkupton edhe thirrjen përmes telefonit dhe mjeteve tjera elektronike për komunikim, nëse dëshmitari pranon që në thirrje të

⁸¹ Për shembull, Ligji për procedurë penale, *Sl. list CG*, nr. 57/2009, 49/2010, neni. 108-111.

⁸² Për shembull, Ligji penal, *Sl. list Rep. Mali i Zi*, nr. 70/2003, 13/2004, 47/2006, dhe *Sl. list Mali i Zi*, nr. 40/2008 i 25/2010, neni. 386 (“Mosparaqitja e veprës penale dhe kryesit”):

(1) Kush dinë se ndonjë person ka kryer vepër penale, për të cilën sipas ligjit mund të shqiptohet dënimi me burgim prej dyzet vjetë, apo dinë vetëm se një vepër e tillë është kryer dhe atë nuk e lajmëron, para se vepra apo autori të jenë akuzuar, do të denohet me burgim deri në dy vite.

(2) Me denimin nga paragrafi 1, të këtij neni, do të denohet personi zyrtarë apo personi përgjegjës, i cili me qëllim nuk e lajmëron veprën penale për të cilën ka marrë vesh se është kryerë gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare, nëse për atë vepër mund të denohet deri në pesë vite burgim apo dënim më të rëndë.

(3) Për mosparaqitjen e veprës penale apo të kryesit të saj, paragrafi 1 dhe 2, të këtij neni, nuk do të denohet personi i cili është bashkëshort i kryesit të veprës, apo me të cilin jeton në lidhje jashtëmartesore, është farefis i tij, vëlla apo motër, i adoptuar apo adoptuesi, mbrojtësi i tij, mjeku apo rrefyesi fetar.

tillë të përgjigjet.⁸³ Të ftuarit e dëshmitarëve, sipas rregullave, e ndërmarrin zyrat territoriale të Komisionit në palët kontraktuese të cilat, sipas nevojës, dhe me qëllim të vërtetimit të adresës së dëshmitarit, bashkëpunojnë me organet kompetente të Ministrive të punëve të brendshme të palëve kontraktuese. Për të qenë efikase ftesa e dëshmitarëve, Komisioni do duhej të sigurojë edhe shërbimin vetanak të dërgesave (njësia për dërgesa), e cila ftesat do i dorëzonte në përputhje me dispozitën përkatëse për thirrje të dëshmitarëve nga ligji i procedurës penale i shtetit kontaktues, dhe në atë mënyrë do të sigurojë dërgimin e rregullt. Nëse dëshmitari, i ftuar në mënyrë të rregullt, pa asnjë arsytim nuk i përgjigjet ftesës së Komisionit, me kërkesë të Komisionit, gjykata kompetente merr procedurë emergjente, mund të përcaktojë masat për të siguruar prezencën e dëshmitarit, duke përfshirë edhe dënimet procedurale, në përputhje me ligjet mbi procedurën penale të atij shteti.⁸⁴

Paragrafi 8.

Shtrohet pyetja, çfarë mund të bëjë Komisioni, nëse një person i thirrur në mënyrë të rregullt, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk i përgjigjet thirrjes së saj. Këtu duhet të theksohet një trend i praktikës së komisioneve për ët vërtetën, por edhe të atyre për hulumtime (apo „anketuese”), se mosardhja e paarsyeshme në ftesën e komisionit, në këtë rast pasojnë sanksionet. Shtetet ligjore siq janë Kanada, Austria, Zelanda e Re, Belgjika, Italia, Izraeli, Gjermania e tjera, parashohin sanksione për personat të cilët refuzojnë të japin informata komisioneve hetuese. Për shembull:

- Ligji i Zelandës së Re për komisionet hetuese parasheh që personi i cili nuk i përgjigjet ftesës së komisionit për të dëshmuar apo të ofrojë dokumentet e kërkuara, mund të dënohet me të holla në vlerë deri 1,000 dollarë, përpos kësaj mund të dënohet radhazi me nga shtatë ditë burg;⁸⁵
- Ligjet të cilët miratohen në parlamentin Italian, para themelimit të secilit komision hetues zakonisht parashohin të theksojnë që në dëshminë para komisionit aplikohet neni. 372 i Ligjit Penal; sipas atij neni, personi i cili refuzon ti japë të dhënat të cilat ai i di, dënohet me burgim prej dy deri në gjashtë vite;⁸⁶
- Ligji i Belgjikës për hetimet parlamentare parasheh dënimin ligjor me burg në kohëzgjatje prej 8 ditë deri në 6 muaj, së bashku me dënimin në të holla, për personin i cili refuzon të dëshmojë para komisionit hetues;⁸⁷

⁸³ Commissions of Inquiry Act 1908, Public Act 1908, No 25 (Ligji për komisionet hetuese 1908, Akti publik 1908, nr. 25), neni. 9 dhe neni. 13A (udhëzon në the Judicature Act 1908, dept 56B).

⁸⁴ Legge n. 132, "Istituzione di una Commissione parlamentare di inchiesta sul fenomeno della mafia e sulle altre associazioni criminali, anche straniere" (Ligji nr. 132, „Themelimi i komisionit parlamentar për hetimin e fenomenit të mafias dhe shoqatave tjera kriminale , duke përfshi edhe ato nga jashtë vendit“), *Gazzetta Ufficiale*, nr. 192, 18.gusht 2008, neni.4 (udhëzon në nenin. 372 Ligjit Penal); Legge, n.90, "Istituzione di una Commissione parlamentare d'inchiesta concernente il 'dossier Mitrokhin' e l'attività d'intelligence italiana" (Ligji nr.90, „Themelimi i komisionit parlamentar për hetimin e rastit 'dosja Mirokhin' dhe aktivitetet sekrete italiane“), *Gazzetta Ufficiale*, br. 109, 11. maj 2002, neni.3, st.1 (neni. 372 Ligjit penal).

⁸⁵ Loi sur les enquêtes parlementaires (Ligji për hetimet parlamentare),ka hyrë në fuqi 15. maj 1880.,n. 8.

⁸⁶ Commissions of Inquiry Laë, 5729-1968, čl. 11(e).

⁸⁷ Afrika e Jugit, neni. 39, st.e; Timori Lindor (2001), neni. 20, st.1; Gana (2002), neni. 22, st.1; Keni (2008), neni. 7, st.5; Mauricius (2008), neni. 11 dhe 16. Nga ana tjetër, aktet themeluese të komisioneve në Siera Leone dhe

- Ligji i Izraelit për komisionet hetuese parasheh dënimin deri në dy vite burgim, për personin i cili në mënyrë të përsëritur (vazhdueshme) refuzon të dëshmojë para komisionit, apo t'ia ofrojë dokumentacionin në shqyrtim.⁸⁸

Gjithashtu, akti themelues i disa komisioneve për të vërtetën, parashohin që refuzimi për të dëshmuar para komisionit, në mënyrë automatike pason dënimi në të holla apo me burgim, me ç'rast dënimi me burgim në disa shtete mund të jetë deri në dy vite (Afrika e Jugut, Gana).⁸⁹

Këto përvoja kanë filluar të sjellën edhe në vendet post-jugosllave, të cilat veprimtarinë e komisioneve hetuese parlamentare e rregullojnë me ligj:

- Ligji në Kroaci për komisionet hetuese, parasheh dënimin në të holla prej 50 mijë kuna (ekuivalente me 6.750 euro), deri në një milion kuna (rreth 135.000 euro), apo dënimin me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vite, për personat të cilët nuk i përgjigjen ftesës së komisionit hetues për të dëshmuar ose njoftuar për informatat të cilat i dinë ata.⁹⁰
- Ligji në Kosovë për hetimet parlamentare, e autorizon komisionin anketues që të urdhërojë sjelljen e obligueshme të personave në funksione publike, dhe personave tjerë fizik dhe juridik, për të dëshmuar para komisionit.⁹¹ Ligji gjithashtu parasheh zbatimin në pajtim me dispozitat e Kodi penal për dëshmitarët, si dhe obligimin e Gjykatave, që të sjellin dëshmitë sipas ët cilave personi fizik dhe juridik refuzon të dorëzojnë apo vonohen në atë çështje;⁹² dhe në fund, Ligji autorizon komisionin anketues që të kërkojë iniciimin e procedurës kundër dëshmitarit i cili nuk dëshmon në pajtim me obligimet e tij të parapara me dispozitat ligjore, Kodi i Procedurës Penale.

Paraguaj, ua kanë lene një të drjetë diskrete komisioneve që të inicojnë procedurën ligjore, apo jo. Siera Leone (2000), neni. 8.2.; Paraguaj (2003), neni. 5;

Loi sur les enquêtes parlementaires (Ligji për hetimet parlamentare), ka hyrë në fuqi 15. maj 1880., n. 8.

⁸⁸ Ligji për komisionet hetuese, *Narodne novine Rep. Kroacisë*, nr. 24/96, neni. 25.

⁸⁹ Ligji nr. 03 L-176, për hetimet parlamentare, *Sl. list Rep. Kosovës*, nr. 74/2010., 20. gusht 2010., neni. 13, tparagrafi 1.6.

⁹⁰ *Njejtë, neni. 18.* Ligji për komisionet hetuese, *Narodne novine Rep. Kroacisë*, nr. 24/96, neni. 25.

⁹¹ *Njejtë, neni. 19,* paragrafi. 10. Ligji nr. 03 L-176, për hetimet parlamentare, *Sl. list Rep. Kosovës*, nr. 74/2010., 20. gusht 2010., neni. 13, tparagrafi 1.6.

⁹² Në Serbi, Mal të Zi, dhe Kosovë, gjykata mund të urdhërojë, me procedurë penale, të sjellet personi i cili ka refuzuar të dëshmojë, dhe nuk e ka arsyetuar msoardhjen pata komisionit, dhe njëherish mund të shqiptojë dënimin në të holla, për te; në BeH Gjykata mund të shqiptojë njërën nga dy masat, në Kroaci mundet vetëm të urdhërojë që të sillet me detyrim, personi për të dëshmuar. Nëse personi vjen, dhe pasi të jetë njohtuar për pasojat, por nuk dëshiron të dëshmojë pa asnjë bazë ligjore, në të gjitha shtetet ai mund të gjobitete me të holla, në Kroaci, BeH, Malin e Zi, dhe në Kosovë, mund të arrestohet (më së shumti një muaj në Kroaci, BeH dhe në Kosovë, dhe rreth dy muaj në Malin e Zi. Ligji për vepër penale, *Sl. glasnik BeH*, nr. 3/03, ndryshimet e fundit 15/08, neni. 81 dhe neni. 268; Ligji për vepër penale, *Sl. list Mali i Zi*, nr. 57/2009 i 49/2010, čl. 119; Ligji për vepër penale, *Narodne novine Rep. Kroacisë*, nr. 152/08, 76/09, neni. 291; Ligji për vepër penale, *Sl. list UNMIK*, nr. 2003/26, ndryshimet e fundit *Sl Rep. Kosovës*, nr. 44/2008, neni. 167 i neni. 237, st.3; dhe, Ligji për vepër penale, *Sl. list SRJ*, nr. 70/01 i 68/02 i *Sl. glasnik Rep. Serbisë*, nr. 58/04, ndryshimet e fundit 72/09, neni. 108.

Në krahasim me shumicën e vendimeve në praktikën krahasuese, madje edhe me zgjidhjet në ligjet për komisionet hetuese parlamentare në Kroaci dhe Kosovë, neni 17, paragrafi 8, nga Statuti, parasheh autoritete relativisht të butë të Komisionit. Ajo mund të iniciojë te prokurori publik, ti propozojë gjykatës kompetente që me procedurë të shpejtë të përcaktojë masat, me të cilat sigurohet pjesëmarrja e personit dhe dhënia e deklaratës, duke përfshi edhe gjobat procedurale, në pajtim me Ligjin për procedurë penale të atij shteti. Masat për të cilat bëhet fjalë përfshijnë, varësisht prej shtetit, sjelljen e detyrueshme, dënimin me të holla, dhe (kur personi refuzon të dëshmojë) burgim deri në dy muaj. KOMRA nuk e ka për obligim që të kërkojë nga Gjykata të shqiptojë dënimin në të holla apo ndonjë dënim tjetër, por Komisioni mund ta bëjë këtë, nëse e vlerëson të përshtatshme. Gjykatës i takon për të marrë një vendim të tillë

Në praktikë, sipas nenit 17, paragrafi 2, nuk duhet pritë gjithnjë që Komisioni do të iniciojë procedurën, të paraparë sipas paragrafit 8, sepse nuk dëshiron të konsiderohet si organ i cili autoritetin e ndërton me iniciimin e masave represive. Por, Por, Komisioni duhet të ketë në dispozicion *mundësinë* që të organizojë sjelljen e ndonjë personi para Komisionit, edhe nëse ai kundërshton.

Autorizimet që i kanë një sërë komisionesh hetuese parlamentare, që nga përfaqësuesit e institucioneve dhe personave privatë të kërkojnë dhënien e informatave, dhe rregullimin me ligj të sanksioneve për personat të cilët refuzojnë t'i japin të dhënat, të mos bëjnë nga komisioni hetues dhe komisioni "gjykata". Mbetet evidente dallimi thelbësorë, që pavarësisht nga niveli i autorizimeve të cilat i posedon, komisionet hetuese dhe komisionet e të vërtetës – për dallim nga gjykatat – nuk mundin ti vendosin sanksionet për shkeljen e të drejtave, të cilat i hulumtojnë. Për tërë atë që u tha, janë të privuara nga t bazë të cilat kanë mund të dëgjohen nga disa pjesëmarrës të procesit konsultativ, nga autorizimi i KOMRA-së sipas nenit 17, paragrafi 8, e bënë KOMRA-në „gjykatë” (Paralele”).

Paragrafi 9

Ndihma psiko – sociale për viktimën, para, gjatë dhe pas dhënies së deklaratës, përfshinë dhënien e ndihmës nga ana e psikologut të Komisionit, Angazhimi i Komisionit që viktimave dhe dëshmitarëve tu gjejnë ndihmë profesionale të psikologut, jashtë vetë KOMRA-së, e kështu me radhë. Shumica e Komisioneve në kuadër të punës së tyre i kanë përfshirë edhe strukturat ndihmëse - psikologët dhe punëtorët socialë, të cilët u kanë ofruar ndihmë viktimave dhe dëshmitarëve, të cilët kanë dhënë dëshmitë Komisioneve. Në Kil dhe Argjentinë, në disa raste psikologët kanë ndejnë ulur pranë viktimave gjatë dhënies së deklaratës , para komisionit. Komisioni i cili e ka vlerësuar shumë lartë rëndësinë e dhënies së ndihmës psiko-sociale, para gjatë dhe pas dhënies së deklaratës, ka qenë Komisioni për të vërtetën në Afrikën e Jugut. Ky Komision, në punën e tij i ka përfshirë edhe punëtorët shëndetësorë, specialistët për çështjet e traumës, të cilët kanë ofruar trajnime për punonjësit e komisionit. Pos kësaj, në punën e saj ka inkuadruar edhe personat të cilët kanë ofruar ndihmën psiko-sociale viktimave dhe dëshmitarëve në dëshmitë publike.⁹³

⁹³ Priscilla B.Hayner, *Unspeakable Truths: Transitional Justice and the Challenge of Truth Commission* (2. botimi i dytë, 2010.), fq.157.

Paragrafi 10

Duke pasur parasysh që KOMRA, krahas grumbullimit të deklaratave në vendbanimet (vendqëndrimet) dhe zyrat e Komisionit do të vazhdojë të ofrojë mundësinë të gjithë personave për të dhënë deklarata të cilat janë të rëndësishme për vërtetimin e fakteve (provave), në pikën 8 të këtij paragrafi zgjerohen dhe iu epet mundësia personave të cilët jetojnë në territoret e vendeve të treta (jashtë territoreve të palëve kontraktuese), për të dhënë deklaratat në përfaqësitë diplomatike të palëve kontraktuese. Duke pasur parasysh faktin që të gjitha palët kontraktuese nuk kanë përfaqësitë e tyre diplomatike në një numër të caktuar të vendeve në të cilat mund të gjenden personat të cilët dëshirojnë për të dhënë deklarata, Komisioni do të kishte të drejtën që të grumbullojë deklarata edhe në ato vende, nëse një veprim i tillë nuk do të konsiderohej si shkelje e dispozitave ligjore të atyre vendeve, duke marr parasysh se KOMRA është organizatë ndërkombëtare e huaja e cila do të vepronte në territorin e vendeve të treta.

Neni 18.

Grumbullimi i dokumentacioneve dhe burimeve tjera

Sqarim

Paragrafi 1

Duke pasur parasysh se institucionet ndërkombëtare dhe vendore dhe organizatat, gjatë dhe pas luftërave, kanë grumbulluar një numër të madh të fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut, Komisioni do të mund të shfrytëzonte këto dokumentacione dhe në atë mënyrë do të lehtësonte rrugën deri të përmbushja e qëllimeve të vet. Neni 16 i Projektstatutit ofron mundësinë Komisionit që, krahas burimeve të theksuara, të shfrytëzoj dhe aktgjykimet gjyqësore, transkriptet dhe shkresat e gjykatave të tjera, p.sh. në Norvegji, Danimarkë, Gjermani, Austri etj), të cilat në bazë të kompetencës universale kanë gjykuar për krime lufte të kryera në territoret e ish Jugosllavisë. Gjithashtu, Komisioni ka të drejtë, me qëllim të vërtetimit të fakteve, të shfrytëzoj edhe prova të tjera, ose dokumentacione e cila shprehimisht nuk është përmendur në këtë dispozitë. Pika h i ofron mundësinë Komisionit që gjatë veprimit të vetë të kërkojë edhe mendime profesionale lidhur me çështje të caktuara (për shembull për sesione tematike që iu kushtohen veprimeve të institucioneve të caktuara), dhe sipas shembullit në dispozita relevante të komisioneve në Kanada, Gjermani, Marok dhe Peru.

Paragrafi 2

Organet shtetërore bashkëpunojnë me Komisionin, ashtu që në kërkesë të Komisionit, ia dorëzojnë asaj dokumentacionin, sipas nenit 18 të Statutit. Obligimi i dorëzimit të dokumentacionit, të organi jashtë-ligjorë, është e rregulluar me ligj në Kroaci dhe në Kosovë. Sipas Ligjeve në fuqi për komisionet hetuese në Republikën e Kroacisë, komisioni i themeluar hetimore „është e autorizuar të kërkojë nga të gjitha organet shtetërore, institucionet, shoqëritë tregtare, personave tjerë juridik dhe qytetarëve, që t’ia dorëzojnë në shqyrtim dokumentacionin, i cili do të mund të ishte i rëndësishëm për realizimin e detyrës

së saj” , ndërsa organet [e përmendura] dhe qytetarët janë të obliguar të veprojnë sipas kërkesave të komisionit hetimor”.⁹⁴ Në ligjin e Kosovës për hetimet parlamentare, është caktuar të themelohet komisioni parlamentar, e cila ka të drejtën të ketë qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet zyrtare” gjegjësisht „të gjithë personat fizik dhe juridik janë të obliguar që Komisionit t’ia dorëzojnë në shqyrtim të gjitha dokumentet dhe materialet si dhe faktet tjera, të cilat kërkohen nga ata”.⁹⁵ Në Malin e Zi, Ligji për administratë shtetërore, është konstatuar obligimi i ministrive „t’ia dorëzojë Kuvendit dokumentet, gjegjësisht dokumentet të cilat paraqesin fshehtësi zyrtare për shtetin, ushtrinë apo fshehtësi sipas ligjit të posaçëm”.⁹⁶ Dispozita e Rregullores së Kuvendit të Malit të Zi për hetimet parlamentare, është përcaktuar që „këshilli anketues ka të drejtë që, me qëllim të realizimit të hetimit parlamentar, të kërkojë nga organet shtetërore dhe organizatat e caktuara, të dhënat, dokumentacionin, lejet dhe informatat, si dhe të marrë deklarata nga individët, nëse këtë e vlerëson të dobishme. Organet shtetërore dhe organizatat tjera, si dhe individët janë të obliguar ti japin dokumente e vërteta, të rregullta, të dhënat, informatat dhe deklaratat të cilat nga ata i kërkon këshilli anketues.”⁹⁷

Obligimi i ngjashëm për bashkëpunim me komisionet, është i paraparë edhe në aktet themeluese bazë të komisioneve për të vërtetën, në të cilat është cekur se komisioni ka të drejtë ti kërkojë dhe ti marrë dokumentet e caktuara.⁹⁸ Kërkesat për dhënien e dokumentacionit janë treguar si të rëndësishme – si diçka që nuk shërben vetëm për individë, por edhe për institucione.

Neni 19.

Hulumtimet dhe vizitat në teren

Sqarim

Paragrafi 1.

Komisioni është i autorizuar që, me qëllim të grumbullimit e të dhënave të kryej edhe hulumtime në teren. Kjo është në përputhje me detyrimin e përgjithshëm të shteteve që të bashkëpunojnë me Komisionin, dhe në atë mënyrë ti mundësojnë kryerjen efikase të detyrave dhe qasje në të dhëna, (Neni 11 i Statutit).

Paragrafi 2.

Me lidhjen e memorandumit për mirëkuptim me organet kompetente shtetërore shmangët mundësia që organet e caktuara shtetërore si komisionet/zyrat për gjetjen e të zhdukurve dhe prokuroritë për

⁹⁴ Ligji për komisionet hetuese, *Narodne novine Rep. Kroacisë*, nr. 24/96, neni. 15.

⁹⁵ Ligji nr. 03 L-176, për hulumtime parlamentare, 4. jun 2010., *Sl. list Rep. Kosovës*, nr. 74/2010, 20. gusht 2010., neni. 13, st.1, paragrafi 4, i neni. 18.

⁹⁶ Ligji për administratë publike, *Sl. list Rep. Mali i Zi*, br. 22/08, neni. 73.

⁹⁷ Rregullorja e Kuvendit të Malit të Zi, *Sl. list Rep. Mali i Zi*, nr. 51/06 i 66/06, neni. 81.

⁹⁸ Kil, neni 4 (b) dhe (c); El Salvador, aneksi, “Poëers”, pikat (a), (b) i (c); Siera Leone, neni.8, st.1, paragrafi (a) dhe (b) Keni, neni.7, st.2, paragrafi (a).

krime luftë, ta konsiderojnë Komisionin si organ i cili vështirëson apo u përzihet në punën e tyre. Me memorandumet e mirëkuptimit mund të rregullohet procedura e njoftimit të organeve kompetente shtetërore për vizitën që do të bëhet në lokacionin e caktuar, apo varësisht nga rrethanat, kur nuk ka nevojë për një njoftim paraprak të tillë, procedura në rastin kur Komisioni ka për qëllim të shikojë objektet të cilat janë në pronësi private, dhe ngjashëm. Autoritetet shtetërore kompetente nënkuptojnë organet shtetërore relevante siç janë komisionet për gjetjen e të zhdukurve, prokuroritë dhe autoritetet kompetente të sistemit të burgimit, e jo organet shtetërore komunale apo policia.

Paragrafi 3.

Njëri prej qëllimeve të Komisionit është “pranimi i të padrejtës të shkaktuara ndaj viktimave, me qëllim të krijimit të kulturës së solidaritetit dhe dhimbjes dhe ngushëllimit me viktimat” (neni 11, pika d). Neni 2 i këtij neni kontribuon në realizimin e qëllimit të theksuar, prandaj, këtu nuk kemi të bëjmë me vizitat në lokalitete me qëllim të hulumtimit, por me vizitat që kanë si qëllim simbolik – pranimin e vuajtjeve dhe shprehjen e pietetit ndaj viktimave, duke përfshirë edhe viktimat të cilat kanë përjetuar krimet, (për shembull ish të robëruarit në vendin e burgosjes).

Neni 20.

Dëgjimi publik i viktimave dhe personave tjerë

Sqarim

Paragrafi 1.

Dëgjimi publik i viktimave nuk ka qëllim primar në grumbullimin e të dhënave nga ana e Komisionit por pranimin e padrejtësisë që iu është bërë këtyre personave, të i mundësohet opinionit që drejtpërdrejtë të fitojë njohuri lidhur me krimet, si dhe krijimit të një kulture të solidariteti dhe i dhimbjes dhe ngushëllimit për viktimat. Anëtarët e Komisionit, sipas rregullave, nuk do të duhej që me shtruarjen e pyetjeve plotësuese të verifikojnë vërtetësinë e pohimeve të viktimës. Kjo del nga qëllimi i dëgjimeve publike – pranimi i padrejtësisë dhe fuqizimi i dhimbjes dhe ngushëllimit me viktimat . Një qëllim të tillë do të ishte vështirë të për të realizuar nëse anëtarët e Komisionit të viktimave krijojnë ndjenjën se atij nuk i besojnë, Prandaj Komisioni nuk do të insistojë në precizimin e detajeve në pohimet-deklarimet e viktimës, për të cilat konsideron se viktimave nuk i ka përshkruar në mënyrë precize, ose të cilat nuk janë plotësisht të sakta, por nuk kanë të bëjnë me thelbin e deklarimeve të viktimës.

Gjithashtu në dëgjimin publik të viktimave nuk do të ekzistojë mundësia që personat të cilët janë përmendur si kryes, ose përfaqësues ligjor i atyre personave, që viktimave të iu parashtrorjnë pyetje me qëllim që ti kontestojnë pohimet e tyre. Dhënia e një mundësie të tillë “të hulumtimeve të tërthorta” në mas të madhe do tija përfaqësojë procedurës para Komisionit në procesin gjyqësor. Me këtë do të vihej

në pyetje, ose do të eliminohej, kuptimi i veprimit të Komisionit si trup jashtë gjyqësorë i fokusuar, para së gjithash, në viktimat dhe jo në kryerësit (siç është gjykata).

Për çdo rast, është me rëndësi që të sigurohet që deklarimi i viktimës të jetë i vërtetë, dhe posaçërisht që të evitohen mundësitë që viktima në pohimet e tija të akuzojë pa bazë persona të pafajshëm kinse si kryerës. Për këtë qëllim Komisioni do të verifikojë vërtetësinë e deklaratës para se të vendos se cilat viktima do të paraqiten në dëgjimin publik, në mënyrë që deklaratën, të cilën viktima paraprakisht iu ka dorëzuar hetuesve të Komisionit, do ti krahason me informata të tjera të cilat i ka grumbulluar. Nëse viktima, gjatë dëgjimit publik prezanton pohime në kundërshtim me ato të dhëna në deklaratën paraprake pranë Komisionit, ose shtron pohime tjera të cilat janë në kundërshtim me njohurit që disponon Komisioni për ngjarjen, anëtarët e Komisionit, lidhur me atë, viktimës do i shtrojnë edhe pyetje konkrete.

Komisioni, në formë shtese do të sigurojë respektimin e të drejtave të personave të cilët në dëgjimin publik të viktimave (si para, ose pavarësisht nga ajo, edhe me rastin e dhënies së deklaratës), janë emërtuar si kryerës, me çka do të iu mundësohet që më pastaj të lajmërohen para Komisionit dhe të prezantojnë versionin e tyre mbi ngjarjen, ose/dhe të dorëzojnë deklaratën në formë të shkruar të cilën Komisioni do e merr në konsideratë me rastin e hartimit të raportit përfundimtarë. (Shiko Sqarimin e nenit 46- *“gjetjet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut”*).

Paragrafi 2.

Në dëgjimet publike, përveç viktimave, mund të flasin edhe dëshmitarët e krimeve të luftës, përkatësisht për shkeljeve të rënda e të drejtave të njeriut, kryerësit të veprave të tilla si dhe personat që iu kanë ndihmuar viktimave.

Kur është fjala për dëgjimet publike për kryerësit dhe dëshmitarët, mund të pritët që nga anëtarët e Komisionit të shtrohen pyetje, me të cilat do të pretendohet që të identifikohen dhe të eliminohen paqartësitë ose pohimet e pasakta në deklarata. Ky dallim në tretman, në raport me tretmanin ndaj viktimave, rrjedhë nga dallimet në qëllimet e dëgjimeve publike të tipave të ndryshme. Qëllimi, për të cilin dëshmitarët dhe kryerësit flasin publikisht, nuk është që të iu shprehet mirënjohje, përkatësisht që të shprehet pietet, por që komisionit dhe opinionit të gjerë ti mundësohet që të fitojnë njohuri mbi krimet, gjegjësisht për shkeljet e rënda e të drejtave të njeriut.

Në praktikën e komisioneve për të vërtetën, relativisht një numër i vogël i personave përgjegjës për shkelje të rënda të drejtave të njeriut ka marrë pjesë në dëgjime publike. Ky përjashtim ka të bëjë edhe në shtetet në të cilat, para fillimit të punës të Komisionit për të vërtetën, është shpallur amnistia (Siera Leone), ose vetë komisionet kanë mundur të ofrojnë amnistinë (Afrika e Jugut (për vepra të rënda më të vogla) Timori Lindorë). Në ato raste, përgjegjësit për shkeljen e të drejtave nuk kishin frikë nga mundësia që do të përgjigjeshin penalisht nëse publikisht flasin mbi rolin e tyre në kryerjen e krimeve, ose në të folurit publik kanë vërejtur rastin që të përfitojnë nga amnistia, ose për fillimin e ri-integrimit të tyre në bashkësinë e tyre. Kur është fjala për KOMRA, ekziston mundësia që në dëgjimet publike të pranojnë të paraqiten një numër i konsiderueshëm i kryesve, et cilët gjenden në kryerjen e dënimit të burgimit, apo veç e kanë kryer, e të cilët e kanë pranuar fajin para MKTJ-së, apo para gjykatave vendore, dhe kanë

shpreh pendimin, dhe gjithashtu kanë shpreh gatishmërinë për në të ardhmen që kontribuojnë në pajtim. Gjithashtu, është e mundur, që personat fajësia e të cilëve nuk është vërtetuar në procedurën penale, i drejtohen me iniciativën e tyre Komisionit, e pranojnë kryerjen e veprave, dhe shprehin gatishmërinë që për këtë të flasin në dëgjimet publike. (Këta persona janë në nenin 20, paragrafi 2, si dhe në nenin 17 (*Marrja e deklaratave*), të përfshirë në kategorinë e "dëshmitarit

Për dëgjimin e dëshmitarëve, gjithashtu vlen ajo çfarë është thënë më lartë për dëgjimin e viktimave, posaçërisht në raport me verifikimin paraprak të vërtetësisë së pohimeve si dhe në kuptim të mundësisë të personave të përmendur si kryerës që më pastaj të deklarohen lidhur me pohimet kundër tyre.

Qëllimi i dëgjimeve publike të personave që iu kanë ndihmuar viktimave është i ngjashëm me qëllimin e dëgjimeve publike për viktimat, në atë masë sepse në të dyja rastet kemi të bëjmë, në mes të tjerash, për dhënien e pranimeve nga ana e Komisionit: pranimi i padrejtësisë dhe vuajtjeve në raport me viktimat, dhe pranimi i humanitetit dhe etikës, kur është fjala për personat të cilët iu kanë ndihmuar viktimave. Prandaj, duhet pritur që qëndrimi i anëtarëve të Komisionit gjatë dëgjimit të personave të cilët iu kanë ndihmuar viktimave të jetë i ngjashëm me qëndrimin gjatë dëgjimit të vetë viktimave.

Paragrafi 3.

Dispozita e Statutit mbi dëgjimet publike përcakton që dhënia e deklaratave në këto ngjarje është në baza vullnetare. Një rregull e tillë nënkuptohet edhe në raport me viktimat, por mund të jetë dukshëm më e vogël kur është fjala për dëshmitarët dhe, posaçërisht, kryesitë e supozuar. Mirëpo, sjellja me dhunë dhe shqiptimi i dënimit ndaj personave të cilët nuk dëshirojnë publikisht, para kamerave të dëshmojnë për krimet do të ishte koftra produktive për vetë statusin e Komisionit. Ai do të kuptohej si trup autoritar, çka do të ishte në kundërshtim me detyrat themelore të Komisionit si trup i cili shpenzon fuqinë e tij nga legjitimiteti i misionit, por jo nga kërcënimet me represion. Kur është fjala për kryerësit e supozuar të cilët akoma nuk janë proceduar, ata gjatë dëgjimit publik – si dhe me gjykimet në procedurat penale – në të cilat janë paraqitur kundër vullnetit të tyre mund të thirren në të drejtën që të ngurojnë (shkurtojnë) përgjigjet në mënyrë që ata, ose të afërmit e tyre, të mos iu ekspozohen ndjekjeve penale, turpit të rëndë, ose dëmeve të konsiderueshme materiale.

Paragrafi 4.

Dispozitë e Statutit për zbatimin e masave për mbrojtjen e identitetit, masave të posaçme të mbrojtjes për integritetin psikik dhe fizik, si dhe masa e mbështetjes psiko-sociale në dëgjime publike, ka për qëllim të mundësojë që viktimat dhe dëshmitarët në çdo kohë gjatë dëgjimit publik të ndjehen të sigurt . Komisionet e tjera kanë përfshirë edhe masa të tilla në punën e tyre. Komisioni për të vërtetën në Afrikën e Jugut në punën e tij ka përfshirë njerëzit që u kanë ofruar mbështetje psiko-sociale për viktimat dhe dëshmitarët në dëshmi dëgjimet publike, të ashtuquajturat ". briefers", të cilët u shpjeguan njerëzve procedurat e dëgjimit publik, kanë ndejë ulur pranë tyre gjatë dëshmisë, dhe kanë kaluar një kohë me ta pas dëgjimeve publike, duke i inkurajuar ata. Praktikën e komisioneve jugo-afrikane, më vonë e kanë marrë edhe komisionet tjera të cilat në punën e tyre kanë përfshi dëgjimet publike – ato të

Perusë, Marokos, madje edhe ato komisione të cilat gjatë punës së tyre janë ballafaquar me probleme të mëdha, siç janë mungesa e kapaciteteve të personelit për kryerjen e detyrave.⁹⁹

Paragrafi 5.

Obligimet e Shërbimeve publike në të gjitha shtetet trashëgimtare është që të sigurojnë transmetim televiziv nga dëgjimet publike, veprimi në përputhje me një obligim të tillë thellësisht nuk do të ishte ndryshe nga plotësimi i obligimeve të parapara me ligj për Shërbimet publike që, për shembull, kanë përmbajtjet e destinuara për pakicat nacionale. Me fjalë të tjera, sanksionimi – përmes ligjit ose kontratës së ratifikuar ndërkombëtare – obligimet e tipit programor për servil publik nuk del nga kornizat praktike të cilat tani më ekzistojnë në shtetet në regjion.

Komisioni nuk mund të obligojë mediet komerciale që të transmetojnë dëgjimet publike, por nuk mund të iu shkurtojnë të drejtën që të transmetojnë dëgjimet, nëse ata vet e vlerësojnë se një gjë e tillë është e rëndësishme.

Neni 21.

Mbajtja e sesioneve tematike

Sqarim

Pjesëmarrësit e shumë gjatë procesit konsultativë kanë theksuar rolin potencialisht të rëndësishëm të Komisionit në verifikimin- hetimin e rolit të institucionit në raport me krimet e kryera në periudhën nga viti 1991 deri në vitin 2001.

Disa Komisione të gjertanishme kanë mbajtur sesionet në të cilat anëtarët e komisioneve kanë hetuar përfaqësuesit e institucioneve mbi rolin e atyre institucioneve gjatë konflikteve.¹⁰⁰ Institucionet, ose pjesë e tyre, në mënyra të ndryshme ishin pjesëtar në shkeljen e të drejtave të njeriut. Mirëpo, disa prej komisioneve të cilat kanë reflektuar edhe në shembuj pozitiv të institucioneve të cilat iu janë kundërvënë shkeljeve të të drejtave.¹⁰¹

Komisioni Afrikan jugor për të vërtetën dhe pajtim, në sesionet publike institucionale, ka analizuar veprimet e institucioneve të rëndësishme ose pjesëve të shoqërisë- bashkësive fetar, bashkësive të

⁹⁹ Priscilla B.Hayner, *Unspeakable Truths: Transitional Justice and the Challenge of Truth Commission* (2. izdanje, 2010), str. 157.

¹⁰⁰ Shembujt përfshijnë komisionet në Afrikën e Jugut Siera Lione dhe Liberi.

¹⁰¹ Për shembull Komisioni në Peru, në bazë të numrit të madh të dëshmive të grumbulluara, dëgjimeve dhe studimeve ka vërtetuar që Kisha katolike Evangjeliste ka kontribuar në mbrojtjen e p popullsisë nga krimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut gjatë periudhës së dhunës. Për më shumë, kisha katolike shumë herët ka gjykuar dhunën të cilën e kanë ndërmarrë kryengritësit, por edhe shkeljen e të drejtave të njeriut nga ana e shtetit. Shiko *Conclusiones Generales del informe Final de la CVR* ("Konkluzat e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në Peru (2003) paragrafi 141 <http://www.cverdad.org.pe/ifinal/conclusiones.php>

juristëve, ekonomistëve, shëndetësore, medieve sindikatave, burgjeve dhe forcave të armatosura.¹⁰² Në këto sesione, anëtarët e komisioneve kanë hetuar jo vetëm përfaqësuesit e medieve dhe institucionet e tjera, por edhe ekspert që kishin njohuri për veprimet e tyre, si dhe përfaqësues të pushtetit aktiviteti i të cilëve kishte ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e këtyre sektorëve, Me analizimin e veprimit të medieve gjatë luftës në Liberi është marr Komisioni i atjeshëm për të vërtetën dhe pajtimin, i cili ishte fokusuar në raportim në media gjatë konfliktit, sfida me të cilat mediet janë ballafaquar gjatë periudhave të cilat ishin lëndë për hulumtime, etj.¹⁰³

Ashtu si edhe komisionet tjera KOMRA do të ketë mundësinë që të hetojë dhe analizoj veprimin e institucioneve shtetërore, por edhe të organizatave politike dhe kulturore, bashkësive fetare, dhe medieve para dhe gjatë konfliktit të armatosur, në raport me kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut. Siç kanë theksuar disa prej pjesëtarëve në konsultimet e mbajtura, veprimet jo vetëm të institucioneve shtetërore, por edhe institucioneve dhe organizatave tjera, siç janë bashkësitë fetare, mediet, organizatat politike dhe kulturore, paraqet njërin prej parakushteve kryesore për të kuptuar natyrën e luftërave, dhe posaçërisht të krimeve të luftës si dhe shkeljeve tjera të rënda të drejtave të njeriut në ish Jugosllavi.

Obligimi i pjesëmarrjes në sesionet tematike, nuk është rregulluar në mënyrë të veçantë në praktikën e këtyre komisioneve, të cilat i kanë mbajtur këso dëgjimesh, por është obligim i pjesëmarrjes e rregulluar përmes kompetencave me të cilat definohet obligueshmëria e dhënies së deklaratave para komisionit dhe pjesëmarrja në dëgjimet publike, nëse kështu e vlerëson komisioni.¹⁰⁴

Duke marr parasysh se sesionet tematike paraqesin një prej formave të dëgjimeve publike, Sqarimi i dhënë në nenin 20 (*Dëgjimet publike*) ka të bëjë në transmetimet televizive të sesioneve tematike të Komisionit (paragrafi 5), që është i zbatueshëm edhe në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 22.

Rregulloret e Komisionit

Sqarim

Zbatimi i metodologjisë unike në grumbullimin e deklaratave, dokumentacionit dhe organizimin e dëgjimeve publike dhe sesioneve tematike siguron konsistencën në punën e Komisionit në të gjithë regjionin, kontribuon në mënyrën të njëjtë në grumbullimin e të dhënave, dhe lehtëson përdorimin e mëvonshëm e të dhënave të grumbulluara për qëllim hulumtimi dhe të ngjashme, pas kryerjes së punës së Komisionit. Në këtë mënyrë do të mundësohet edhe të përmbushen detyrat e Komisionit.

¹⁰² Prisila B. Heiner (*Priscilla B. Hayner*), "*Të vërtetat e pa thëna*" (Samizdat B92,2003) faqe 68.

¹⁰³ Numri i konsiderueshëm i gazetarëve vendor dhe të huaj, si dhe ekspert për media, kanë dëshmuar në sesionet tematike të mbajtura në kryeqytetin e Liberisë, *Monrovi*. *Liberian TRC, Final Report, tom II. (Consolidated Final Report)*, faqe 48, paragrafi 4.11 dhe faqe 49.

¹⁰⁴ Afrika e jugut, neni.29 (3)(c).

Meqenëse marrja e deklaratave është fondamenti i punës të çdo Komisioni, dhe duke pas parasysh përvojat e komisioneve të mëhershme, hetuesit e të cilave kanë grumbulluar me mija deklarata të viktimave, dëshmitarëve, të autorëve të mundshëm, të mbijetuarve, me të dhëna për llojet e shkeljeve, viktimat, kryerësit, përgjegjësitë institucionale si dhe për detalet tjera të ndryshme, është e domosdoshme që të standardizohet mënyra në të cilën do të zhvillohen bisedat me dhënësit e deklaratave. Kjo është e nevojshme me qëllim të organizimit të një baze të dhënave dhe për të siguruar analizën e mëvonshme të tyre, çka paraqet sfidë duke marr parasysh me ardhjen e një numri jashtëzakonisht të madh të fakteve (provave).¹⁰⁵ Krahas kësaj, metodologjia unike siguron që pyetjet të cilat shtrihen me rastin e marrjes së deklaratave mbesin në kornizat e mandatit të Komisionit.¹⁰⁶

Rregulloret e Komisionit mund të parashohin metodologjinë për marrjen e deklaratave dhe grumbullimin e dokumentacionit. Kjo mundëson konsistencën e të dhënave të grumbulluara dhe shfrytëzimin e mëvonshëm të tyre me rastin e analizave të formularëve mbi krimet e kryera. Dokumentet e grumbulluara në bazë të metodologjisë me rregulla unike, paraprakisht të hartuar, mund të shfrytëzohen edhe për nevoja të procedimit penal, si dhe hulumtimeve historike, sociologjike dhe ligjore, lidhur me konfliktet e armatosura në hapësirat e ish RSFJ-së.

Nxjerrja e rregulloreve për dëgjimet publike dhe sesionet tematike do i mundësojnë Komisionit që më lehtë të zgjidhë problemet që kanë të bëjnë me organizimin e këtyre sesioneve, duke marrë parasysh që dëgjimet publike dhe sesionet tematike paraqesin “një sfidë jashtëzakonisht të madhe administrative, logjistike dhe financiare për komisionet për të vërtetën”.¹⁰⁷ Shfrytëzimi i metodologjisë unike në organizimin, demonstrimin, video dhe audio incizimet e këtyre sesioneve mundëson përdorimin e mëvonshëm për qëllime të ndryshme. Rregullorja për dëgjime publike duhet të rregullojë çështjet në vijim: mënyrën e përzgjedhjes së personave që do të dëshmojnë publikisht, rregullat për informimin e personave, emri i të cilëve do të lajmërohet gjatë dëshmimit, si dhe personat e dyshuar për krime të caktuara, rregulla që do të rregullojnë të drejtën e personave të tillë për tu përcaktuar ndaj pohimeve të thëna, masat mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat, mbështetja psikologjike për viktimat dhe dëshmitarët etj.¹⁰⁸

¹⁰⁵ Prisila B. Heiner (*Priscilla B. Hayner*), “*Të vërtetat e pa thëna*” (Samizdat B92,2003) faqe 310.

¹⁰⁶ Mark Freeman, *Truth Commissions and Procedural Justice* (Cambridge University Press, 2006) faqe 302.

¹⁰⁷ Njejtë, faqe 222

¹⁰⁸ Njejtë. Faqe 226

PJESA VII – ZGJEDHJA E ANTARËVE DHE ANTAREVE TË KOMISIONIT

Neni 23.

Përbërja e Komisionit

Sqarim

Komisioni për të vërtetën, të cilat konsiderohen në masë të madhe, ose të vogël, të suksesshme, kanë pasur më së shumti 17 anëtarë, me përjashtim të dy komisioneve, specifike, të Parlamentit Gjerman.¹⁰⁹

- Guatemala dhe El Salvador (nga 3 anëtarë);
- Timori Lindorë, Panamaja dhe Siera Leone (7);
- Çile (8);
- Gana dhe Paraguai (9);
- Peru (12);
- Argjentina (13);
- Republika Afrikano-jugore dhe Maroku (17);¹¹⁰ dhe
- Gjermania 1992-1994 (27), dhe 1995-1998 (36).

Përvojat e komisioneve të gjertanishme për të vërtetën, flasin në dobi të numrit të kufizuar të anëtarëve, në mënyrë që të lehtësohet komunikimi në mes të anëtarëve të Komisionit me qëllim të punës më efikase dhe efektive.¹¹¹ Natyrisht, në punën e çdo komisioni për të vërtetën, përveç anëtarëve/anëtareve (“Komisarëve”), janë të kyçur edhe një numër i madh i personave – personeli. Personeli, sipas rregullave, është shumë herë më i madh nga numri se sa vet anëtarët/anëtares e komisionit.

Është ofruar zgjidhje me të cilën, në krijimin e kushteve të tjera, të cilat janë sqaruar në vazhdim, duhet të jetë numri qift i anëtarëve. Një zgjidhje e tillë, siç shihet nga shembulli i komisioneve të deritanishme, nuk është pa precedencë. Edhe pse është e vërtetë që numri tek i anëtarëve, sipas rregullave, e lehtëson

¹⁰⁹ Komisionet Gjermane i ka themeluar Parlamenti i Republikës Federale Gjermane, dhe më shumë se 2/3 e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit janë përbërë nga deputetët. *US Institute for Peace, The Truth Commissions Digital Collection*, <http://www.usip.org/library/truth.html>.

¹¹⁰ Prisila B. Heiner (*Priscilla B. Hayner*) “*Truth Commissions: a schematic overview*”, *international Review of the Red Cross*, tom 88, nr. 862, qershor 2006, [http://www.cicr.org/web/eng/siteeng0.nsf/htmlall/review-862-p295/\\$File/irrc_862_Hayner.pdf](http://www.cicr.org/web/eng/siteeng0.nsf/htmlall/review-862-p295/$File/irrc_862_Hayner.pdf).

¹¹¹ “Njëra prej dobësive më të dukshme të komisioneve të mëdha paraqet koha dhe energjia e cila duhet përkushtuar për koordinimin dhe komunikimin në mes të anëtarëve. Komisioni i madh mund të ketë vështirësi të mëdha që të arrijë deri te përfundimet unanime dhe rekomandimet në fund të punës së vet” (Vendimit strategjike në rastin e themelimit të komisionit për të vërtetën, *Strategic Choices in the Design of Truth Commissions*, Projekti “Komisionet për të vërtetën”, janë krijuar në bashkëpunim të Programit për negociata të Fakultetit Ligjor të Harvardit dhe OJQ Serch for common Fround nga Uashingtoni, dhe European Centre for Common Ground, nga Briseli, <http://www.truthcomission.org/about.php?lang=en>).

vendimmarrjen dhe e pamundëson rezultatin “barazim”, rregulla e paraparë e vendimmarrjes të Komisionit në mënyrën e shumicës së kualifikuar (14), këtë problem e anashkalon.¹¹²

Para sqarimit të numrit të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, të cilët zgjidhen nga ana e palëve kontraktuese, duhet theksuar që KOMRA duhet të jetë një trup i cili është i paanshëm dhe i pavarur nga politikat shtetërore, do të thotë trup anëtarët dhe anëtares e të cilit veprojnë në cilësinë personale, në vend që të përfaqësojnë shtetet.¹¹³ Prandaj, në parim, nuk do duhej të ishte e rëndësishme se sa anëtar janë zgjedhur në cilin shtet, sepse ata, edhe ashtu nuk e përfaqësojnë shtetin. Mirëpo është reale që opinioni dhe elitat politike në secilin shtet do i japin rëndësinë edhe numrin të anëtarëve të komisionit, të cilët zgjedhen në shtetin përkatës. Përbërja e Komisionit duhet të jetë e atillë që opinioni politik dhe ai i gjerë publik ta përjetojnë si zgjidhje ndaj të cilit, nga shkaqet e arsyeshme, nga secili shtet në Komision zgjidhet edhe numri i paraparë i anëtarëve dhe anëtareve.

Statuti i KOMRA niset nga dy kritere për përcaktimin e numrit të anëtarëve të Komisionit të cilët zgjidhen në palët kontraktuese: 1) nga intensiteti i konfliktit të armatosur në territorin e palës kontraktuese, gjegjësisht në territorin në të cilin është zhvilluar konflikti dhe në të cilin shteti ka qënë i kyçur, si dhe pasojat e atyre konflikteve në pikëpamje, para së gjithash, të humbjeve në njerëz në territorin e palës kontraktuese, dhe 2) dhe nga nevoja që shtetasin e çdo shteti kontraktues të jenë në masë të kapshme të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në anëtarësinë e Komisionit.

1.) Pa marrë parasysh atë që numri i saktë i njerëzve të humbur në të gjitha shtet anëtare akoma nuk është vërtetuar zyrtarisht, sipas të dhënave në disponim është e qartë se Bosnja dhe Hercegovina (BIH) ka përjetuar shkatërrimet më të fuqishme dhe humbjet më të mëdha në njerëz, prandaj për këtë shkak është propozuar që në atë shtet të zgjidhet numri më i madh i anëtarëve të Komisionit (5). Gjithashtu, fakti që në territorin e sajë janë themeluar tani më dy komisione hetimore për lokalitete konkrete (Komisioni i RS për Srebrenicën dhe Komisioni për Sarajevën), dhe se në nivelin zyrtarë me të madhe bisedohet për themelimin e Komisionit për të vërtetën, është mjaft indikativ që mirëkuptimi për rëndësinë që ka, për atë shtet, vërtetimi i fakteve.¹¹⁴ Kroacia, Kosova dhe Serbia zgjedhin nga 3 anëtar të Komisionit, si dhe vendet në territoret e të cilave, në masë të përafërt janë zhvilluar konflikte të armatosura, ose kanë qënë në masë të konsiderueshme të kyçura në konfliktet në territoret e shteteve tjera. Mali i Zi, Sllovenia dhe Maqedonia zgjedhin nga 2 anëtarë duke pasur parasysh intensitetin e konflikteve në territoret e tyre, si dhe faktin që Sllovenia dhe Maqedonia nuk kanë qënë të kyçura në Kroaci dhe BeH, ndërsa Mali i Zi në ato konflikte nuk ka i përfshirë në masë më të vogël, krahasuar me Serbinë, (në të cilën zgjedhen tre anëtarë të komisionit).

2.) Nga ana tjetër ekziston nevoja që shtetasit e çdo pale kontraktuese të jenë në masë të duhur të përfaqësuar në anëtarësinë e Komisionit, në mënyrë që të evitohet që në ndonjë shtet Komisioni të

¹¹² Shiko nenin 31 të Statutit, Kuorumi dhe vendimmarrja

¹¹³ Shiko nenin 34 të Statutit, që parashohin të drejtat dhe obligimet e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, gjegjësisht pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre.

¹¹⁴ Iniciativa e parë për themelimin e Komisionit për të vërtetën në BIH është paraqitur në mbledhjen për drejtësinë dhe pajtimin në Strasburg në muajin korrik 1997, ndërsa iniciativën e dytë e ka nisur Instituti për po aq i Shteteve të Bashkuara në bashkëpunim me OJQ Dejtton në fund të vitit 2005. Në BH, në vitin 2010, është formuar grupi punues me detyrë të hartojë Strategjinë e të drejtës tranzisionale dhe planit të veprimit për zbatimin e sajë.

përjetohet si trup në të cilin ngjarjet nga ai shtet, dhe pjesëmarrja e shtetasve të atij shteti në punën e Komisionit, të kenë rëndësi të dorës së dytë. Prandaj numri i anëtarëve prej asnjë shteti nuk duhet të jetë më i vogël në mënyrë drastike nga numri i anëtarëve nga BH, çka gjithsesi do të ishte rasti nëse intensiteti i konflikteve dhe i numrit të viktimave do të ishte kriteri i vetëm.¹¹⁵

Numri i propozuar i anëtarëve, krahas asaj që do të duhej të jetë në përputhje me kriteret e përshkruara më parë, respekton edhe nevojën që numri i përgjithësim i anëtarëve dhe anëtareve të mos jetë aq i madh që Komisionin ta bëjë të ngathtë dhe trup jo efikas. Numri minimal i anëtarëve dhe anëtareve të cilët zgjedhën në ndonjë shtet është 2, dhe jo 3 (ose më shumë), sepse në rastin e dytë do të duhej të rritej edhe numri i anëtarëve dhe anëtareve të cilët zgjedhën në BH dhe gjetkë, kështu që numri i përgjithshëm do rritej deri në 30, ose në më shumë anëtarë dhe anëtare, çka do të pengonte efikasitetin, këmbimin e mendimeve dhe nxjerrjen e vendimeve.

Statuti nuk përmban opsionin sipas të cilit çdo palë kontraktuese do të zgjidhte numrin e njëjtë të anëtarëve/anëtareve të Komisionit. Zbatimi i parimit të tillë të paritetit, është e zakonshme te përfaqësimi i shteteve në organizatat ndërkombëtare (një shtet – një votë), mirëpo anëtarët/anëtares e KOMRA do të veprojnë në cilësinë personale, dhe jo si përfaqësues i shtetit. Përfaqësimi me paritet do të sillte deri te rezultati i cili është kontestues, duke marr parasysh temat me të cilat do të merret Komisioni, sepse, për shembull, numri i anëtarëve të Komisionit nga BIH do të ishte i njëjtë me numrin e anëtarëve/anëtareve nga Mali i Zi ose Sllovenisë, në të cilat nuk kishte konflikte të armatosura ose ishin afatshkurtra, ndërsa numri i viktimave është, pakrahasueshëm, më i vogël se sa në BH.

¹¹⁵ Parimi i propozuar për “përfaqësimin e barabartë në masë të duhur” për zgjedhjen e anëtarëve në KOMRE nga secili shtet – kontraktues, mund të krahasohet me parimin sipas të cilit çdo shtet – anëtarë i Unionit Evropian zgjedh shtetasin e vet në Parlamentin Evropian (PE), një prej trupave të Unionit, edhe pse krahasimet, natyrisht jo të përkryera – për shkak të dallimit dhe shkaqeve për themelimin, dhe për çështjet me të cilat merren këto dy organizata. Shtetet – anëtare me numër të madh të banorëve zgjedhin numrin më të madh të anëtarëve të PE nga shtetet më të vogla, por në atë rast nuk ekziston proporcionaliteti rigoroz. Për shembull Gjermania, me 82,3 milion banorë zgjedhë 4.5 herë më shumë anëtarë të PE nga Greqia, në të cilën jetojnë 10.7 milion njerëz (Gjermania zgjedhë 96, ndërsa Greqia 22 anëtarë të PE) Proporcionaliteti strikt në bazë të numrit të banorëve do të kërkonte që numri i anëtarëve të PE nga Gjermania të jetë 7.7 herë më i madh se numri i anëtarëve nga Greqia. Ngjashëm me këtë, Franca (me 64.4 milion banorë) zgjedhë 3.5 herë më shumë anëtarë të PE se sa Greqia (Franca zgjedh 74 anëtare ndërsa Greqia 22), edhe pse sipas numrit të banorëve raporti do të duhej të jetë 6:1. Prandaj, Parlamenti Evropian mundëson që shtetasit nga secili shtet – anëtar i BE-s të jetë në masë të kuptueshme, i përfaqësuar, në mënyrë të barabartë.

Neni 24.

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

Sqarim

Paragrafi 1, pika a. (nënshtetësia)

Është miratuar qëndrimi që ka mbisunduar në konsultimet që anëtarët dhe anëtarët e komisioneve të jenë personat që janë shtetas/shtetase të palëve kontraktuese, ndërsa të huajt duke përfshirë dhe përfaqësuesit e Organizatave ndërkombëtare t mos jenë anëtarë në Komision. Është lënë mundësia, në dispozitën e veçantë të Statutit të Komisionit (neni 39, paragrafi 3), që ekspertët e jashtëm të jenë të punësuar në Komision, si personel i tij, gjegjësisht të angazhuar si këshilltarë të Komisionit.

Paragrafi 1 pika b. (personi me cilësi të larta morale dhe autoritet, i përkushtuar për dialog tolerant dhe konstruktiv në zgjidhjen e kontesteve, i cili mund të gëzojë besimin në të gjitha palët kontraktuese).

Në aktet themeluese të Komisioneve për të vërtetën, ishte e zakonshëm që të parashihen cilësitë dhe karakteret të cilat do karakterizojnë anëtarët dhe anëtarët e Komisionit, dhe rasti i njëjtë është edhe me kontratat ndërkombëtare mbi bazën e të cilave janë themeluar trupat e pavarura gjyqësore dhe trupat e ngjashëm ndërkombëtar në të cilat veprojnë ekspertët pavarësisht dhe në mënyrë të paanshme nga interesat e shteteve, shtetas të së cilës janë. Kështu që, për zgjedhjen në Komitetin për të Drejtat e njeriut, në Kombet e Bashkuara, kërkohet që gjykatësit të kenë “karakter të lartë të moralit” (*high moral character*);¹¹⁶, i njëjti kusht parashtrohet edhe për gjykatësit në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut,¹¹⁷ ndërsa për anëtarët në Komitetin për të drejtat e fëmijëve, mund të zgjedhen vetëm „ekspertet me kriter të lartë të morali“ (*experts of high moral standing*).¹¹⁸ Integriteti dhe autoriteti janë gjithashtu cilësitë të cilat kërkohen dhe i atribuohen aktit të themelimit gati të të gjitha komisioneve të deritashme për të vërtetën: anëtarët e komisioni kanadez kanë qenë personat „me integritet të lartë të pranuar, të pozitës së lartë në shoqëri dhe me autoritet“ (*integrity, stature and respect*);¹¹⁹ anëtarët e komisionit të Liberisë kanë qenë „persona me kredibilitet, integritet të lartë dhe me autoritet“ (*credibility, high integrity and honour*);¹²⁰ anëtarët e komisionit peruan „persona me etike të dëshmuar, prestigj, dhe me legjitimitet në shoqëri, të cilët identifikohen me mbrojtjen e demokracisë“;¹²¹ anëtarët e komisionit kenian „persona me karakter dhe identitet“,¹²² dhe të ngjashme.

Në paragrafin 1, pika b., karakteristikat e parapara janë pjesërisht në përputhje me përshkrimin e anëtarëve dhe anëtareve të Komitetit për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, Komitetit për të drejtat e fëmijëve, Komitetit kundër torturës dhe gjykatësve të Gjykatës evropiane për të drejtat e

¹¹⁶ Pakti ndërkombëtarë për të Drejtat Civile, neni. 28, paragrafi. 2.

¹¹⁷ Konventa e Evropës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, përkthimi i Ligjit për ratifikimin e Konventës, nga Serbia dhe Mali i Zi, neni. 21, paragrafi.. 1.

¹¹⁸ Konventa për të drejtat e fëmijëve (Qendra Jygoslave për të drejtat e fëmijëve dhe UNICEF, Beograd, 1998,1999, 2001, 2002), neni. 43, paragrafi. 2.

¹¹⁹ Kanadaja, čl. 5.

¹²⁰ Liberia, pjesa 11.

¹²¹ Peru, neni. 4.

¹²² Kenia, neni. 10, st paragrafi.. 5, pika b.

njeriut. (“... personalitete me cilësi të larta morale...” nga neni 28, paragrafi 2 të Traktatit Ndërkombëtar mbi të drejtat qytetare dhe politike; “gjuqtarët duhet të kenë një autoritet të lartë moral...” neni 21, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, përkthim nga Ligji për ratifikimin e Konventës nga ana e Serbisë dhe Malit të Zi, “...ekspertët e vlerave të larta morale...” neni 43, paragrafi 2, Konventa për të drejtat e fëmijëve”(Qendra Jugosllave për të drejtat e fëmijëve dhe UNICEF, Beograd, 1998, 1999, 2001, 2001). Integriteti dhe autoriteti janë gjithashtu cilësi të cilat parashohin edhe aktet mbi themelimin, pothuaj, i të gjitha komisioneve të gjertanishme për të vërtetën: Anëtarët e Komisionit Kanadez kanë qenë personat “të integritetit të pranuar, të pozitës shoqërore dhe të autoritetit”; Anëtarët e Komisionit të Libërisë personat “me kredibilitet, integritet të lartë dhe të ndershëm”; Anëtarët e komisionit të Perusë “persona të njohur për etikë, prestigj dhe legjitimitet në shoqëri, të cilët janë të përkushtuar në mbrojtjen e demokracisë”; Anëtarët e Komisionit të Kenisë “Persona me karakter dhe dinjitet” dhe të ngjashme.

“Përkushtimi për dialog tolerant dhe konstruktiv në zgjidhjen e konteksteve” është një kualitet individual i cili gjer më tani nuk është përmendur në aktet themeluese të komisioneve për të vërtetën, por është i domosdoshëm për përmbushjen e qëllimeve të KOMRA-së në kushtet ku akoma kemi tensione dhe emocione të ngritura, ku kemi të bëjmë me debate për marrëdhëniet ndëretnike dhe konflikte në territorin e ish RSFJ.

Karakterit rajonal i Komisionit kërkon që anëtarët dhe anëtares të tij të jenë persona “që mund të gëzojnë besimin e popujve në të gjitha palët kontraktuese”. Arsyeja përse nuk është përdorur formulimi “persona të cilët gëzojnë besim...” qëndron në qëllimin që të mundësohet zgjedhja e jo vetëm atyre personaliteteve të cilat më janë të njohur për opinionin e gjerë në regjion, por edhe atyre njerëzve të cilët do të kenë mundësi të gëzojnë besimin kur për ta do të mund të dihet edhe jashtë kufijve të shteteve të tyre, për shkak se, për shembull, nuk kanë pasë qëndrim nacional ndaj tjerëve dhe nuk kanë shprehur paragjykim ndaj popujve tjerë.

Paragrafi 1, pika c. (personi i aftë psiko-fizikisht për kryerjen efektive dhe në kontinuitet të detyrave të anëtarëve të anëtares të Komisionit.

Aktet themeluese të komisioneve për të vërtetën shpesh herë kanë paraparë edhe gatishmërinë shëndetësore si kusht për të qenë i zgjedhur anëtarë i Komisionit. Ligji për themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim në republikën Jug-Afrikane, kërkonte që anëtarët e komisionit të jenë “të shëndosh, të drejtë, persona të mirë që janë të paanshëm dhe që nuk janë të një profili të lartë politik”, ndërsa aktet për themelimin e Komisionit në Libëri dhe Keni kanë paraparë kushtin “i/e shëndetit të mire”. Anëtarët e Komisionit në Marok kanë theksuar rëndësinë e përgatitjes së mirë psiko-fizike për punë kontinuale të Komisionit, me rastin e fjalimit të tij në Forumin e pestë për të drejtën transitorë në Beçiq, Mali i Zi, në maj të vitit 2009.¹²³ Gjithashtu, ish anëtarja e dikurshme e komisionit për të vërtetën dhe pajtim në Republikën jug-afrikane dhe Sierra Leones, Yasmin Sooka, ka deklaruar, në mbledhjen me Grupin punues për hartimin e Statutit, në maj të vitit 2010. në Zagreb, se është e rëndësishme të sigurohet që anëtarët e Komisionit, për shkak shëndetësorë, të mos heqin dorë nga një punë me

¹²³ Fjalimi i Abdelhay Moudden-it, ish anëtarë i Komisionit për barabarësi dhe pajtim (Marok), Beçiqi (Mali i Zi), 29. maj 2009.

kërkesa jashtëzakonisht të mëdha, mu në mes të punës së Komisionit, ose të mos arrihet në situatën që mos të mund të përcjellin punën e kolegëve të tyre, të cilët atëherë do të jenë të detyruar që ti marrin në barrë edhe pjesën e punëve të tyre, çka nuk është e drejtë dhe e vështirëson edhe punën e Komisionit.

Meqenëse gjatë procesit konsultativ kishte edhe disa vërejtje në karakterin "diskriminues" në dispozitat e Statutit, me të cilat kërkohej edhe përgatitja psiko-fizike e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, duhet pasur parasysh se në të gjitha palët kontraktuese, si dhe shtete e botës, për shumë profesione një përgatitje e tillë kërkohej dha atë me arsye, kur natyrë e profesionit është e tillë sa që për kryerjen e atij profesioni është e domosdoshme edhe gjendja shëndetësore e qëndrueshme, gjegjësisht disponimi me kualitete të veçanta fizike.¹²⁴ Nga këndvështrimi i të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duhet të dallohen dy mënyrat e veprimit të pabarabartë (në kuptimin e "trajtimit të ndryshëm" engl. *differential treatment*): njëri lloj nënkupton trajtimin e ndryshëm i cili është objektiv dhe i arsyeshëm, dhe në pajtim me qëllimin legjitim i cili synohet të arrihet, ndërsa lloji tjetër i trajtimit të ndryshëm nuk është e arsyeshme me ato arsyetime, prandaj paraqet diskriminimin e palejueshëm.¹²⁵ Prandaj, qëllimi legjitim i cili në këtë dispozitë dëshirohet të arrihet është efikas, kontinuel dhe puna efikase e Komisionit, pa ndërprerje, që do të shkaktoheshin me eskalimin e simptomave të sëmundjes të anëtarëve/anëtareve të Komisionit, e cila mund të supozohet, për shkak se bëhet fjalë për persona me sëmurje kronike, personave të ekspozuar stresit dhe të ngjashme. Natyrisht, ashtu si edhe çdo normë tjetër ligjore, edhe këtë duhet interpretuar në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kështu që dispozita nuk do të duhej të lejonte, që për shembull personat në karroca të invalidëve, për atë shkak, të konsiderohen të paafta për pjesëmarrje efikase dhe kontinuitet në punën e Komisionit.

Paragrafi 2. (parimi i barazisë gjinore)

Kjo dispozitë ka për qëllim që personat e të dyja gjinive të jenë të përfaqësuara në Komision. Me zgjidhjet e ofruara sigurohet që, së paku një e treta (shtatë) e anëtarëve/anëtareve, por jo më shumë se 2/3 e anëtarëve/anëtareve, të jenë e të njëjtës gjini.

Paragrafi 3. (Përkushtimi që të sigurohet barazia etnike në Komision, por jo për çdo çmim)

Zgjidhja e propozuar ka pretendim që në Komisionin regjional të pajtojë dy kërkesa: që të jenë reprezentativë dhe për përzgjedhjen e personaliteteve të jashtëzakonshme, të cilit, para së gjithash, me

¹²⁴ Për shembull, për kryerjen e detyrave të gjyqarit dhe prokurorit në BH shprehimisht kërkohej "aftësia intelektuale dhe fizike" për kryerjen e atyre detyrave, neni 21 Zakon o Visokom sudskom i tuzilackom vijecu BiH.

¹²⁵ Shih, për shembull, vendimin e Gjykatës Evropiane në rastin *Sejdićdhei Finci kundër BeH*, 2009, st. 42: „Gjykata përsëritë se diskriminim do të thotë trajtim i ndryshëm i personave, ët cilët gjenden në situatë të njejtë, pa arsye objektive apo arsyeshmëri. Mosekzistimi i shkakut dhe arsyes objektiv, do të thotë se trajtimi i ndryshëm nuk e përcjellë legjitimitetin e qëllimit apo nuk ka marrëdhënie të kuptueshme mes mjeteve të cilat përdoren për arritjen e qëllimit”. Gjithahstu, shih Ligji për ndalimin e diskriminimit, *Sl. glasnik BeH*, nr. 59/09, čl. 2; Ligji për ndalimin e diskriminimit, *Sl. list Mali i Zi*, nr. 46/10, neni. 2 Ligji për ndalimin e diskriminimit, *Sl. glasnik Rep. Serbsëe*, nr. 22/09, neni. 2; 1 Ligji për dëbimin e diskriminimit, *Narodne novine Rep. Kroacisë*, br. 85/08, neni. 1; Ligji kundër diskriminimit [Kosovë], Ligji nr. 2004/3, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/32, neni. 2 dhe 3, në të cilat definohet ndalimi i diskriminimit.

kualitetet personale do i kontribuojnë rezultatit përfundimtarë të punës së Komisionit. Duke marrë parasysh atë që çdo palë kontraktuese përzgjedhë numrin e caktuar të anëtarëve të Komisionit regjional në mesin e shtetasve dhe shtetaseve të vet, ekziston mundësia që KOMRA, mu nga ky parim do të jetë trup etnikisht dhe regionalist reprezentativ. Por, insistimi i vendosur në përfaqësimin sipas “çelësit etnik”, është i papërshtatshëm për organin, nga anëtarët e të cilit pritet, që parasegjithash të veprojnë të pavarur dhe paanshëm.¹²⁶ Nëse edhe më tutje do të insistohet në përfaqësimin etnik në mesin e anëtarëve të Komisionit, të cilit zgjidhen brenda një shteti, kjo do të thoshte, duke pasur parasysh strukturën etnike të palëve kontraktuese, do të thotë një komision shumë anëtarësh dhe jo funksional. Nga shkaqet e përmendura, kriteri etnik është ndalur në nivel të rekomandimit për komisionet e seleksionimit dhe shefave të shteteve që të marrin parasysh edhe nevojën për përbërjen e shumëllojshme etnike të anëtarëve të Komisionit nga secili shtet, si dhe kriter sekondar, i cili nuk është obligativ. I është lënë çdo shteti që “të mundohet që të sigurojë përfaqësimin etnik në Komision”, dhe ndër kandidatët dhe kandidatet e paraqitur të përzgjidhen më të mirët të cilët mund të gëzojnë besimin në çdo shtet veç e veç.

Paragrafi 4 pika a. (anëtari/anëtarja nuk mund të jetë personi i cili ka ushtruar funksione politike në dy vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhjen e anëtarëve/anëtareve të Komisionit, ose në periudhën kohore e cila është e përfshirë në kompetencën e Komisionit)

Me qëllim të mbrojtjes së pavarësisë dhe të paanshmërisë, në bazë të përvojave të komisioneve të gjertanishme, është pretendim i përcaktimeve të ekspertëve dhe pjesëmarrësve në konsultime që anëtarët dhe anëtarët e Komisionit nuk duhet të jenë personat që përfaqësojnë interesat e partive politike.¹²⁷ Për këtë arsye është propozuar që të pamundësohet kandidimi i personave të cilët, në kohën e zgjedhjeve kryejnë funksione të shquara politike, gjegjësisht, të cilët kanë kryer funksione të tilla në dy vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit. Me qëllim që edhe më shumë të sigurohet paanshmëria dhe të pengohet ndikimi i drejtë për së drejtë në punën e Komisionit të personave të cilët në periudhën kompetente të Komisionit ishin në funksione të shquara politike në shtetet anëtare, është përjashtuar mundësia e kandidimit të personave të tillë për anëtarësim për Komision. Qëllimi është që të nxiten kandidaturat e njerëzve të cilët në vitet e 90-a nuk ishin në funksione politike, në kohën kur shtetet e krijuara në vitet e nëntëdhjeta në ish territorin e RSFJ,

¹²⁶ Në Komisionet për të vërtetën, “komisionerët e zgjedhur duhet të ëprfaqësojnë shoqërinë në kuptimin më të gjerë, por zgjedhja nuk duhet të bazohet në përfaqësuesit e partive politike dhe bashkësive etnike. Komisioni nuk guxon të bëhet vatër e konflikteve partiake dhe mospajtimit të tyre” Qendra ndërkombëtare për drejtësinë tranzicionale (ICTJ), *Truth Commissions and NGOs: the Essential Relationship*, prill 2004, st. 15, www.ictj.org/images/content/1/O/106.pdf.

¹²⁷ Rekomandimi i Zyrës së Komisionarit të lartë për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara: “duhet të iu kundërvihet fuqimisht qëllimeve që si anëtarë të Komisioneve të vendosen liderët politik ose përfaqësuesit e partive politike, fraksioneve ose grupeve të mëhershme të armatosura...” *Office of the UN High Commissioner for Human Rights, Rule-of-laë fools for post-conflict status: Truth Commissions*, faqe 13, <http://ëëë.ohchr.org/Documents/Publications/Ruleoflaë/TruthCommissionsen.pdf>. sa për ilustrim, neni 7, paragrafi 2 pika b i Ligjit për promovimin e unitetit nacional dhe pajtimit, në bazë të cilit është themeluar Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin i Republikës Afrikës së jugut, ka paraparë që “Anëtarët e komisionit do të jenë personat të cilët nuk janë të profilut të lartë politik...”

me përjashtim të Sllovenisë, nuk kishin vlerësime pozitive mbi gjendjen e demokracive dhe të drejtave të njeriut nga ana e organizatave relevante ndërkombëtare.

Kriteriumet e funksioneve të shquara politike përmbajnë një dozë të pasigurisë, prandaj në panelet zgjedhore mbetet ti shqyrtojnë ato. Akti themelues i një numri të komisioneve për të vërtetën gjithashtu kanë përjashtuar mundësinë që liderët politik të zgjidhen si komisionerë, edhe pse edhe në ato akte është përdorë termi („profili i lartë politik“), përmbajtja e të cilit në një masë i është lënë interpretimit të diskriminimit.¹²⁸

Personat të cilët kanë qenë në funksione të larta publike të karakterit jo politik (për shembull kryetar i Gjykatës Supreme, Prokurori i lartë shtetërorë, kryetarët e gjykatave dhe të ngjashme, dhe që kanë vepruar në kundërshtim me parimet e të drejtave të njeriut, nuk do të mund të zgjidhen për anëtarë/anëtare të Komisionit, për shkak të zbatimit të paragrafit 4 pika c. (përgjegjësia për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare ndërkombëtare, ose mbështetja, dhënia e ndihmës ose nxitja e kryerjes së veprave të tilla, ose dhënia e kontributit në mos gjykimin e atyre veprave).

Paragrafi 4, pika b. (anëtarë/anëtare e Komisionit nuk mund të jetë personi i cili është ose ka qenë pjesëtar profesional i strukturave ushtarake, policore ose i strukturave informative dhe të sigurimit

Është e qartë se personat të cilët gjinden nën dyshimin serioz që në çfarëdo mënyre kanë marrë pjesë në shkeljen e të drejtave të njeriut ose të drejtës humanitare ndërkombëtare, ose që kanë nxitur ose mbështetur shkelje të tilla, ose që janë ngushtë të lidhur me personat përgjegjës ose nën hetime për shkelje të tilla, nuk mund të jenë anëtarë/anëtare të paanshëm të Komisionit. Dispozita pengon që për anëtarë dhe anëtare të Komisionit të jenë të zgjedhur personat që janë përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut në të kaluarën, por përgjegjësia e të cilëve nuk është vërtetuar edhe formalisht në procedurë penale.

Në dispozitë shfrytëzohet formulimi “dyshimi serioz” në vend të “dyshimi i bazuar”, termin që është i paraparë në ligjet për procedurën penale. Dyshimi i bazuar nënkupton që organi kompetent gjyqësor në shtetin kontraktues ka nxjerr vendim për zbatimin e hetimeve; dhe nga momenti i nxjerrjes së vendimit të tillë konsiderohet se ekziston dyshimi i bazuar kundër personit përkatës. Komisionet seleksionues nuk janë organe gjyqësore, nuk disponojnë me kompetenca hetuesie, prandaj edhe nuk mund të kenë autorizime që të vërtetojnë ekzistimin e dyshimit të bazuar, dhe as që iu nevojitet një gjë e tillë për të mos votuar për kandidat të caktuar për ta zgjedhur për anëtarë/anëtare të Komisionit. Mirëpo, në praktikë mund të pritët që përmbajtja e “dyshimit të serioz”, mund të jetë e përafërt me përmbajtjen “dyshimi i bazuar”, do të thotë që anëtarët/anëtares të Komisioneve seleksionuese seriozisht të shqyrtojnë informatat për persona të caktuar, para se të nxjerrin përfundimin se nuk është kandidat/kandidate e mirë për anëtarësim në Komision. Kështu që komisionet seleksionues do të kenë mundësinë që nga përzgjedhja të përjashtojnë personat për të cilët ekziston dyshimi se janë përgjegjës

¹²⁸ Afrika e Jugut, neni. 7, prg. 2, pika. b (“Anëtarë të Komisionit do të jenë personat të cilët nuk kanë prejardhje me profil të lartë politik...”); Timori Lindor, neni. 11.1 (njëjtë).

për veprat e përmendura, por të cilët, për shkak të mosfunksionimit joadekuat të shtetit ligjor deri në ditën e zgjedhjeve nuk kanë qenë të proceduar, ose për shkak të përshkrimit të ndjekjes penale nuk mund të procedohen më tutje, ose do ishin ekspozuar *Ilustracionit*, sikur ajo të zbatohet (për shembull kanë bashkëpunuar me shërbime sekrete). Shembuj të tillë ka akoma në numër të tepërt në territorin e palëve kontraktuese.

Sa i përket ndalesës nga "*lidhja e përfaqësues*" me personat përgjegjës ose nën hetime për shkeljen e të drejtave të njeriut ose të drejtës humanitare ndërkombëtare, ky kriter fleksibil është shfrytëzuar për të ia mundur Këshillit seleksionues që të marrë në konsideratë edhe lidhjet të cilat, kryesisht, nuk janë farefisnore (për shembull në linjën e drejtë, deri te shkalla e dytë e farefisnisë në linjën anësore ose nga ana femërore, siç definohet zakonisht në zgjidhjet tona ligjore), por janë të natyrës afariste dhe të natyrave tjera, si dhe lidhjet familjare vlerësohen në pajtim me të gjitha rrethanat në raport me raste konkrete. Paragrafi 4, pika (b), nuk sugjeron përgjegjësinë e personit të caktuar për shkelje të rënd atë të drejtave të njeriut apo të drejtës ndërkombëtare që implikon edhe përgjegjësinë e të afërmeve të tij, apo personave tjerë të afërm. Përgjegjësia gjithnjë është individuale. Megjithatë, sipas paragrafit 4, pika (a), duke marrë parasysh perceptimin e mundshëm negativ të publikut dhe zvogëlimin e besueshmërisë në kredibilitetin e Komisionit, Statuti përmban zgjidhjen me të cilën mundësohet ngushtimi i zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit në persona të cilët nuk kanë qenë në lidhje të afërt me kryesit e mundshëm.

Neni 25.

Njëjtësimi i procedurës në përzgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

Sqarim

Propozimi që në çdo shtet të zbatohet zgjedhja e anëtarëve/anëtareve sipas të njëjtës procedurë është e bazuar në pretendimin që Komisioni si tërësi të fitojë besimin e opinionit në secilin prej palëve kontraktuese veç e veç. Për shembull, nëse në disa shtete anëtarët e Komisionit, do të zgjidheshin me procedurë e cila nënkupton rolin e veçantë të shoqërisë civile, ndërsa në disa shtete tjera zgjedhja e anëtarëve do të bëhej me ndikim të elitës politike, kjo do të ketë pasojë që disa anëtarë do të kenë bazë të fuqishme legjitimiteti për veprimin e Komisionit, për dallim nga të tjerët. Me procedurë e cila është identike në çdo shtet sigurohet që zgjedhja e fundit të jetë rezultat i shanseve të cilën të gjitha shoqëritë, në mënyrë të barabartë kanë pasur në disponim në mënyrë që të ju mundësojnë kandidatëve dhe kandidateve më të mirë që të gjenden në Komision.

Neni 26.

Kandidimi i anëtarëve dhe anëtarëve

Sqarim

Rekomandimi në bazë të përvojave të gjertanishme të komisioneve për të vërtetën është se anëtarët e Komisionit zgjidhen me ndihmën e Komisionit të pavarur për përzgjedhje, i cili i pranon nominimet nga publiku, i vlerëson kandidaturat, mban intervistat me kandidatët dhe harton rekomandimet për pushtetin politik, i cili më pastaj vepron sipas rekomandimeve dhe bënë zgjedhjen përfundimtare, me këtë sigurohet procesi i hapur i kandidimit dhe debat i gjerë shoqëror.¹²⁹ Për besueshmëri të opinionit në punën e Komisionit, përbërja e tij është e një rëndësie thelbësore, dhe mënyra më e mirë që të sigurohet përbërja kredibile është që të mundësohet procesi ma i gjerë i mundshëm për kandidimin publik (të hapur).

Qëllimi i dispozitës për propozuesit e autorizuar të kandidatëve për anëtarë në Komision është që të sigurohet procesi i hapur i kandidimit. Mirëpo, për ta mbrojtur Këshillin seleksionues nga numri i madh i paraqitjeve joserioze individuale, e drejta për të propozuar kandidat/kandidate iu mundësohet grupit jo formal të përbërë nga 30 qytetarë, si dhe qytetarë të organizuar në shoqata, bashkësi fetare, fakultete, universitete, sindikata, prandaj në institucione në të cilat ekziston sistemi i vendimmarrjes kolektive. Me qëllim të evitimit të politizimit të procesit, të drejtën për të vendosë kandidatët nuk iu është mundësuar shprehimisht partive politike. Mirëpo, anëtarët e tyre mund të organizohen si grup jo formal i qytetarëve, dhe në atë mënyrë të propozojnë kandidatin.

Neni 27.

Përbërja dhe zgjedhja e Këshillave seleksionuese

Sqarim

Këshilli seleksionues, në secilin shtet, do të duhej të jetë trup reprezentativ i cili do të përfshijë si përfaqësuesit e shoqërisë civile, po ashtu edhe anëtarët të cilët i kanë zgjedhur organet shtetërore. Njëkohësisht, Këshilli seleksionues në çdo shtet duhet të jetë i pavarur nga ndikimet e mundshme kryesisht politike dhe i aftë që të ngushtojë rrethin e kandidatëve në persona të cilët, pa dyshim, i karakterizon pavarësia dhe paanshmëria. Në shtetet tjera, në të cilat Këshilli seleksionues kishte rolin në përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit, ka qenë i përbërë nga përfaqësuesit e partive politike,

¹²⁹ Mark Freeman ekspert i Qendrës Ndërkombëtare për të drejtën tranzicionale (ICTJ), në trajnimin e anëtarëve të Këshillit koordinues iniciativë për KOMRE, 26-27 maj 2008, Beograd. Njëjtë, M. Freeman & P.B.Hayner, "Reconciliation After Violent Conflict, Èhat is Truth Commission?", *International Institute for Democracy and Electoral Ssistance*, 2003. Procesi i kandidimit publik dhe tërheqja e selektimit të kandidatëve nga ana e Këshillit seleksionues në përbërjen e të cilin janë organizatat joqeveritare, është zbatuar në Republikën Jugo-Afrikane, Siera Leone, Timorin Lindor, Liberi dhe Keni. Në të kundërtën e kësaj në Argjentinë, Çile, Guatemalë, Peru dhe në shumë shtete tjera, kryetarët e shteteve ose përfaqësuesit e KB kanë emëruar anëtarët e komisioneve pa konsultime me shoqërinë civile.

bashkësive fetare, organizatave për të drejtat e njeriut, shoqatave të viktimave, të juristëve, të afaristëve, sindikatave etj.¹³⁰

Modeli i propozuar është bazuar në aspiratën që Këshilli seleksionues të mos jetë një trup tepër i madh, në të cilin nuk do të ishte e mundur që në një afat relativisht të shkurtër të shikohen dhe shqyrtohen të gjitha aplikacionet e kandidatëve, të mbahen intervistat dhe të harmonizohen qëndrimet për kandidatët më të mirë. Për shembull Këshilli seleksionues në Sierra Leone kishte 6 anëtarë dhe anëtare, ai në Timorin Lindor – 13, ndërsa në Keni 9.

Duke pasur parasysh që Koalicioni i organizatave joqeveritare dhe individëve për themelimin e KOMRA ka anëtarësi të organizuar në palët kontraktuese, me evidencë mbi anëtarësim, dhe se mund të organizohet në atë mënyrë që në mënyrë efikase dhe demokratike të zgjedhë përfaqësuesit e vet në Komisionin seleksionues, është zgjidhje praktike që zgjedhja e 1/3 së anëtarëve të Këshillit seleksionues të vihet në disponim të anëtarësisë së Koalicionit në çdo njërin prej shteteve. Një zgjidhje e tillë do të ishte e pëlqyeshme, duke pas parasysh që Koalicioni për KOMRA, i cili në Janar të vitit 2011 numëron gjithsejtë 419 organizata joqeveritare dhe 706 individë në regjion – ka nisur iniciativën për themelimin e Komisionit dhe me vite ka vazhduar me lotimin për themelimin e të njëjtit.

Pjesën e dytë të 1/3 të anëtarëve të komisionit seleksionues, e përbëjnë përfaqësuesit e organeve shtetërore, të cilët bashkërisht i emëron ministri kompetent për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, ose ministri i drejtësisë atje ku ministria për të drejtat e njeriut dhe të drejta të pakicave nuk ekziston, dhe anëtarët e Këshillit seleksionues ose Komisionit kompetent për të drejtat e njeriut. Komisioni i tillë parlamentar, gjegjësisht Këshilli seleksionues, përfshinë përfaqësuesit e të gjitha partive parlamentare. Ministri është kompetent që të propozoj kandidatët të cilët mund të fitojnë pëlqimin e Komisionit parlamentar/ komisionit.

Tre anëtarët e mbetur të Këshillit seleksionues bashkërisht i zgjedhin përfaqësuesit e koalicionit për KOMRA dhe organeve shtetërore, dhe atë në bazë të konkursit publik. Gjashtë anëtarët e emëruar më herët, do të zgjedhin tre anëtarët e mbetur me shumicë të votave, nëse do të jetë e pamundur që të sigurojnë konsensus.

Në përkushtimin që përbërja e Këshillit seleksionues të jetë sa më reprezentativë, dhe posaçërisht që shoqatave të viktimave të iu sigurohet ndikim i konsiderueshëm në zgjedhjen e kandidatëve të Komisionit, është propozuar që së paku 1/3 e anëtarëve të këshillit seleksionues të përbëhet nga femrat gjegjësisht meshkujt, si dhe nga përfaqësuesit/përfaqësueset e shoqatave të viktimave. Zgjedhja e 1/3 të anëtarëve në mes të përfaqësuesve të shoqatave të viktimave nuk është paraparë si obligative, por si “përkushtim” që të bëhet një gjë e tillë në përputhje me mundësitë, në mënyrë që një zgjidhje e tillë të mos iu imponohet shteteve në të cilat nuk është e mundur që të sigurohet pjesëmarrja e përfaqësuesve e tri shoqatave të viktimave (për shembull, në Slloveni, në Maqedoni).¹³¹

¹³⁰ Për shembull një rast i tillë ishte në Keni, Republikën e Amerikës së Jugut . Timorin Lindor dhe Siera Leone.

¹³¹ “ Do të pretendojë” gjegjësisht “do të ketë kujdes lidhur me atë që të bëhet diçka, ose mos të bëhet, nuk është e pazakonshme në kontratat ndërkombëtare. Për shembull neni 36, paragrafi 8 i Statutit të Romës: a)”Shtetet anëtare me rastin e zgjedhjes së gjyqtarëve mbajnë llogari për: (i) me paraqitje të drejtë të sistemeve ligjore

Nënkuptohet se në shtetet në të cilat numri më i madh i shoqatave të viktimave janë në përbërje të Koalicionit për KOMRA, koalicioni në mes të tre përfaqësuesve të vet do të zgjedhë së paku një anëtarë nga radhët e shoqatave të viktimave, ndërsa në BH, ku disa prej shoqatave më të mëdha të viktimave nuk janë në përbërje të koalicionit, do emërojnë njërin ose dy përfaqësues të shoqatës së viktimave nga radhët e veta, ndërsa edhe një ose dy vende do të mbeten për zgjedhje, së bashku me përfaqësuesit e shtetit, shoqatat e viktimave të cilat nuk janë në përbërje të Koalicionit.

Ministri kompetent për çështjet e të drejtave të njeriut, ose Ministri tjetër kompetent në palën kontraktuese, në të cilin mbahen zgjedhjet, është i ngarkuar që të sigurojë kushtet për zgjedhje efikase dhe punë për komisionin seleksionues. Të drejtat dhe obligimet e tij janë që të propozoj kandidatët për tre anëtarë në Këshillit seleksionues mes përfaqësuesve të organeve shtetërore dhe të arrijë pëlqimin rreth zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit parlamentar, dhe më pastaj të kujdeset për respektimin e afateve, të shpallë emërimet, gjegjësisht zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit seleksionues dhe të iu mundësojë kushte për punë.

Neni 28.

Zgjedhja e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim për Komisionin nga ana e komisionit seleksionues

Sqarim

Qëllimi i këtij neni është që ti sigurojë kushtet për zgjedhje efikase të kandidatëve nga ana e Këshillit seleksionues, si dhe punën transparente të Këshillit.

Prezumohet që puna e këshillave seleksionuese në të gjitha palët kontraktuese do të sfidojë interesimin e opinionit. Për këtë arsye është paraparë që në afat të shkurtër pas arritjes së kandidaturave, opinionit të jetë i njoftuar se cilët janë kandidatët, kandidaturat e të cilëve do të shqyrtohen, në mënyrë që të mundësohet debati publik për kandidatët e paraqitur si dhe dërgimi i informatave plotësuese për Këshillin seleksionues për kandidatët e paraqitur. Është paraparë që intervistat të jenë të hapura për publik, por kjo nuk vlen për mbledhjet e Këshillit në të cilat debatohet për kandidatët, në mënyrë që të mundësohet këmbimi i lirë i mendimeve.

botërore; (ii) përfaqësimin e barabartë gjeografik; (iii) përfaqësimin e barabartë të gjyqtarëve të gjinisë mashkullore dhe femërore..."; Konventa për të drejtat e fëmijëve, neni 24.. "Shtetet kontraktuese do të tentojnë që të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos jetë i privuar nga e drejta në qasje në shërbime të tilla të mbrojtjes shëndetësore", Kontrata në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për çështjet penale, neni 8, paragrafi 3: "Me rastin e përcaktimit të masave të mbikëqyrjes në shtetin kontraktues i cili ka marrë mbikëqyrjen, do të tentohet që të zbatohen masat e caktuara nga shteti i cili e ka nxjerr aktgjykimin".

Shefit të shtetit duhet ti mundësohet që të përzgjedhë anëtarët e Komisionit në bazë të listës e cila përmban numër më të madh të emrave nga vet numri i anëtarëve të caktuar për atë palë kontraktuese. Si për shembull, për zgjedhjen e 3 anëtarëve (në rastin e Kroacisë, Serbisë dhe Kosovës), është në konformitet që shefi i shtetit të të pranojë listën e cila përmban nga 6 deri në 9 emra. Kjo zgjidhje është bazuar, ndër të tjera edhe në shembullin e Republikës së Afrikës Jugore, kur kryetari Nelson Mandela përzgjodhi 15 anëtarë dhe anëtare të Komisionit nga lista prej 15 kandidatëve të propozuar.¹³²

Këshillat seleksionuese, listën e kandidatëve e shpallin në të njëjtën ditë kur të njëjtën ia dorëzojnë kryetarëve/ kryesive. Në këtë mënyrë mundësohet që debati publik për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit të vazhdojë gjatë gjithë kohës deri te përzgjedhja përfundimtare nga ana e kryetarit/kryesisë.

Neni 29.

Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit nga ana e kryetarit/kryesisë së palëve kontraktuese.

Sqarim

Në të gjitha shtetet në të cilat këshillat seleksionuese kanë marrë pjesë në përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit, por ata nuk kanë vendosur përfundimisht për zgjedhjet, sepse një gjë e tillë i është lënë kryetarit të shtetit ose ekuivalencës së tij.¹³³ Ky është njëri nga elementet që e bëjnë Komisionin për të vërtetën, organ zyrtarë shtetërorë. Duke pasur parasysh se procesi i zgjedhjes, së anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, është e domosdoshme të kryhet njëkohësisht dhe në mënyrë efikase në tërë regjionin, është propozuar që zgjedhja përfundimtare e anëtarëve të Komisionit, në secilin prej shteteve, të bartet në organin inoks – kryetarët, gjegjësisht Kryesinë tre anëtarësh në BH. Ata, në praktikë, do të vendosin në mesin e kandidatëve të cilët, sipas vlerësimit të këshillave seleksionuese, i plotësojnë kushtet që të gjenden në Komision.

Në secilin shtet, Komuna është në proces të përfaqësuar me rastin e përzgjedhjes së Këshillit seleksionues, sepse tre anëtarë të Këshillit zgjedhjen me propozimit të Ministrit të drejtësisë, dhe me pëlqim të anëtarëve të komisionit parlamentar, në të cilin janë të përfaqësuar të gjitha partitë parlamentare (neni 27, paragrafi 3, i Statutit). Gjithashtu, partive politike iu është mundësuar që të kandidojnë përfaqësuesit e tyre për anëtarë të Këshillit seleksionues, të cilët zgjedhën në bazë të konkursit.

¹³² Më pastaj, kryetari Mandela, e ka plotësuar Komisionin edhe dy anëtarë, të cilët nuk ishin të propozuar nga ana e Këshillit seleksionues, me qëllim të përfaqësimit përkatës gjeografik dhe etnik.

¹³³ Në Republikën e Afrikës Jugore dhe Keni, anëtarët e Komisionit, në bazë të rekomandimit të Këshillit seleksionues, i ka emëruar kryetari i shtetit. Në Sierra Leone atë e ka bërë Përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të K.B., ndërsa në Timorin Lindor – Administratori në tranzicion, i emëruar nga ana e K.B.

Kryetari i shtetit, gjegjësisht Kryesia e BH, bën përzgjedhjen përfundimtare të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit të cilët zgjedhën në shtetin me të cilin kryeson, nga lista të cilën e konfirmon Këshilli seleksionues në atë shtet. Në rast të ndërprerjes të mandatit për anëtarin/anëtaren nga i njëjti shtet (neni 33, i Statutit) kryetari/kryesia, nga ajo listë do të përzgjedhë anëtarin ose anëtaren e re të Komisionit.

Që të sigurohet që përbërja e Komisionit në tërësi të jetë e pranueshme për të gjitha shtetet është propozuar që, në periudhën prej dy javësh para se të bëhet publikimi i përbërjes definitive të Komisionit, kryetaret/kryesia njoftohen me zgjedhjet e të gjithëve dhe se, sipas nevojës, me konfidencialitet diplomatik ndikojnë në ndryshimin e vendimit të ndonjërit prej tyre. Në këtë mënyrë, me një mundësi minimale komplikimesh të procesit, mundësohet që zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Komisionit të jetë e konfirmuar nga ana e të gjitha shteteve.

Neni 30.

Mbledhja konstitutive

Sqarim

Fillimi efikas i punës së Komisionit është siguruar me përcaktimin e kompetencave për anëtarin/anëtaren më të vjetër që të kryesojë Komisionin në 60 ditët e para të punës së tij, për deri sa anëtarët e Komisionit të njoftohen në mes veti në mënyrë të mjaftueshme që të mund të vendosin për zgjedhjen e anëtarit/anëtares kryesues. Gjithashtu, është një zgjidhje e zakonshme në shtetet në region që me mbledhjet konstitutive të organeve shtetërore, për shembull Kuvendit, të kryesojë anëtari më i vjetër.¹³⁴

Leximi i tekstit të betimit me zë dhe/ose nënshkrimi i deklaratës me të cilën anëtarët dhe anëtarët e Komisionit obligohen në respektimin e Statutit të Komisionit dhe në veprime etike, të pavarura dhe të paanshme, është një akt i zakonshëm në fillim të punës së komisioneve për të vërtetën.¹³⁵ Pjesa hyrëse e mbledhjes konstitutive do të jetë e hapur për opinion. Në pjesën hyrëse të mbledhjes, do të marrin pjesë edhe kryetarët e shteteve, para të cilëve anëtarët dhe anëtarët e Komisionit në mënyrë solemne do të nënshkruajnë dhe lexojnë me zë tekstin e betimit me të cilin obligohen që do veprojnë në përputhje me statutin e Komisionit.

¹³⁴ Shembull, shiko: Poslovník Skupštine Crne Gore neni 6; Poslovník Narodne Skupštine Republike Srbije, neni 3; Poslovník Doma Naroda Parlamentarne Skupštine Bosne i Hercegovine, neni 2, paragrafi 3; Delovodnik na Sobranieto na Republika Makedonija, neni 9.

¹³⁵ Për shembull, shiko nenin 14 dhe aneksin II të Ligjit për themelimin e Komisionit për të vërtetën, drejtësinë dhe pajtimin, Keni, viti 2008.

Neni 31.

Zgjedhja e kryesuesit/kryesueses dhe miratimi i Rregullores

Sqarim

Anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit iu është mundësuar që vet të vendosin lidhur me atë se a do të kenë gjatë gjithë kohës të njëjtin kryesues/kryesuese ose do ta kufizojnë afatin kohor të funksionit të kryesuesit në një periudhë për të cilën anëtarët vlerësojnë se është e përshtatshme, çka në fund mund të mundësojë që edhe të gjithë anëtarët e Komisionit për një kohë të jenë në funksionin e kryesuesit. Afati i paraparë prej 2 muajsh do të ishte i mjaftueshëm që anëtarët dhe anëtares të komisionit të përzgjedhin kryesuesin/kryesuesen dhe të miratojnë Rregulloren për punën e tyre.¹³⁶

Neni 32.

Kuorumi dhe vendimmarrja

Sqarim

Nuk është e domosdoshme që dispozita për kuorumin të jetë pjesë përbërëse e Statutit të Komisionit, gjegjësisht është e mundshme që kjo të lihet në vetë Komisionin që të vendos për mënyrën sipas të cilës do të merr vendimet. Rasti i tillë ishte edhe me komisionet jug-afrikane, dhe të Liberisë, ku ligjet për themelimin e tyre parashikonin vetëm kuorum për vendosje në mbledhjen e parë konstitutive të Komisionit (dy vota më pak nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit). Megjithatë, shumica e akteve themeluese kanë përmbajtur dispozitat për kuorumin. Aktet e kanë përcaktuar në mënyrë të ndryshme kuorumin e domosdoshëm për punën e komisionit. nga shumica e thjeshtë e anëtarëve/anëtareve (Timori Lindor), deri te shumica e kualifikuar e cila është formuluar si dy të tretat (Maroku), ose numerikisht si 5 – 9 anëtar, duke përfshirë edhe kryesuesin (Gana), ose si 4 – 7 anëtarë, duke përfshirë njërin prej tre komisionarëve – nënshtetas të huaj (Kenia).

Nëse merret qëndrimi që anëtarët/anëtares të Komisionit do të duhej që të jenë , sipas rregullave të angazhuar në Komision me orar të plotë të punës, siç është propozuar me këtë Statut, atëherë nuk ekziston arsyeja për zgjidhje sipas të cilës për punë do të ishte e mjaftueshme vetëm shumica e thjeshtë, dhe jo shumica e kualifikuar. Zgjidhja e cila është propozuar (14 anëtarë/anëtares, lejon, akoma, edhe 6 anëtarë/anëtares të jenë në mungesë, por Komisioni prapë se prapë të punojë. Të gjitha alternativat tjera nuk i kontribuojnë kredibilitetit të punës së Komisionit.

Shumica e ligjeve dhe urdhëresave për themelimin e komisioneve, të cilët kanë përcaktuar mënyrën e vendimmarrjes, shprehimisht kanë rekomanduar që Komisioni të nxjerrë vendimet në mënyrë unanime (

¹³⁶ Këto dispozita janë të bazuara në përvojën e anëtarëve të komisioneve në Republikën e Afrikës Jugore, Siera Leone dhe Peru.

me konsensus), por aktet themeluese, njëkohësisht, përcaktojnë që në rast kur konsensusi është i pamundur të arrihet, Komisioni vendos me shumicën nga të gjithë anëtarët (Sierra Leone, Timori Lindor, Gana), Me shumicën e 2/3 të anëtarëve prezentë (Maroku), ose me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezentë, por me atë që në rast të votave të barabarta, vota e kryesuesit është ajo që vendos (Kenia). Zgjidhja e propozuar për KOMRE-n është në gjurmët e të cekurave më lartë: Komisioni do të përpiqet që të nxjerr vendime njëzëri, por kur kjo nuk do të jetë e mundur, do të vendos me shumicën e kualifikuar nga 14 votat e anëtarëve/anëtareve. Shumica e njëjtë mund të vendos që vendimet e caktuara procedurale të merren me shumicën (e thjeshtë) të anëtarëve/anëtareve.

Zgjidhja e propozuar, e cila kërkon shumicën e kualifikuar nga 14 vota, do të thotë që në punën e Komisionit mund të vijë deri te situata në të cilën nuk do të ketë shumicën për marrjen e vendimit të caktuar. Mirëpo, zgjidhja sipas të cilës shumica e thjeshtë e të gjithëve ose të anëtarëve prezent do të ishte e mjaftueshme, mundëson që gjetjet thelbësore të Komisionit mund të merren me votat për shembull 11 “për” dhe 9 “kundër”. Vendimet e marra me këtë shumicë të ngushtë nuk do të kishin peshën e domosdoshme, nga i cila varet edhe perceptimi i vet Komisionit, në të gjithë regjionin, si trup autoritativ. Gjetjet faktike të Komisionit të miratuara me shumicën e pamjaftueshme nuk do të kishin fuqinë e nevojshme me të cilën do të mund të ndërpriteshin shtrembërimet ose mohimet e fakteve ekzistuese mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda e të drejtave të njeriut. Kjo do të ishte në kundërshtim me njërin prej qëllimeve themelore për themelimin e KOMRA-s, prandaj, për këtë arsye Statuti përcakton shumicën e kërkuar për marrjen e vendimeve. Nevoja që vendimet të merren me shumicën prej 14 votave, imponon obligimin shtesë etik për anëtarët dhe anëtares të komisionit që të veprojnë me përgjegjësi çka nënkupton dhe pjesëmarrje në mbledhje (shiko nenin 13, paragrafi b dhe d, të Projektstatutit), “të drejtat dhe obligimet e anëtarëve/dhe anëtareve të Komisionit”.

Neni 33.

Ndërprerja e mandatit të anëtarit/anëtares

Sqarim

Në këtë nen është paraparë se në cilat raste pushon mandati i anëtarit/anëtares së Komisionit. Paragrafi 2 ka të bëjë me rastet me të cilat mandati pushon sipas “automatizmit”, do të thotë kur komisioni konstaton që janë paraqitur faktet të cilat vetvetiu sjellin deri te ndërprerja e mandatit, ndërsa paragrafët 3 – 5 me rastin e shkarkimit, kur Komisioni merr vendim që të propozoj shkarkimin e anëtarit/anëtares kryetarit/kryesisë së shtetit, të cilit për këtë vendosin. Është e domosdoshme që kryetari/kryetarja, gjegjësisht Kryesia e BeH, përfundimisht të vendos mbi ndërprerjen e mandatit të anëtarit/anëtares së Komisionit, për zgjedhjen e të cilit më herët ka vendosur. Presumohet që autoriteti i shumicës së kualifikuar (14 vota), i/e cili/a vendos të propozoj shkarkimin sipas rregullave, do të kontribuojë që kryetari/kryetarja me një vendim të tillë do të pajtohet. Mirëpo, atij/asaj duhet ti ofrohet mundësia që për këtë çështje vet të vendos.

Është përcaktuar afat i shkurtër prej 15 ditësh për vendosje nga ana e kryetarit/kryetares për shkarkimin, gjegjësisht zgjedhjen e anëtarit/anëtares së re të Komisionit, në mënyrë që të sigurohet kontinuitet në punën e Komisionit. Kryetari/kryetarja zgjedhë anëtarin e ri nga lista të cilën paraprakisht e ka përcaktuar Këshilli seleksionues, procedura e tillë është e zakonshme te ato Komisione të cilat Këshilli seleksionues ka qenë pjesëmarrës në zgjedhje (p.sh. Sierra Leone, Timori Lindor, dhe Kenia).

Zgjidhja, sipas të cilës mandati pushon në rast të gjykimit të anëtarit/anëtares së Komisionit me dënim të pakusht me burg (paragrafi 1 pika d) është marrë nga dispozita e Kushtetutës së Serbisë dhe Malit të Zi lidhur me ndërprerjen e mandatit për gjyqtarët e gjykatave themelore dhe kushtetuese.¹³⁷ Në këtë rast, kemi të bëjmë me gjykim për vepra penale të cilat janë kryer ose para fillimit të detyrës, ose pas kryerjes së detyrës të anëtarit/anëtares së Komisionit, por e cila nuk ka të bëjë në mendimin e shprehur dhe veprimin brenda kornizave të kryerjes së detyrave për të cilat vlen imuniteti (shiko nenin 36, paragrafi 1, pika b), ose është në pyetje rasti kur Komisioni vendos që të ia shkurtoj imunitetin anëtarit/anëtares së vet (neni 36, paragrafi 3).

Në paragrafët 3 – 5 të këtij neni janë përshkruar shkaqet dhe procedurat për shkarkimin e anëtarëve/anëtareve të komisionit. Deri te shkarkimi mund të arrihet për shkak të mosplotësismit të obligimeve nga ana e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit të cilat janë të parapara në nenet 35 dhe 37). Komisioni merr vendim mbi propozimin për shkarkim në të njëjtën mënyrë si për të gjitha të tjerat – sipas mundësisë njëzëri, por nëse unanimiteti është i pamundshëm atëherë me shumicën prej 14 anëtarëve dhe anëtareve. Para se të përcaktojë propozimin, Komisioni, për anëtarin/anëtares e Komisionit shkarkimi i të cilit shqyrtohet, do i mundësojë që të njoftohet me provat (faktet) që ekzistojnë kundër anëtarësisë së tij/saj në Komision, në mënyrë që të ofroj provat (faktet në dobi të tij/saj, por ai/ajo nuk marrin pjesë në vendimmarrje për propozim për shkarkim.

Neni 34.

Largimi i përkohshëm nga detyra e anëtarit/anëtares së Komisionit

Sqarim

Me qëllim të sigurimit të punës në kontinuitet të Komisionit, në rastet kur paraqitet dyshimi i bazuar ose dyshimi serioz në kredibilitetin e anëtarit/anëtares, ose kur anëtari/anëtarja të jenë përkohësisht të pamundësuar që të marrin pjesë në punën e Komisionit për shkak të sëmundjeve ose shkaqeve

¹³⁷ Shiko nenin 154 Ustav Crne Gore, dhe nenin 174 Ustav Republike Srbije. Kushtetuta e Republikës së Kroacisë përcakton që gjyqtari mund të jetë i shkarkuar në rast se kryen vepër penale, e cila e bën jo të denjë për kryerjen e detyrave të gjyqtarit (neni 122 Kushtetuta e RK); Në BH gjykimi me dënim me burg ose për vepër penale të cilat gjyqtarin/prokurorin e bën të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave, po ashtu edhe kundërvajtjet disiplinore janë ato të cilat mund të sjellin deri te shkarkimi. Ligji për këshillin e lartë gjyqësor dhe prokuroria i BH, Sl. Glasnik BiH, nr. 25/04, 93/05, neni 56, pika 14 dhe neni 57, pika 13.

emotive.¹³⁸ Komisionit i mundësohet që të vendos të suspendojë anëtarin/anëtaren përderisa shkaqet për dyshim të verifikohen, gjegjësisht për derisa rrethanat tjera në raport me te të mos ndërpritet. Zgjidhja është propozuar në bazë të dispozitave mbi largimin e përkohshëm të gjyqtarëve nga kryerja e detyrave¹³⁹, dhe në bazë të përvojave dhe rekomandimeve të anëtarëve të komisioneve për të vërtetën.¹⁴⁰

PJESA VIII. – TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE/ANËTAREVE DHE PERSONELIT TË KOMISIONIT

Neni 35.

Ndërgjegjja , pavarësia dhe paanshmëria

Sqarim

Paragrafi 1.

Pavarësia dhe paanshmëria e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit është obligim i cili theksohet në të gjitha aktet themeluese të komisioneve nacionale, për të vërtetën. Për Komisionin regjional është prej rëndësisë së veçantë që të theksohet se anëtarësia e tij, edhe pse e zgjedhur nga ana e shtetit i cili do të jetë materie e interesimit të Komisionit, ka për obligim të veproj në cilësinë personale, sipas një ndërgjegjeje individuale, pavarësisht nga interesat shtetërore politike ose të tjera, të cilit do grupimi të interesit. Një veprim i këtillë nënkupton edhe obligimin e anëtarit/anëtares që të përmbahet nga ndërmarrja e çfarëdo veprimi ose dhënie të deklaratës e cila do të mund të cenonte pavarësinë dhe integritetin e komisionit, gjegjësisht do të sillte në pyetje besueshmërinë e opinionit në punën e tij.

Shembulli se është e mundur që të shtetet të zgjedhin anëtarët e trupave ndërkombëtare nga të cilët, më pastaj, pritët që të veprojnë në mënyrë të pavarur, në cilësinë individuale, paraqesin kontratat ndërkombëtare në bazë të cilave janë themeluar nga KB si Komiteti për të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, kundër torturës, për luftimin e diskriminimit racor, si dhe gjykata ndërkombëtare penale,

¹³⁸ Shiko Zakon o Visokom sudskom i tuzilackom savjetu BiH, Kreu VII, "Sl. Galsnik BiH", nr.25/04, 93/05,, nen .77, pika e.): Gjyqtari dhe prokurori mund të largohen përkohësisht nga krayerja e detyrave...e.) nëse është vështirësuar kryerja e detyrave zyrtare për shkak të gjendjes së tij mentale, emocionale ose fizike".

¹³⁹ Njejtë. Ligji mbi këshillën gjyqësore në Mal të Zi, nen.69, Sl. List CG, nr.13/08

¹⁴⁰ Yasmin Sooka , anëtare e Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin të Rep. Afrik. Jugore dhe Siera Lenës, konsultimet me anëtarët e Grupit punues për hartimin e Statutit të KOMRE-s, Zagreb, qershor 2010.

gjykata evropiane për të drejtat e njeriut e tjerë. Të gjithë personat të cilët nxjerrin vendimit në trupat e përmendura janë të obliguar që të veprojnë “në cilësinë individuale”

Përvoja e të tjerëve tregon se është e nevojshme që të përcaktohet edhe obligimi i punës së ndërgjegjshme dhe të përkushtuar, në mënyrë që anëtarësisë dhe personelit të Komisionit ti tërhiqej vërejtja në faktin se funksioni dhe ngarkimi me detyra nuk është i karakteri protokollarë, por kërkon punë të përkushtuar dhe efikase, në bashkëpunim me anëtarët/anëtares tjerë dhe me të punësuarit në Komision. Shkelja e obligimit të përcaktuar i lejon Komisionit që, sipas nevojës, ti qaset shkarkimit të anëtarit/anëtares, gjegjësisht largimit të personit nga Komisioni, (shih nenin 33 dhe 34, të Statutit), çka nga përvoja e komisioneve tjera, dikur, ishte shtruar si e domosdoshme.¹⁴¹

Paragrafi 2 dhe 3.

Problemi i konfliktit të interesit është i ndërlidhur me obligimin e anëtarit/anëtares ose të punësuarit në Komision që të kujdesen për atë dhe opinioni objektivisht mund të fitojë përshtypjen se ata veprojnë pavarësisht dhe paanshmërisht, në mënyrë që Komisioni në tërësi të gëzojë besimin dhe që integriteti i tij të mos vihet në pyetje.

Neni 36

Privilegjet dhe imuniteti

Sqarim

Privilegjet dhe imuniteti ndahen në mënyrë që të sigurohet që anëtarët/anëtares, si dhe personeli, i Komisionit të punojnë në mënyrë të pavarur, dhe të kenë mundësi që pa frikë të vërtetojnë faktet (provat) dhe të njëjtat t ia prezantojnë opinionit.

Numri më i madh i Komisioneve për të vërtetën, të cilat kanë vepruar në këtë 10 vjetësh, kanë siguruar imunitet për anëtarët e tyre, kjo përfshinë Komisionet në Afrikën e Jugut, Siera Leone, Timori Lindor, Ganë, Liberi, Keni dhe në Ujdhesat e Solomonit dhe në Ekuador.¹⁴² Neni 36 i Statutit të KOMRA-s, përveç tjerash, bazohet në dispozitat mbi imunitetin e anëtarëve të Komitetit kundër torturës, në bazë të Konventës kundër torturës dhe veprimeve tjera të egra, jo njerëzore ose dënimeve përbuzëse (neni 23), si dhe anëtarëve të Komitetit i cili është themeluar me Konventën Evropiane për pengimin e torturës dhe veprimit jonjerëzorë dhe përbuzës ose dënimeve (aneks “privilegjet dhe imuniteti”, në lidhje me nenin 16të Konventës).

¹⁴¹ Të shikohet, për shembull, Pakti ndërkombëtarë për të drejtat qytetare dhe politike. Neni 28, pika 3; Konventa për të drejtat e fëmijut, Neni 43, pika 2; dhe Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Neni 21, pika 2.

¹⁴² Yasmin Sooka, anëtare e Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin të Rep. Afrik. Jugore dhe Sierra Leonës, konsultimet me anëtarët e Grupit punues për hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, qershor 2010.

Përveç anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, imunitet gëzon edhe personeli i KOMRA-s, në të njëjtën masë, dhe në të njëjtën mënyrë. Shumica e akteve themeluese të cilët sigurojnë imunitet për anëtarë dhe anëtarët e Komisionit për të vërtetën, këtë e bëjnë edhe në raport me personelin e Komisionit (shembujt janë marrë nga Timori Lindor, Sierra Leone, Gana, Liberia dhe Ekuadori),¹⁴³ edhe pse komisionet tjera kanë një rreth më të ngushtë të personave me imunitet (Ujdhesat e Solomonit, Kenia).¹⁴⁴ Rekomandimi që edhe personeli të gëzoj imunitet, e përmban edhe studimi gjithëpërfshirës i Komisionit të Australisë për reformë juridike (*Australian Law Reform Commission*), nga viti 2009, mbi punën e komisioneve për hetuesi në atë vend.¹⁴⁵

Me pikën a është përcaktuar imuniteti nga paraburgimi dhe sekuestrimi i bagazhit personal, çka është e zakonshme në situatat e njohjes së imunitetit, si siguri themelore për kryerjen e detyrave.

Me pikën b është siguruar mbrojtja nga të gjitha llojet e procedurave juridike, çka nënkupton nga ato për kundërvajtje, penale, civile ose procedurave tjera për shprehje mendimi, votim, ose veprim, me mirëbesim, brenda kornizave të kryerjes së detyrës.

Komisioni do të jetë i përbërë nga anëtarë/anëtarët të cilët janë shtetas të shteteve të ndryshme, të krijuara me shpërbërjen e RSFJ. Prandaj, me pikën c është pamundësuar ndalesa eventuale në qasje, gjegjësisht është siguruar e drejta e hyrjes dhe daljes në/nga shteti në të cilin kryhet funksioni.

Me Statut është përcaktuar që imuniteti nga të gjitha llojet e procedurave juridike, çka nënkupton nga ato për kundërvajtje, penale, civile ose procedurave tjera për shprehje të mendimit ose veprimit, në mirëbesim] brenda kornizës në kryerjen e detyrës, të përcaktuar në nenin 1 pika b, nuk pushon me ndërprerjen e mandatit të anëtarit/anëtares së Komisionit.

Mirëpo, mbrojtja me imunitet nuk është absolute dhe e përvokueshme. Komisioni ka të drejtë që të revokoj imunitetin nëse vlerëson se imuniteti mund të pengojë në rrjedhën e drejtësisë dhe të rrezikoj besueshmërinë e opinionit. Këto kushte për revokim të imunitetit duhet të jenë të plotësuara në mënyrë kumulative, në mënyrë që imuniteti të jetë i revokuar.

¹⁴³ Afrika e Jugut, nen.41; Sierra Leone, nen.14(4); Timori Lindorë, kapitulli 45; Gana, 21; Liberia, nen.22; Kenia, nen. 24(1) dhe (2); Ujdhesat Solomone, nen.13(1); {Ekuadori} *Ley de proteccion de la Comision de la verdad*, 4. shkurt 2010, nen.1.

¹⁴⁴ Sierra Leone, nen.14(4); Timori Lindorë, kapitulli 45; Gana, 21; Liberia, nen.22; Kenia, nen. 24(1) dhe (2); Ujdhesat Solomone, nen.13(1); {Ekuadori} *Ley de proteccion de la Comision de la verdad*, nen2.

¹⁴⁵ Statuti i Komisionit të Kenisë në nenin relevant (nen.24), flet për imunitetin e anëtarëve dhe sekretarit të Komisionit, ndërsa Statuti i Komisionit të Ujdhesave Solomone, në nen.13(1), vetëm për imunitetin e komisionerit.

Neni 37.

Mbrojtja e burimeve të të dhënave konfidenciale (të besueshme)

Sqarim

Gjatë punës së Komisionit, anëtarët dhe anëtarët e Komisionit, personeli dhe persona tjerë të angazhuar do të kenë qasje në një numër të madh të të dhënave, nga të cilët disa prej tyre do të jenë të natyrës sekrete. Gjithashtu, presumohet disa institucione të caktuar dhe individ do të bashkëpunojnë me komisionin vetëm nën kusht të konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së burimit me rastin e dhënies së të dhënave ose të dokumenteve. Me qëllim të pengimit të keqpërdorimeve të mundshme dhe shfrytëzimin e të dhënave me qëllim të realizimit të interesave personale, si dhe për mbrojtje të kredibilitetit të Komisionit, përcaktohet obligimi për ruajtjen e sekretit për të dhënat deri në momentin e publikimit zyrtar të tyre nga ana e Komisionit. KOMRA mban të drejtën diskrete që, duke marrë parasysh obligimin për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të vendos se cilat informata do i publikoj zyrtarisht. Komisioni, me atë rast, do të ketë kujdes që publikimi i të dhënave të caktuara të mos rrezikoj përmbushjen e detyrave të Komisionit. Komisionet në Keni, Ganë, Timorin Lindor dhe Siera Leone, gjithashtu kanë pasur dispozita për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe pengimin në përdorimin e tyre për qëllime personale.¹⁴⁶

Neni 38.

Statusi i anëtarëve/anëtareve të Komisionit dhe i personelit të Komisionit

Sqarim

Është propozuar që anëtarët/anëtarët e Komisionit, si dhe të punësuarit tjerë në Komision të angazhohen, sipas rregullave, për orar të plotë të punës, kurse në raste të tjera, që për punën e tyre të përfitojnë pagesë apo honorar i cili do të parashihej me marrëveshje të veçantë për financimin e Komisionit. Përvojat e komisioneve të deritanishme për të vërtetën janë të ndryshme sa i përket kësaj çështje. Në Çile, për shembull anëtarët/anëtarët e Komisionit nuk kanë përfituar honorarë, ndërsa personeli po, sepse ishin të angazhuar dhe të paguar me kontratë mbi vepër. Në Komisionet tjera, sipas rregullave anëtarët e Komisionit kanë përfituar kompensimin dhe kanë punuar ose me orar të plotë të punës ose më së paku 25% nga orari i plotë i punës (Timori Lindor). Orari i plotë i punës nënkuptonte përjashtimin e çdo mundësie për angazhim tjetër dhe kryerjen e ndonjë funksioni tjetër (për shembull (Gana dhe Liberia), mirëpo, Komisioni, ekskluzivisht, kishte mundësinë që të përjashtojë anëtarët/anëtarën e vet nga një obligim i tillë. Duke pasur parasysh vëllimin e punëve që ekziston para KOMRE-s, si dhe nevojën për kufizimin e kuptueshëm të kohëzgjatjes së mandatit, është propozuar që anëtarët/anëtarët e Komisionit të jenë të angazhuar me orar të plotë të punës dhe për atë punë të

¹⁴⁶ Australian Law Reform Commission, *Making Inquiries: A New Statutory Framework* (2009), kreu 12 ("Protection from Legal Liability"), faq.308, rekomandimi 12-1.
www.alrc.gov.au/sites/default/files/pdfs/publications/ALRC111.pdf.

pranojnë kompensimin adekuat. Mirëpo, duke pasur parasysh mundësinë e angazhimit për katër vite të plota, është propozuar zgjidhja kompromise që do të mundësonte edhe për kandidatët me karrierë, për shembull, të profesorëve të Universitetit, që të pranojnë detyrat e anëtarit/anëtares së Komisionit, në atë mënyrë që Komisioni, do të kishte mundësi, ekskluzivisht, të vendos që ata në një përqindje më të vogël të kohës së punës të vazhdojnë të kryejnë edhe funksione tjera, me kusht që ato të mos paraqesin konflikt interesi, gjegjësisht që mos të dëmtojnë besimin e opinionit në pavarësinë dhe paanshmërinë e Komisionit. (shih nenin 35, paragrafi 2)

PJESA E IX – STRUKTURA E KOMISIONIT

Neni 39

Sekretariati Ekzekutiv dhe paralelet tematike

Sqarim

Sipas nenit 4, të Statutit është përcaktuar që selia e Komisionit të gjendet në Sarajevë. Kjo nënkupton atë se në Sarajevë gjendet zyra qendrore, gjegjësisht Sekretariati ekzekutiv i Komisionit. Brenda kornizave do të ekziston një numër më i madh i paraleleve, dhe secila prej tyre e aftësuar për kryerjen e aktiviteteve konkrete me rëndësi për përmbushjen e mandatit të Komisionit. Vendimi lidhur me atë se cilat paralele konkrete janë të nevojshme për Komisionin, do e marrin vet anëtarët e tij. Në bazë të përvojave krahasuese, mund të parashihet që Sekretariati ekzekutiv të ketë disa prej, ose shumicën, e departamenteve në vijim:

- a. për financa;
- b. për hulumtime,
- c. për punë juridike, (ligjore);
- d. për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve;
- e. për ndihmë psikologjike dhe këshillimin e viktimave dhe dëshmitarëve;
- f. për punë me viktimat e dhunës seksuale, gjegjësisht viktimat të cilat në kohën e kryerjes së kriminit ishin të mitur;
- g. grumbullimin e deklaratave;
- h. udhëheqjen me dokumentacionin e Komisionit;
- i. për arkiv dhe bazën e të dhënave;
- j. për hartimin e raportit përfundimtarë dhe përmbledhjes së raportit (rezymesë) e raportit, dhe
- k. paralele të tjera të cilat Komisioni, sipas nevojës, mund ti themeloj.¹⁴⁷

¹⁴⁷ Aktetet themeluese të Komisionit të Sierra Leone, nen 14.3., Timorin Lindor, nen 44.1., Ganë, nen 19.4. dhe 19.8., Liberi, nen 25., dhe Keni, en 23.

Komisioni duhet të vlerësojë se në cilën fazë, këto paralele, duhet të jenë të themeluara. Për shembull, është e sigurt se paralelja për hartimin e raportit përfundimtarë dhe rezymesë së raportit do të themelohet në vitin e fundit të veprimtarisë së Komisionit, qoftë me themelimin e një paralele tërësisht të re, ose me transformimin e pjesëve të paraleles së deriatëhershme për hulumtime.

Është edhe një vendim të cilin Komisioni duhet gjithsesi ta nxjerr është ai se në cilën masë, zyrat e saja në palët e caktuara kontraktuese (shiko nenin 40, të Statutit, do të pasqyrojnë këtë strukturë, gjegjësisht ti shmangen asaj, varësisht nga nevojat e zyrës përkatëse.

Neni 40 .

Zyrat e Komisionit në palët kontraktuese

Sqarim

Për ti realizuar detyrat e KOMRA-s, do të jetë e nevojshme që përveç të zyrës qendrore të Komisionit në Sarajevë, të ekzistojnë edhe zyrat në territoret e palëve kontraktuese. Është e natyrshme pritja se në ato zyre, kryesisht, do të jenë të punësuar nënshtetasit e shtetit përkatës. Të gjitha këto zyre do jenë të detyruara, si tërësi, të ruajnë kohezionin i cili, në realitet, i bën si pjesë të të njëjtit Komision regional, dhe jo të veçanta, si komisione nacionale. Pavarësia e tepruar në punën e zyrave mund të sjellë deri te njëanshmëri etnike dhe të krijojë vështirësi ardhjen deri te të dhënat relevante, të cilat gjendet jashtë atij shteti – do të thotë deri te ato probleme të njëjta të cilët kanë shtyrë organizatat joqeveritare dhe shoqatat e viktimave që të iniciojnë themelimin e KOMRA-s si Komision regional dhe mbi nacional.

Disa elemente në nenin 40 dhe në pjesët tjera të Statutit do duhej të siguronin kohezionin në veprim të zyrave të ndryshme në palët kontraktuese:

- Të gjitha zyrat zbatojnë rregulloret të cilat i nxjerrë Komisioni, me të cilat është përcaktuar metodologjia unike për marrjen e deklaratave, grumbullimin e dokumentacionit, rregullimin e procedurave për dëgjime publike, si dhe rregullimin e sesioneve tematike (neni 22);
- Të punësuarit dhe bashkëpunëtorët në zyrat në palët kontraktuese angazhohen pa marrë parasysh nënshtetësinë e tyre, çka mundëson, për shembull, shtetasve të Serbisë dhe Maqedonisë të punojnë në zyrën në Zagreb (neni 40 paragrafi 4);
- Komisioni emëron shefat e zyrave në palët kontraktuese (neni 40, paragrafi 1). (Nuk ka pengesa që për shef të zyrës të jetë i emëruar edhe ndonjëri prej 20 anëtarëve të Komisionit. Një praktikë e tillë ka ekzistuar, për shembull, në punën e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në Republikës së Afrikës së Jugut¹⁴⁸).
- Komisioni ka mundësi që vetë të themelojë ekipin mobil hetues, i cili mund të kryej hulumtime kudo qoftë në territorin e palës kontraktuese (neni 40, paragrafi 3).

¹⁴⁸ Ekzistimin e disa paraleleve e kanë paraparë, për shembull, Statuti i komisioneve në Liberi (kapitulli 33.); Kanada (nen.6), dhe Keni (nen.13 (3)).

Gjithashtu, Komisioni është ai i cili mund të vendosë për themelimin e zyrave lokale në vendet tjera në territorin e shtetit përkatës, apo të themelojë ekipet mobile hulumtuese, si dhe të emërojë personat në udhëheqje të këtyre zyrave, gjegjësisht ekipeve. Komisioni, këto i bënë në konsultime me zyrat e shteteve, dhe me Komisionin Ekzekutiv. (neni 40, paragrafi 2).

Vendosja e zyreve territoriale vendore dhe e ekipeve hetuese mobile nuk është obligim, por mundësi e cila është në disponim të zyreve në shtetet përkatëse. Në të njëjtën mënyrë, zyret territoriale vendore të themeluara dhe ekipet hetuese mobile nuk është e domosdoshme që të ekzistojnë gjatë gjithë kohës deri te përfundimi i punës së Komisionit.

Neni 41.

Arkivi

Sqarim

Dokumentacioni i grumbulluar dhe baza e të dhënave të Komisionit, të cilat pas kryerjes së punës së KOMRA-së, do të jenë të vlefshme (rëndësishme), si për bashkëkohësit e konflikteve të armatosura në ish RSFJ-së, po ashtu edhe për gjeneratat e ardhshme dhe hulumtues të cilët do të analizojnë faktet, të vërtetuara gjatë punës së Komisionit. Një numër i madh i komisioneve tjera për të vërtetën, në rëndësinë e punës së arkivit, ka përfshirë planet për organizimin e arkivit në statutet e tyre.¹⁴⁹

Paragrafi 1, dhe 2.

Sekretariati ekzekutiv i Komisionit do të duhet që menjëherë pas themelimit të konstitujë Paralelen për arkiv dhe bazën e të dhënave, sepse është e pritur se Komisioni do të grumbullojë një numër të madh të deklaratave dhe dokumentacioneve. Kjo paralele duhet që në fillim të punës të definojë metodologjinë unike për arkivim dhe grumbullim të dokumentacionit dhe digjitalizim me qëllim të futjes së të njëjtave në bazën elektronike të të dhënave.¹⁵⁰ Metodologjia duhet të zbatohet, domosdoshmërisht, në të njëjtën mënyrë në të gjitha paralelet për arshivë dhe bazën e të dhënave në zyrat e shteteve (paragrafi3). Pas përcaktimit të metodologjisë, paralelja për arshivë dhe bazën e të dhënave do të ngritët në arkiv dhe bazë e të dhënave të Komisionit. Ky trup ka për detyrë grumbullimin e dokumentacionit dhe organizimin e bazës së të dhënave, njëri prej segmenteve më të rëndësishme të punës së Komisionit. Ky organ përbëhet nga arkivi në të cilin ruhen, mbrohen dhe sistemohen të gjitha dokumentet e grumbulluara dhe baza elektronike e të dhënave në të cilën vendosen të dhënat nga dokumentacioni i grumbulluar, si dhe dokumentacioni i digjitalizuar. Në periudhën e mëvonshme të punës së Komisionit, baza elektronike e të dhënave mundëson analizën komplekse dhe të sofistikuar të të dhënave të grumbulluara, duke përfshirë kategorizimin e viktimave sipas gjinisë, viteve, vendeve të

¹⁴⁹ Yasmin Sooka , anëtare e Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin të Rep. Afrik. Jugore dhe Siera Lenës, konsultimet me anëtarët e Grupit punues për hartimin e Statutit të KOMRE-s, Zagreb, 19. qershor 2010.

¹⁵⁰ Sierra Leone, nen.19.2.; Timorin Lindorë, nen.43.2; Liberi, nen.47; dhe Peru, nen., nen. 7.

prejardhjes etj. Gjithashtu, për shkak të natyrës regionale të Komisionit, është me rëndësi që të organizohet digjitalizimi i dokumentacioneve në letra, në mënyrë që të mundësohet shkëmbimi më i lehtë i të gjitha dokumenteve të grumbulluara ndërmjet arkivave në Zyrën qendrore dhe arkivave në zyrat e shteteve.

Paragrafi 3.

Ashtu siç është e rëndësishme që të funksionoj Paralelja për arkiv dhe bazën e të dhënave që nga fillimi, brenda kornizave të zyrës qendrore, po ashtu është me rëndësishme që çdo njëra prej zyrave të shteteve të themelojë paralele të njëjta përbrenda zyrave të tyre, dhe të zbatojnë metodologjinë unike për shifrimin, shenjëzimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, si dhe për shifrimin, shenjëzimin dhe vendosjen e të dhënave. Vetëm metodologjia unike dhe sistemi për menaxhimin në bazën e të dhënave mundëson nxjerrjen e përfundimeve të bazuara mirë të Komisionit.¹⁵¹

Paragrafi 4.

Për dalim nga komisionet paraprake, KOMRA duhet të përfshijë disa shtete. Kjo mund të sjellë deri te dallimi në pikëpamje lidhur me atë se ku duhet të jetë i vendosur arkivi unik pas pushimit të punës së Komisionit. Në region akoma vazhdon debati për vendin se ku do të mund të jetë i vendosur arkivi i TPNJ – se a duhet ai të jetë në Hagë (selia e Tribunalit), ose do të duhet të jetë i bartur në njërin ose në më shumë territore të palëve kontraktuese. Arkivin dhe bazën e të dhënave të zyrës qendrore dhe të zyrave në shtete, duhet konsideruar si pjesë e arkivit unik, i cili do të mundësojë qasje të njëjtë në grumbullimin e të dhënave dhe dokumentacionit. Më së voni tre muaj para përfundimit të punës së Komisionit, të gjitha arkivat dhe bazat e të dhënave të zyrave në shtete të jenë të bashkuara me Arkivin dhe bazën e të dhënave të Komisionit. Me këtë do të mundësohet bartja më e lehtë dhe më e thjeshtë e arkivave të palëve kontraktuese (paragrafi 5), dhe qasja e mëvonshme në grumbullimin e të dhënave.

Paragrafi 5.

Pas pushimit të mandatit, arkivi dhe baza e të dhënave i unifikuar i Komisionit do ti dorëzohet arkivave shtetërorë të palëve kontraktuese, dhe ose institucioneve të cilat disponojnë kapacitete për ruajtjen e tyre. Në rastet e disa Komisioneve të tjera, siç është ai i Afrikës Jugore, një pjese e arkivit i ka takuar arkivit të veçantë, të pavarur dhe historik – arkivit për të drejtat e njeriut. Nganjëherë, arkivi mund të jetë edhe pjesë e qendrave komemorative ose muzeve. Komisioni për të vërtetën dhe pajtim në Peru, për shembull, bazën e dhënave ia ka dorëzuar në ruajtje Zyrës së ombudspersonit.¹⁵²

Paragrafi 6.

Ky paragraf është në përputhje me përvojat e disa komisioneve të gjertanishme – aktet themeluese të të cilave kanë paraparë se është e rëndësishme që qasja në arkiva të jetë e hapur, por, njëkohësisht kanë

¹⁵¹ Prisila B. Heiner (*Priscilla B. Hayner*), "Të vërtetat e pa thëna" (Samizdat B92,2003) faqe 310.

¹⁵² *Ibid*, faq.311.

theksuar që dokumentet e ndjeshme dhe të besueshme (konfidenciale) duhet të kenë status special dhe të jenë të mbrojtur me masa të veçanta.¹⁵³ Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin në Liberi, për shembull, për 20 vitet e ardhshme ka kufizuar qasjen në dokumentet të cilat i ka klasifikuar si të besueshme (konfidenciale)¹⁵⁴

PJESA E X. – FINANCIMI I KOMISIONIT

Neni 42.

Financimi

Sqarim

Paragrafi 1

Financimi i Komisionit, gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, duhet të jetë paraprakisht i qartë dhe saktë i definuar, që të mundësohet fillimi i mbarë i punës së Komisionit. Siç është paraparë që Komisionin do ta përbëjnë 20 anëtarë/anëtare të cilët i emërojnë kryetarët e palëve kontraktuese, për të realizuar qëllimet dhe detyrat e Komisionit, të parapara sipas neneve 13 dhe 14, të këtij Statuti, nga i cili rrjedhë autoriteti i Komisionit, është në interes të palëve kontraktuese që përmes kontributeve të financojnë punën e organeve ndërkombëtare. Kontributet e anëtareve paraqesin pjesën më të madhe të mjeteve për financim të Komisionit, dhe ato do të duhej të mbulojnë të gjitha shpenzimet të cilat janë të ditura që më parë, dhe me të cilat sigurisht se do të mund të sasinë e punës së tërësishme të Komisionit, në realizimin qëllimeve dhe detyrave të saj.

Financimi i Komisionit të masën më të madhe është nga kontributet e shteteve të cilat e formojnë, kjo është praktika më e shpeshtë e themelimit të komisioneve për të vërtetën, deri tani. Disa komisione të mëhershme, me numër më të vogël të të punësuarve, në tërësi janë financuar nga shteti i cili i ka themeluar, sikur ajo në Kil dhe Argjentinë, por, më vonë shumica e komisioneve janë financuar pjesërisht nga shtetet të cilat i kanë themeluar dhe pjesërisht nga kontributet dhe donacionet e qeverive të shteteve tjera.¹⁵⁵

Sipas mendimit të ekspertëve për çështjet e komisioneve për të vërtetën, është e pranueshme që të gjitha mjetet e nevojshme për punën e Komisionit të sigurohen me rastin e themelimit të komisionit, por kjo rrallë herë ka ndodhë deri tani. Megjithatë, është me rëndësi të ceket, se disa komisione të cilat nuk i kanë siguruar fondet e financimit para fillimit të punës, janë ballafaquar me vështirësi të mëdha gjatë punës dhe funksionit të komisionit. Rasti i tillë ka qenë me komisionin në Haiti, i cili nuk i ka siguruar mjetet financiare që nga fillimi, dhe nuk ka pasë plan të qartë të financimit që nga fillimi, prandaj i është dashur ta shtyj fillimin e punës, si dhe i ka humbë një pjesë të të punësuarve në Komision, sepse nuk ka qenë në gjendje tu ofrojë kontratat e punës më gjatë se një muaj.¹⁵⁶

¹⁵³ Peru, nen.7

¹⁵⁴ Timori Lindor, 43.2; Kenia, 50(2).

¹⁵⁵ Liberija, 47.

¹⁵⁶ Priscilla B.Hayner, *Unspeakable Truths: Transitional Justice and the Challenge of Truth Commission* (2. botimi, 2010.), str.217.

Përvojat e komisioneve tjera, gjithashtu na tregojnë për aktivitetet financiare dhe realizimin e detyrave, me qëllim të arritjes së qëllimit të saj, dhe paraqet sfida të madhe për themeluesin, nga i cili pritet të sigurojë shumicën e donacioneve. Megjithatë, sipas përvojave të deritashme të komisioneve për të vërtetën, vetëm komisionet ët cilat kanë qenë mire të financuara dhe të mbajtura, kanë arritur të realizojnë qëllimet e tyre dhe përmbushin detyrat e tyre. Komisioni për të vërtetën dhe pajtim në Afrikën e Jugut, me 17 komesarë dhe rreth 300 punonjës, për dy vite e gjysmë të punës aktive, gjatë së cilës kohë ka marrë deklaratat prej rreth 22,000 viktimave dhe i ka mbledhë rreth 7000 aplikacione të kryesve lidhur me krimet e kryera, i ka shpenzuar gjithsej 35 milion dollarë, përderisa Komisioni në Guatemalë për sqarimin historik të asaj kohe ka shpenzuar rreth 10 milion dollarë.¹⁵⁷ Komisionet e mëvonshme, si ai në Keni apo Kanadë kanë buxhet më të madh – Qeveria e Kanadës ka planifikuar që për pesë vite të shpenzojë 57 milionë dollarë, përderisa për shpenzimet e komisionit të Kenisë janë paraparë rreth 30 milionë dollarë për periudhën prej dy vite e më shumë.¹⁵⁸

Paragrafi 2

Kontributet nga paragrafi 2, të këtij neni sigurohen nga buxheti i palëve kontraktuese. Ato mjete sigurohen me procedurë të rregullt buxhetore të të gjitha shteteve anëtare të Komisionit, dhe vihen në dispozicion të Komisionit sipas dinamikës të cilën Komisioni e parasheh me palët kontraktuese, dhe në propozim të Sekretariatit Ekzekutiv, në pajtim me shpenzimet dhe kohën e paraparë, planifikon buxhetin e Komisionit, e në bazë të tij edhe dinamikën e pagesave të kontributeve të palëve kontraktuese.

Paragrafët 3 dhe 4

Kontributet e palëve kontraktuese do të vërtetohen në bazë të marrëveshjes mes palëve kontraktuese për mënyrën e shpërndarjes së mjeteve.

Përqindja e vlerave të kontributeve të palëve kontraktuese janë fikse dhe aplikohen, si në vlerën e përgjithshme të nevojshme të funksionimit të Komisionit, gjatë kohës së zgjatjes së tij, po ashtu edhe në bazë vjetore të kontributeve të palëve kontraktuese.

Paragrafi 5

Duke e ditur rëndësinë e Komisionit në kuptimin e gjerë dhe ndikimin e saj në procesin e vërtetimit të fakteve, pritet të ketë interesim të madh të organizatave ndërkombëtare, si dhe të personave vendor juridik, që të marrin pjesë në financimin e një organi të tillë të rëndësishëm, dhe të japin kontributin e tyre direkt në krijimin e sërishëm të besimit në territorin e ish RSFJ-së.

Praktikë e njëjtë e marrjes së donacioneve nga ana e organizatave ndërkombëtare apo shteteve tjera, është pranuar nga ana e shumë komisioneve për të vërtetën të themeluara që nga fillimi i viteve 1990. Fondi Amerikan i Fordit ka ndarë donacionin prej 93,300 dollarë për komisionin në Ugandë, 1987, me qëllim të përfundimit të punës së saj.¹⁵⁹ Nga komisioni Jugo-afrikan, e cila 15% të mjeteve i ka siguruar nga donacionet e huaja, ndërsa 85% ia ka ndarë Qeveria e Afrikës Jugore, këtë praktikë e kanë pranuar gati të gjitha komisionet.

¹⁵⁷ Njejtë.

¹⁵⁸ Njejtë.fq.269.

¹⁵⁹ Njejtë.fq.273.

Qeveria e Guatemalës ka ndarë rreth një milion dollarë nga buxheti i përgjithshëm të komisionit, i cili ka qenë rreth 10 milion dollarë, përderisa pjesa tjetër është marrë nga 13 shtete të ndryshme dhe dy fondacioneve – qeveria e Norvegjisë dhe e Zvicrës kanë donuar nga 1,2 milion dollarë, Suedia dhe SHBA-të nga 2 milion dollarë, Japonia ka donuar 750,000 dollarë, Gjermania dhe Danimarka nga 500,000 dollarë, ndërsa Austria, Belgjika, Kanada, Italia, Holanda dhe Zvicra kanë ndarë nga 250,000 dollarë apo më pak. Përpos kësaj, për këtë komision, Fondacioni i Fordit për shoqëri të hapur nga Nju Jorku, ka ndarë donacion apo mbështetje në logjistikë.¹⁶⁰ Qeveria e Liberisë ka financuar rreth 60% të shpenzimeve të punës të buxhetit të përgjithshëm për komisionin, prej më shumë se shtatë milion dollarë, me ç'rast ka ndarë rreth 1% nga buxheti i saj i përgjithshëm për punën e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin.¹⁶¹

Paragrafi 6

Donacionet, si burim shtesë në financimin e Komisionit, sipas definimit të saj paraqet kontributet vullnetare të organizatave ndërkombëtare dhe personave vendor juridik, të cilët e kanë në interes që të jenë pjesë e procesit të vërtetimit të fakteve, i cili do të duhej të rezultojë me pranimin e padrejtësisë të shkaktuar viktimave, dhe dhënien e kontributit në realizimin e të drejtave të viktimave, pranimin e fakteve për krimet e kryera të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, zbardhjen e fatit të të zhdukurve dhe parandalimin e përsëritjes së krimeve në territorin e ish RSFJ-së.

Këto mjete mund të sigurohen përmes marrëveshjes direkte me palët e interesuara, apo përmes konferencave të donatorëve, të cilat do të organizoheshin me qëllim të njoftimit të donatorëve për rolin, detyrat, qëllimet dhe aktivitetet e Komisionit.

Mjetet e siguruara në këtë mënyrë mund të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve shtesë të Komisionit, për shpenzimet e pa planifikuara të cilat mund të paraqiten gjatë punës së Komisionit, si dhe qëllimet e caktuara për të cilat merret vesh direkt me donatorin. Në pajtim me pikat e lartpërmendura, donacionet paraqesin „mjetet me të cilat menaxhohet direkt“ dhe për shpenzimin e tyre Komisioni është përgjegjës i drejtpërdrejt te donatorët.

Paragrafi 7

Paragrafi 7, i këtij neni, definon kufizimin për palët, që kontributet në të mira materiale, nuk mund të vlerësohen si pjesë e kontributit, të cilin janë të obliguara ta sigurojnë për funksionimin e rregullt të Komisionit. Në këtë rast, mund të parandalohet, që nëse ndonjëra palë kontraktuese siguron hapësirën punuese për zyrën e Komisionit, gjatë kohës së punës së saj apo dhuron automjetin zyrtarë për nevojat e Komisionit, të kërkojë që vlera e caktuar, sipas nenit 42, paragrafi 2, të zvogëlohet paralelisht me vlerën e kontributit të dhënë në të mira materiale.

¹⁶⁰ Njejtë.217.

¹⁶¹ Njejtë, fq.333.

Neni 43.

Raportimi financiarë

Sqarim

Në pajtim me nenin 39, Sekretariati Ekzekutiv, detyra e të cilit është të ofrojë ndihmën teknike, administrative dhe mbështetjen e operativës për Komisionin, dhe koordinimin e punës mes zyrave të ndryshme, të themeluara në palët kontraktuese, do të jetë direkt kompetent, që pos tjerash, të sigurojë raportimin me kohë lidhur me shpenzimin e buxhetit dhe donacioneve, në pajtim me rregulloret financiare. Sekretariati ekzekutiv, apo departamenti i financave, përpos përgatitjeve të planeve financiare në pajtim me rregulloret e planifikuara dhe shpenzimet, do të përgatisë raportet e rregullta për rrjedhën dhe dinamikën e arritjes së donacioneve dhe shpenzimin e tyre, në periudha të caktuara, në baza tremujore dhe vjetore, dhe në pajtim me standardet financiare ndërkombëtare.

Raportet e Sekretariatit ekzekutiv do të jenë në dispozicion për revidim nga revidorët, dhe rezultatet e revizorëve pas procedurës adekuate së bashku me komente, Komisioni do t'ia ofrojë në dispozicion opinionit publik.

Në këtë mënyrë sigurohet niveli më i lartë i kontrollës së mjeteve, si të të hyrave, ashtu edhe i shpenzimeve, dhe siguron qasje transparente në punën e Komisionit, që do tu mundësojë palëve kontraktuese dhe donatorëve të shohin se në çfarë mënyre dhe si janë shpenzuar mjetet të cilat ata i kanë siguruar. Gjithashtu, në këtë mënyrë, edhe ata të cilët financojnë në mënyrë indirekte, do të kenë mundësinë të kenë qasje në shikimin e punës së Komisionit.

PJESA XI – RAPORTI PËRFUNDIMTAR I KOMISIONIT

Neni 44.

Hartimi dhe publikimi i Raportit përfundimtarë

Sqarim

Paragrafi 1.

Secili Komision për të vërtetën është i obliguar që vërtetimin e fakteve, për shkeljen e të drejtave të njeriut, të hartojë raportin, dhe atë raport ta bëjë publik me qasje për publikun.¹⁶²

¹⁶² Njejtë, fq.218.

Paragrafi 2.

Ceremonia e dorëzimit të Raportit përfundimtarë shefit të shtetit është një prej ngjarjeve më të rëndësishme në punën e Komisionit. Pranimi i Raportit është një formë e rëndësishme e pranimi zyrtarë të vuajtjeve nëpër të cilat kanë kaluar viktimat, dhe paraqet nxitje për qeveritë dhe shoqëritë që të implementojnë rekomandimet. Në Çile, kryetari *Ajlvín* gjatë transmetimit televiziv të ceremonialit të dorëzimit të raportit, i ka lutur viktimat për falje, dhe ka theksuar nevojën për pajtim, ndërsa nga forcat e armatosura ka kërkuar që të pranojnë dhimbjen të cilën e kanë shkaktuar.¹⁶³

Paragrafi 3.

Raportet përfundimtare të Komisioneve për të vërtetën zakonisht janë dokumentacione voluminoze, shpesh edhe me mijëra faqe. Rezymeja e Raportit që është paraparë për publikim është në shërbim të asaj, para së gjithash, që të sigurojë qasjen në gjetjet të cilat Komisioni i ka pasqyruar në Raport. Disa prej Komisioneve për të vërtetën janë përcaktuar për hartimin dhe publikimin e raportit shumëtonësh.¹⁶⁴ Në disa raste, rezymeja e raportit është bërë burim i lexueshëm dhe i hapur për qasje për të gjithë – si shembull mund të përmendet rezymeja e Raportit të Komisionit të Argjentinës për të humburit “*Nunca mas*”, i cili është bërë bestseller kombëtar.¹⁶⁵ Ndërsa, disa prej komisioneve tjera kanë publikuar pjesë të raportit në formë të përmbledhjes në gazetatat me tirazhin më të madh si javore, po ashtu edhe ato ditore.¹⁶⁶

Për shkak të mandatit të gjerë të KOMRA-së, si dhe për shkak të natyrës dhe shpërndarjes gjeografike të konflikteve në territorin e ish RSFJ-së, çka kërkon hartimin e raportit shumëtonësh, është e nevojshme që të gjendet një zgjidhje në mënyrë që faktet dhe përfundimet, deri te cilat vije Komisioni, të jenë të prezantuara për publikun mundësisht sa më të gjerë. Për këtë shkak, neni 44, paragrafi 3, i Statutit parasheh obligimet e Komisionit që me dorëzimin e Raportit përfundimtar, njëkohësisht, të bëjë të hapur për qasje edhe rezymenë e Raportit përfundimtar.

¹⁶³ Prisila B. Heiner (*Priscilla B. Hayner*), “*Të vërtetat e pa thëna*” (Samizdat B92,2003) faqe 60.

¹⁶⁴ Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin, Peru, Raporti është publikuar në 9. vëllime, shiko <http://usip.org/resources/truth-commission-peru-01>; Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin, Afr. e Jugut, Raporti është publikuar në 7. vëllime, në drponim në <http://usip.org/resources/truth-commission-south africa>, konsultuar me 2. shtator 2010.

¹⁶⁵ Marijana Toma dhe Jelena Simic, “Vërtetimi dhe zbardhja e fakteve për të kaluarën” (2008), në disponim në http://ëëë.korekom.org/public/fck_files/Iskustvo%20drugih-Marijana%20Toma%20i%20Jelena%20Simic-16_12_2008_.pdf, konsultuar me 2. shtator 2010.

¹⁶⁶ Office of the UN High Commissioner for Human rights, Rule of Laë Tools for Post-Conflict Societies, Truth Commissions (2006), në disponim në <http://ëëë.ohchr.org/Documents/Publications/Ruleof laëTruthCommisionsen.pdf>, është konsultuar me 2. shtator 2010.

Përmbajtja e Raportit përfundimtarë

Sqarim

Paragrafi 1.

Raportet e Komisioneve të deritanishme përmbajnë përmbledhjen e të gjitha fakteve relevante, për të cilat Komisioni ka pasur mandat që ti hulumtoj dhe vërtetojë. Faktet janë paraqitë në formë narrative, por përmes treguesve të statistikës, aty ky është e mundshme, dhe në bazë të të dhënave të mbledhura. Megjithatë, komisionet në raportet e tyre, zakonisht paraqesin edhe rekomandimet e tyre për themeluesit në lidhje me masat të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të zgjedhjes complete të problemit, të cilat janë rezultat i krimeve të kryera në të kaluarën.¹⁶⁷ Raporti i KOMRA-së, do të, me elementet e paraqitura të cilat përmbajnë gati të gjitha raportet përfundimtare, përmbajnë edhe listat e humbjeve në njerëz, vendet e burgimeve, personave të burgosur në mënyrë jo ligjore, dhe personat që kanë përjetuar tortura. Këto lloje të dhënave i kanë përmbajt raportet e disa komisioneve për të vërtetën, ato të cilat kanë qenë në mundësi ti sigurojnë informata të mjaftueshme.

Në raportin përfundimtar do të gjinden edhe paraqitja e rrethanave politike dhe shoqërore, ët cilat [duke filluar nga viti 1980] kanë kontribuar bindshëm në shpërthimin e luftërave apo të konflikteve të armatosura, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të të drejtave të njeriut.

Paragrafi 2, pika b.

Ky nen parasheh propozimin për hartimin e modelit të reparacioneve materiale dhe simbolike, në formë të kompensimit material, shënimit të vendit të vuajtjeve, vendosjen e përmendoreve dhe ndërtimin e muzeve. Rekomandimet do të përfshinin edhe propozimin për reformën e institucioneve dhe mekanizmave me të cilët do të sigurohej integrimi i fakteve të vërtetuara në sistemet arsimore – edukative të palëve kontraktuese në formë të ndryshimit të përmbajtjeve në librat shkollore të historisë dhe krijimit të shënimeve të përbashkëta historike mbi krimet nga vitet 1990, në përputhje me parimet themelore dhe udhërrëfyesit për të drejtën në apelim dhe reparacion për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave ndërkombëtare njerëzore dhe shkeljeve serioze të të drejtave humanitare

dërkombëtare, të miratuar me Rezolutën e Asamblesë së përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në vitin 2005.¹⁶⁸

¹⁶⁷ "The commission's final report, summarizing its findings and recommendations, will serve as its most enduring legacy." Office of the High Commissioner for Human Rights, *Rule of Law Tools for Post-Conflict Societies, Truth Commissions*, str. 26, mund ta shikoni në www.ohchr.org/Documents/Publications/RuleoflawTruthCommissionsen.pdf.

¹⁶⁸ Basic Principles and Guidelines on the Right a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of Interanational Human Rights Laë Rights and Serious Violations of Interantional Humanitarian Laë. Të miratuara me rezolutën e Asamblesë së Përgjithëshme të Kombeve të Bashkuara , nr.60/147, dt. 16. dhjetor, 2005.

Paragrafi 2, pika c.

Zgjidhja e ngjashme me propozimin e Grupit punues për hartimin e Statutit ishte e paraparë, për shembull, sipas rregullores në bazë të cilës është bërë themelimi i Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në Peru, në bazë të përvojës së komisioneve të përparshme, të cilat nuk dispononin mekanizma që do të përfaqësonin garancionin lidhur me atë se shteti do të zbatojë rekomandimet lidhur me korrigjimin e padrejtësive nga e kaluara.¹⁶⁹

Neni 46.

Gjetjet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut

Sqarim

Paragrafi 1.

Komisionet për të vërtetën paraqesin formën e komisioneve hetuese (*Commissions of Inquiry*). Është e zakonshme që komisionet hetuese të nxjerrin përfundime lidhur me atë se personi i caktuar me veprimet e tija ose me mosveprimet ka vepruar në kundërshtim me standardet për respektimin e të drejtave të njeriut. Një praktik e tillë është në përputhje me interesin legjitim të opinionit që të jetë i njoftuar me të gjitha faktet relevante lidhur me çështjen se për çka themelohet Komisioni. Identiteti i personave të cilët janë përgjegjës për shkelje, gjithsesi, paraqet një fakt të tillë relevant.

Gjatë dhjetëvjetëshit të kaluar numri më i madh i komisioneve për të vërtetën, në raportet e tyre finale kanë theksuar emrat e personale të cilët, sipas të dhënave të grumbulluara, kanë qenë të kyçur (përfshirë) në shkeljen e të drejtave të njeriut. Shembujt përfshijnë Komisionet në Peru, Siera Leone, Timori Lindor, Ganë, Paraguaj, Liberi dhe Ekuador.¹⁷⁰ Komisionet hetimore në shtetet anglosaksone, me një traditë shumëshekullore të sundimit të së drejtës (ligjit), gjithashtu në raporte hulumtojnë edhe rolin e individëve.¹⁷¹

Mirëpo, Komisioni për të vërtetën nuk është Gjykatë, kështu që gjetja mbi veprimin e ndonjë personi nuk ka për pasojë vuajtjen e dënimit me burg ose ndonjë sanksion tjetër penal –juridik (ligjor). Prandaj,

¹⁶⁹ Peru (2001), nen.2.

¹⁷⁰ Komisioni në Ekuador, p.sh. në Raportin përfundimtarë , të publikuar në qershor të vitit 2010., i ka vendosur sipas rendit alfabetik emrat e personave të cilët janë përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut në periudhën 1984-2008, me përshkrim të shkurtër për veprimet e atyre personave, udhëzimi në pjesë të caktuara të raportit që përmbajnë përshkrimin më në detaje mbi shkeljet, dhe, atje ku ishte e mundur, edhe me fotografinë e kryerësit . Comision de la Verdad, *Sin Verdad No Hay Justicia: Informe de la Comision de la Verdad (2010), vëllimi 5. pjesa 2.* (“Listado alfabetico de los presuntos responsables y su grado de participacion”)

¹⁷¹ Një prej shembujve të tillë të fundit është edhe raporti i ashtuquajtur Komisionit *Saville* , në *Britaninë e Madhe*, nga qershori i vitit 2010, lidhur me ngjarjet e dt. 30. janar 1972, në Derry, qytete në Irlandën Veriore. Raporti, në disa kapituj, hulumton përgjegjësinë e 4. oficerëve britanik, të cilët kanë udhëhequr me operacionin në Derry, kur ushtarët britanik kanë hapur zjarr në katolikët irlandez-pjesëmarrës të demonstratave , dhe ka vrarë 13 njerëz. Report of The Bloody Sunday Inquiry, vëllimi VIII, krrerët 169-172.

Komisioni nuk vërteton përgjegjësinë penale të ndokujt, me pasoja të cilat do të dilnin nga një veprim i tillë. Prandaj, niveli i fakteve i cili arsyeton të përmendurit e emrit të kryerësit në raport, është më i ulët se sa niveli për nxjerrjen e aktgjykimit për dënim në procedurë penale. Në praktikë, Komisioni për të vërtetën, dhe në literaturë për të drejtën transitorë, mbisundon qëndrimi që standardi i të ashtuquajturës baraspesha e probabilitetit (*Balance of probabilities*) i përgjigjet karakterit të Komisionit për të vërtetën. Standardi i tillë nënkupton që ekzistimi i faktit të caktuar është më i mundshëm se sa mosekzistimi i të njëjtit.¹⁷²

Përpos që të gjeturat e Komisionit nuk kanë efekt të vendimit të gjykatës, me te nuk prejudikohet vendimi final i procesit eventual gjyqësor (penale), procesit në të cilin përdoren standardet e larta të dëshmisë (jashtë dyshimit të arsyeshëm).

Paragrafi 2.

Edhe përkundër asaj që Komisioni nuk vërteton përgjegjësinë penale dhe nuk shqipton sanksione penale, publikimi i emrit të kryerësit të mundshëm, mund të ketë pasoja negative për atë person. Pasojat e tilla kanë të bëjnë me gjykimin moral në bashkësinë në të cilën ku ai person jeton, por edhe me mundësinë e humbjes së punës ose ekspozimit të ndjekjes penale.¹⁷³ Prandaj, është me rëndësi që Komisioni krahas asaj që i bazon të gjeturat e veta në fakte (prova) mjaft të fuqishme, i mundëson kryerësit të supozuar që të deklarohet për gjetjet të cilat tregojnë për përgjegjësinë e tij. Masat nga paragrafi 2 sigurojnë që për procedurë të drejt (njëri nga parimet e veprimit të Komisionit, neni 10 i Statutit), të jetë e përmbushur. Komisioni vetë do të vlerësojë se në çfarë mënyre do të informojë personin mbi përmbajtjen e gjetjes së propozuar dhe në çfarë mënyre do të ketë mundësi që personi të deklarohet për gjetjen. Njëra prej mundësive është që personi të jep deklaratë gojore para Komisionit, duke përfshirë edhe deklaratën në dëgjimin publik. Mirëpo, personi mund të dërgojë edhe deklaratën me shkrim.¹⁷⁴ Në punën e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim në Republikën e Afrikës së Jugut, deklaratat me shkrim në një numër rastesh kanë sjellë deri te ajo që emri i personit nuk ishte i përfshirë në listën e kryerësve të mundshëm.¹⁷⁵

Obligimi i Komisionit nga paragrafi 2 nuk mund të jetë i plotësuar në raport me kryerësit potencial, të cilët nuk janë të gjallë. Në ato raste Komisioni duhet të jetë, posaçërisht, i kujdesshëm, me rastin e vlerësimit se të dhënat e grumbulluara a janë në atë masë të bindshëm që të tregojnë në përgjegjësinë e personit, dhe që do të arsyetojnë vendosjen e një vlerësimi të tillë në raport.

¹⁷² Mark Freeman, *Truth Commissions and Procedural Fairness* (Cambridge University Press, 2006) faqe 282., fusnota 53; Nacional Reconciliation Commission Report (Gana), kreu 2., ("Understanding and Giving Effect to the Mandate"), par.2.3.3.6.2.Për zbatimin e standardit të "balansimi i probabilitetit", shprehimisht janë thirrur edhe raportet e komisioneve si në: A. E Jugur (vëllimi 1, kreu4.("The Mandate"), par.155&157); Haitit , Kreu5. (Presentation general des cas"); S. Leone, vëllimi2. kreu 2 ("Findings"), par.7, dhe Ganë, kreu 2 ("Understanding and Giving Effect to the Mandate"), par.2.3.3.6.2.

¹⁷³ Mark Freeman, vër.cit.faq.114.

¹⁷⁴ Shiko , në këtë temë, rekomadimet e komisionit australian për reformën e legjislativ , Final Report-making Inquiries: A Neë Statutory Framework (ALRC Report 111), 4. shkurt 2010., faq.379, par.15.31, <http://ëëë.alrc.gov.au/inquiries/current/royal-commissions/ALRC111/index.htm>.

¹⁷⁵ Prisila B. Heiner (*Priscilla B. Hayner*), "Të vërtetat e pa thëna" (Samizdat B92,2003) faqe 178-179.

Paragrafi 3.

Dispozita mbi të drejtën diskrete të Komisionit që në Raportin përfundimtarë të udhëzojë në aktgjykimin përkatës, i mundëson Komisionit që opinionin ta njoftojë me atë se si është kualifikuar shkella e të drejtës nga ana e gjykatës, dhe për cilin rast konkret bëhet fjalë. Komisioni, duke udhëzuar në aktgjykimin e dhënë dhe kualifikimin juridik që përmban i njëjti, i mundëson opinionit që të arrijë deri tek njohurit më të plota mbi ngjarjen të cilën e ka hulumtuar.

Komisioni është i obliguar që në raportin përfundimtarë të udhëzojë në vendimet e e marra. Përpos kësaj, vetëm në raste ekstreme, mund të paramendohet që Komisioni mund të konstatojë se të gjeturat nga gjykimi nuk janë me bazë: nëse Komisioni i vërteton këto fakte të reja, të cilat në mënyrë evidente mund të jenë vendimmarrëse për gjykimin, pjesërisht apo tërësisht, që janë marrë gabimisht.

Edhe pse ka mundësi që Komisioni të arrijë deri te faktet, të cilat tregojnë në atë se faktet gjatë gjykimit nuk kanë qenë të vërtetuara si duhet, ajo mundësi nuk përjashtohet me detyrimin nga Komisioni, që edhe para fillimit të punës të pranojë – si jo të dyshimta – të gjitha faktet e vërtetuara në procedurën gjyqësore. Zgjidhja e propozuar nga neni 46, paragrafi 3, është në pajtim me logjikën, e cila përcillet nga ligji për vepra penale në palët kontraktuese, gjegjësisht dispozitat e atyre ligjeve për të ashtuquajturat përsëritje të gjykimeve. Më këto dispozita lejohet përsëritja madje edhe e procedurës penale, i cili është i mbyllur plotfuqishëm; përsëritja është gjykimit është e lejuar nëse janë gjetur fakte të reja dhe dëshmitë, të cilat mund të sjellin deri te një vendim ndryshe, nga ai i marrë më herët.¹⁷⁶ Ti ndalohej KOMRA-së që në zbardhjen e fakteve të reja, të tregojë në vlerësimin e gabuar të situatës në gjykim, do të ishte ngjashëm me ndalimin e procedurës penale të përsëritur, që do të ishte vendim i gabuar.

Nuk ekziston mundësia e vërtetë, që Komisioni vetë të sjellë konkludimet me të cilën do të zhvlerësoheshin vendimet, të cilat bazohen fuqishëm në fakte (të tilla janë shumica), dhe me të edhe pranimin e krimit dhe vuajtjeve të paraqitura në gjykime. Së pari, kriteret dhe procedurat rigorozë për zgjedhjen e komisionerit – procedura të cilat përfshijnë rolin e rëndësishëm të shoqatave të viktimave dhe organizatave joqeveritare – garanton qëndrimin personal kredibil të Komisionit. Pra, vetëm nëse Komisioni vërteton faktet e reja, për të cilat është evidente që faktet vendimtare të aktgjykimit pjesërisht, apo tërësisht janë identifikuar gabimisht, do të mund të pritët që Komisioni të paraqesë gjetje tjetër nga gjykata.

Paragrafi 3, i përjashton vendimet të cilat janë marrë në mungesë të të akuzuarit, nga radha e gjykimeve në të cilat mund të udhëzojë Komisioni, pasi që ato gjykime janë kontestuese nga aspekti i standardeve për gjykim të drejtë.

¹⁷⁶ Ligji për vepra penale, Sl. List SRJ, nr. 70/01, dhe 68/02, Sl. G717asnik777 Rep. Srbije, nr. 58/04. posl. ndryshimet 72/09, nen. 415-418, Ligji për vepra penale, Sl. List C.G, nr ver. Cit.nr. 57/2009 dhe 479/2010, nen. 423-426; Ligji për vepra penale, Gaz. Zyrtare 44/2008, neni. 442; i, Ligji për vepra penale, Sl. list SRJ, nr. 70/01 i 68/02 i Sl. glasnik Rep. Serbsje, br. 58/04, ndryshimet e fundit 72/09, neni. 407.

Neni 47.

Obligimi i Parlamentit dhe qeverisë që të shqyrtojnë Raportin përfundimtarë

Sqarim

Neni 47 siguron që pas publikimit të Raportit përfundimtarë, pushteti ekzekutiv dhe legjislativë në çdo palë kontraktuese të shqyrtojnë me kujdes të veçantë gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit. Neni është hartuar në bazë të projektligjit për të vërtetën, të drejtën dhe pajtimin, të cilën e kanë përgatitur ekspertët e Qendrës ndërkombëtare për të drejtën transitorë në vitin 2008, me organizatat e shoqërisë civile në Keni.¹⁷⁷ Edhe pse më pak e detajuar, zgjidhja me të cilën parashikohet obligimi i pushtetit ekzekutues dhe parlamentar që të shqyrtojnë raportin e Komisionit për të vërtetën, nuk janë të pazakonshme në praktiken krahasuese. Ligji për themelimin e Komisionit në Afrikën e Jugut ka paraparë, në atë mënyrë, edhe obligimin e kryetarit të shtetit, që në afat prej 2 muajsh pasi që Komisioni të ia dorëzoj /Raportin, të dorëzoj Raportin e Komisionit në parlament.¹⁷⁸ Ligji në Keni ka obliguar ministrat kompetent që të dorëzojnë Raportin për shqyrtim në parlament në afat prej 21 ditësh nga dita e publikimit.¹⁷⁹

Duke marrë parasysh se sesioni i parlamentit (nga paragrafi 1) në të cilin diskutohet për Raportin, thirret në afat më të shkurtër se tre muaj pas dërgimit të Raportit, do të thotë në periudhën në të cilën Komisioni akoma ekziston (shih nenin 50), është e rëndësishme që në seancat e parlamentit të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e Komisionit.

PJESA XII – TË NDRYSHME

Neni 48 .

Veprat penale dhe sanksionet

Sqarim

Ligjet me të cilat themelohen komisionet për të vërtetën, si dhe ligjet me të cilat rregullohet puna e komisioneve hetuese, parlamentare dhe jo-parlamentare, gati pa përjashtim, të gjitha përmbajnë edhe dispozitat për vepra penale, me të cilat rrezikohet puna e komisionit, dhe për sanksionet për ato vepra.

¹⁷⁷ The Truth , Justice and Reconciliation Bill, 2008- Civil Society Draft (Ligji për zë vërtetën dhe pajtimin-projekt i shoqërisë civile), nëntor 2008, nen51 (Responsibilities of the Government of Kenya, the National Assembly and the KNCHR”).

¹⁷⁸ Afrika e Jugut, nen.44.

¹⁷⁹ Kenia, nen.42, par.3.

Në Sqarimin, lidhur me nenin 16, të Statutit, qartë janë paraqitur dispozitat për ndëshkimet në praktikën krahasuese, ndërsa këtu kjo mund të paraqitet si vijon:

- Legjislacioni në shtetet siç janë Kanada, Austria, Zelanda e re, Belgjika, Gjermania, Izraeli, etj, parashohin ndëshkimet (sanksionet) për personat të cilët refuzojnë ti dhënë informatat komisionit hetues;¹⁸⁰
- Aktet themeluese të shumë komisioneve për të vërtetën, parashohin që refuzimi për të dëshmuar para komisionit, automatikisht pason me ndëshkimin, me gjobitje në të holla apo me burgim, (Afrika e Jugut, Gana), në disa shtete dënimi me burg është deri në dy vite e gjysmë.;¹⁸¹
- Përvojat e tilla kanë filluar të përcillen në vendet post-jugosllave, të cilat punën e komisioneve hetuese parlamentare e rregullojnë me ligj:
 - Ligji në Kroaci për komisionet hetuese parasheh dënimin me të holla dhe dënimin me burg, për personat të cilët nuk i përgjigjen ftesës së Komisionit për dëshmi apo dhënie të informatave të cilat i dinë ata;¹⁸²
 - Ligji në Kosovë për hetimet parlamentare autorizon komisionin anketues që të kërkojë iniciativën për procedurë penale kundër personave të cilët nuk dëshmojnë, në pajtim me obligimin e tij, të paraqitur në dispozitat e ligjit për veprë penale.¹⁸³

Kësaj duhet shtuar se Ligjet relevante parashohin ndëshkimet (sanksionet) edhe për veprat tjera penale, e jo vetëm për refuzim të dëshmisë apo të dhënies së dokumenteve. Në radhën e veprave ndëshkuese bëjnë pjesë edhe:

¹⁸⁰ Për shembull,

- Ligji në Zelandën e re, për Komisionet Hulumtuese parasheh që personi i cili nuk i përgjigjet ftesës së komisionit të dëshmojë para komisionit hetues apo t'ia dorëzojë dokumentacionin, mund të dënohet me mjete net ë holla deri në 1,000 dollarë, përveq kësaj mund të denohet vazhdimisht edhe me denim me burg nga shtatë ditë.
- Ligjet të cilat janë në Itali, para formimit të çdo komisioni hetimor të parlamentit Italian, zakonisht parashohin që në dëshmitë para komisionit të aplikohet neni 372, i Ligjit penal; sipas të cilit nen, personi i cili refuzon t'i tregojë të dhënat për të cilat ka njohuri, dënohet me denim me burgim prej dy deri në gjashtë vite. ;
- Në Belgjikë, Ligji për hetimet pralamentare parsheh dënimin me burg në kohëzgjatje prej 8 ditë deri në 6 muajë, së bashku me dënimin në të mjete (në të holla), për personin i cili refuzon të dëshmojë para komisionit hetimor;
- Ligji Izraelit për komisionet hetuese parasheh dënimin me dënim me burg deri në dy vite, për personin i cili në mënyrë të përsëritur refuzon të dëshmojë para komisionit apo t'ia ofrojë të njejit dokumentacionin e kërkuar në dispozicion.

¹⁸¹ Afrika e Jugut neni. 39, Liberia, pjesa 28, Kenia, neni. 7, st. 4, Ujdhesat Solomone, neni. 9, st. 2, Siera Leone, neni. 9, st. 2; Izrael, Ligji për komisionet hetuese, 5729-1968, ndryshimet nga viti 1972. neni. 24A.

¹⁸² Ligji për komisionet hetuese, *Narodne novine Rep Kroacisë*, nr. 24/96, neni. 25.

¹⁸³ Ligji nr. 03 L-176, për hetimet parlamentare, 4. jun 2010., *Sl. list Rep. Kosovës*, nr. 74/2010., 20. gusht 2010., neni. 19, st. 10.

- Dëshmia e rrejshme;¹⁸⁴
- Përdorimi i kërcënimit apo dhunës, si dhe dhënia e mitos, me qëllim të bindë personin për dhënie të dëshmisë së rrejshme, apo për mosdhënie të dëshmisë;¹⁸⁵
- Shkatërrimi i dokumenteve apo mjeteve, me qëllim të pengimit të Komisionit që të kryejë hetimin;¹⁸⁶
- Zbulimi i të dhënave të cilat komisioni i ka marrë me kusht konfidencialiteti¹⁸⁷
- pengim i përgjithshëm në punën e komisionit, gjegjësisht bënë ndikim të palejuar në te;¹⁸⁸

Paragrafi 1.

Me dispozitat mbi veprat penale dhe sanksionet sigurohet mbrojtja e Komisionit nga obstrukcionet nga ana e të punësuarve në strukturat e pushtetit si dhe nga personat tjerë, por po ashtu iu jep edhe efekt disa dispozitave në Statut të cilat parashohin ndalesa për komisionar dhe personel të Komisionit. Me ratifikimin e Statutit, kontrata e tillë ndërkombëtare do të bëhet pjesë e sistemit juridik të palëve kontraktuese, dhe nuk ka pengesa që këto vepra penale të zbatohen pa pasur nevojë për plotësimin e ligjeve penale.

Pika b. (nxitja për dhënien e të dhënave të rrejshme ose mos dhënia e të dhënave),

- (Asgjësimi i fakteve), dhe d. (zbulimi i të dhënave kofidenciale) janë njëloj të zbatueshme ndaj qytetarit të thjeshtë, dhe në ata të cilët punojnë në organet shtetërore. Qëllimi primar i dispozitës nga pika d., është që të operacionalizojë nenin 35 të Statutit, me të cilin anëtarët dhe anëtarët e Komisionit, si të gjithë të punësuarit, obligohen që të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave për të cilat do të kenë njohuri gjatë kohës së kryerjes së detyrës në Komision, dhe të cilat nuk i shfrytëzojnë për qëllime personale.

Paragrafi 2.

Paragrafi 2 (sanksionet për refuzimin e personi zyrtarë apo privat, për dorëzimin e dokumenteve të Kërkuara nga Komisioni, apo të burimeve tjera), ka për qëllim plotësimin e obligimit, sipas nenit 18, paragrafi 2, të Statutit, (Organet shtetërore personat tjerë juridik dhe qytetarët e palëve kontraktuese, janë të obliguar që në kërkesë të Komisionit të sjellin në shqyrtim të gjitha dokumentet apo burimet e tjera, të cilat do të mund të jenë të rëndësishë së veçantë, për realizimin e qëllimit të saj dhe detyrave të saj”).

¹⁸⁴ Gana, neni. 22, st. 1(e), Mauricius čl. 16(c); Ligji për hetimet parlamentare [Belgjika], ka hyrë në fuqi 15. maj 1880., neni. 9.

¹⁸⁵ Ligji për hetimet parlamentare [Belgjikë], neni. 9.

¹⁸⁶ Gana, neni. 22, st. 1(k), Afrika e Jugut neni. 39(h)

¹⁸⁷ Timori Lindor, neni. 39.1, Gana 19, st. 8, Afrika e Jugut neni. 39(g).

¹⁸⁸ Afrika e Jugut neni. 39, Liberia, pjesa 28, Kenia, neni. 7, st. 4, Ujdhesat Solomone, neni. 9, st. 2, Siera Leone, neni. 9, st. 2; Izrael, Ligji për komisionet hetuese, 5729-1968, ndryshimet nga viti 1972. neni. 24A.

Paragrafi 3.

Ky paragraf ka të bëjë me mospërgjigjen e personave në thirrje dhe refuzimin e personave për të dhënë deklaratë para Komisionit. Neni 17, paragrafi 6 (me të cilën udhëzon kjo dispozitë), parasheh, ndër të tjera, nëse e sheh si ët nevojshme, Komisioni mund ti propozojë gjykatës, që “në kërkesë të Komisionit, gjykata kompetente, me procedurë urgjente, të vendos për zbatimin e masave për sigurimin e prezencës së dëshmitarëve, duke përfshirë edhe caktimin e dënimeve procesuale për shkak të mospërgjigjes në ftesë të Komisionit, në përputhje me Ligjin mbi procedurën penale të shtetit në të cilin personi e ka vendqëndrimin, apo vendbanimin”. Në Serbi, Mal të Zi dhe në Kosovë, gjykata me procedurë penale mund të urdhërojë që çdo dëshmitarë i cili nuk i përgjigjet ftesës, dhe që nuk e arsyeton mungesën e tij, të silltet me dhunë, dhe krahas kësaj mund të shqiptoj edhe dënimin në të holla; në Bosnje dhe Hercegovinë, gjykata mund të shqiptojë njëjërën prej atyre dy masave, ndërsa në Kroaci vetëm mund të urdhëroj që dëshmitari të silltet me dhunë. Nëse dëshmitari vije, mirëpo pasi që iu është tërhequr vërejtja në pasojat, nuk dëshiron që pa arsye ligjore të dëshmojë, mund të dënohet me të holla në të gjitha shtetet, ndërsa në Kroaci, Mal të Zi dhe në Kosovë mundet edhe të burgoset (më së gjati një muaj në Kroaci dhe në Kosovë, gjegjësisht dy muaj në Mal të Zi.¹⁸⁹

Neni 49.

Roli i Komisionit në procedimin penal

Sqarim

Para sqarimit të nenit 49, është e dobishme të përkujtojmë dispozitat paraprake të Statutit, me të cilat përcaktohen pikat kyçe mes Komisionit dhe ligjshmërisë, apo ato pika përputhëse nuk ekzistojnë, në fakt nuk ka, por një pjesë e komunitetit juridik në territorin e palëve kontraktuese vlerëson se ka, prandaj Komisioni në bazë të kësaj merr mbi vete pushtetin ligjor prerogativ:

- Autorizimi i KOMRA-së, sipas nenit 11 të Statutit, të kërkojë dhe ta këtë bashkëpunimin e plotë të shteteve; kjo është në pajtim me të njëjtat kompetenca të zyrave të ombudspersonit dhe të komisioneve hetuese parlamentare në palët kontraktuese dhe shtetet tjera në botë, si dhe autorizimet e një numri të madh të komisioneve për të vërtetën në botë (shih Sqarimin e nenit 11.)

¹⁸⁹ Shiqo dispozitat vijuese në ligjet për procedurat penale. Zakon o krivcnom postupku, Sl. Galsnik BiH, nr.3/03, pos. izmene 15/08, nen.81; Zakon o krivcnom postupku, Sl. Galsnik Crne Gore, nr.57/2009, dhe 49/20, nen119; Zakon o kaznenom postupku, Narodne Novine Rep. Hrvatske, nr.152/08, nen.291; Ligji për procedurën penale , Gazeta Zyrtare-UNMIK, nr.2003/26 , ndryshimet dhe plotësimet Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 44/2008, nen.167, dhe Zakon o krivcnom postupku, Sl. List SRJ, nr.70/01 dhe 68/02, dhe Sl. List Rep. Srbije, nr.58/04, pos. izmene 72/09, nen108.

- Autorizimi i KOMRA-së që të „vërtetojë faktet“, kjo është në pajtim me ligjet dhe praktikat e palëve kontraktuese, si dhe me shtetet tjera, që me organe jo-gjyqësore të jepet autorizimi për vërtetimin e fakteve (shih Sqarimin e nenit 13),
- Autorizimi i KOMRA-së që të propozojë gjykatës kompetente, që me procedurë të shpejtë, të vendosë për marrjen e masave, me të cilat siguron prezencën e personit, në pajtim me ligjin për veprën penale të shtetit përkatës (shih Sqarimin e nenit 17, paragrafi 8);
- Vërtetimi; nga ana e Komisionit, që faktet e mbledhura tregojnë në ekzistimin e dyshimit serioz, se personi i caktuar ka kryer veprë të krimit të luftës gjegjësisht shkelje të rëndë të drejtave të njeriut me shfrytëzimin e këtij autorizimi Komisioni nuk e shqipton sanksionin penal – ligjor apo qytetar-ligjor, as nuk shkel supozimin për pafajësinë e dikujt (shih Sqarimin e nenit 46.)
- Gjykata; e jo komisioni; është ajo e cila e shqipton ndëshkimin (sanksionin) për personat të cilët pengojnë punën efikase të Komisionit, duke dhënë dëshmi të rrejshme, duke detyruar tjerët të japin dëshmi të rrejshme; apo të mos japin informata; duke shkatërruar dokumentet apo mjetet, duke zbuluar informatat sekrete; shqiptimi i sanksioneve në këto raste zakonisht është në veprimin e komisioneve hetuese (duke përfshi edhe në disa palë kontraktuese), edhe komisioni për të vërtetën (shih Sqarimin e nenit 48,)

KOMRA nuk është trup gjyqësor (neni 46 paragrafi 1) por komisioni ka autorizime të caktuara dhe të rëndësishme për sistemin penalo-juridik të shtetit në të cilin do të zbatohet Statuti.

Neni 49 nuk cenon pavarësinë e gjykatave, parimin të mbrojtur si me kushtetutat e palëve kontraktuese po ashtu edhe me standardet ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, Komisioni ka autorizime që të propozojë shqiptimin e dënimit më të lehtë, falje të pjesërishtme, zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, por jo që edhe vet të merr vendim për masa të tilla. Vendimin e merr gjykata.

Në të tri paragrafët nga ky nen, theksohet se lehtësimet mund të fitojë personi i cili “komunikon të dhënat e rëndësishme për zbulimin e lokalitetit me mbetje mortore të personave të humbur, ose për zbulimin e kryerësve dhe veprave tjera”. Me shprehjen “kryerësve të tjerë të mundshëm” nuk mendohet vetëm në personat tjerë përgjegjës për humbje të dhunshme, por edhe në kryerës të çfarëdo krimi të luftës ose të shkeljes së të drejtave të njeriut, nga mandati i Komisionit.

Kjo dispozitë në Statut përmban zgjidhjet të cilat kanë ngjashmëri me zgjidhjet ligjore dhe praktiken në disa palë kontraktuese, mbi privilegjet e personave për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se kanë kryer vepra penale, nëse bashkëpunojnë me organet e ndjekjes penale dhe gjykatat në zbulimin e veprave penale dhe kryesve të mundshëm. Në ligjet penale të palëve kontraktuese, është përcaktuar mundësia e lidhjes së marrëveshjes mbi fajësinë, në të cilin rast kryerësi stimulohet me shqiptimin e dënimit më të butë nëse pranon të bashkëpunojë me Prokurorinë.¹⁹⁰ Gjithashtu, neni 49 përcjellë logjikën e normave

¹⁹⁰ Dispozitat për marrëveshjen mbi pranimin e fajit janë në përmbajtjet e : ZKP BiH, nen.231; ZKP Fedarata BeH, nen.246; ZKP R. Srpske, nen. 246; ZKP Mali i Zi, nen.300; ZKP Rep. Srbije, nen.304; Ligji për organizimin e organeve

nacionale për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët në atë mënyrë që neni 47 – për dallim nga disa legjislatura nacionale në regjion – nuk parasheh mundësinë që personi kooperativ i krimit të luftës ose shkeljes së rëndë të të drejtave të njeriut të lirohet plotësisht nga përgjegjësia për kryerjen e krimit të luftës apo të shkeljes të të drejtave të njeriut. .

Me paragrafin 1 është paraparë autorizimi i Komisionit që të propozoj privilegje të caktuara në raport me personat për të cilët Komisioni gjatë punës së vet ka vërtetuar se ekzistojnë dyshimi serioz se është ka kryer krim të luftës ose shkeljes të rëndë të të drejtave të njeriut, dhe i cili është i gatshëm që ti komunikojë Komisionit informata relevante mbi mbetjet mortore të personave të zhdukur gjatë konflikteve të armatosura në hapësirat e ish RSFJ-së, ose të dhëna relevante për zbulimin e kryerësve të tjerë dhe veprave tjera. Sipas kësaj dispozite, gjykata e shtetit përkatës do të duhej të merr në shqyrtim propozimin e komisionit si rrethanë lehtësuese, dhe se një propozim të tillë ta shqyrtojë brenda kornizave të vendimmarrjes mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, duke respektuar bindjen e lirë të gjyqtarit. Vlerësimin përfundimtarë lidhur me kornizën e përcaktimit të dënimit e merr gjykata.

Dispozita e paragrafit 2 si dhe e paragrafit 3, ka të bëjë me persona të gjykuar. Personi i gjykuar, në përputhje me ligjet në shtetet në hapësirat e ish RSFJ-së, konsiderohen personat ndaj të cilëve është vërtetuar fajësia me aktgjykim të plotfuqishëm. Do të thotë, ata nuk janë personat nga paragrafi 1 për të cilët ekzistojnë indikacione se kanë kryer krim lufte ose shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Falja është në kompetencë të kryetarit/ kryesisë të vendit përkatës. Falja, shpeshherë, zbatohet si meritë dhe shpërblim për sjellje konkrete të të gjykuarit, ofrimi i të dhënave mbi mbetjet mortore të personave të humbur ose të dhënave relevante për zbulimin e kryerësve të tjerë paraqet formë të sjelljes për të cilën është e arsyeshme që të jepet falje e pjesërishtme.

Paragrafi 3 parasheh që Komisioni mund të propozoj mjete të veçanta juridike, zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit është përcaktuar në kodekset/ligjet mbi procedurën penale në Mal të Zi, Kroaci, Kosovë dhe Serbi, për rastet kur, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit lajmërohen rrethana të cilat nuk kanë qenë në kohën kur është shqiptuar aktgjykimi ose gjykata nuk ka pasur njohuri se ato kanë ekzistuar, dhe të cilat rrethana në mënyrë të dukshme do të sillnin deri të shqiptimi i dënimit më të butë.¹⁹¹ Vendimin mbi zbutjen e jashtëzakonshme e merr gjykata e caktuar me ligj.

shtetërore në veprimin për krimet e luftës, Sl. List Rep. Serbisë, nr.67/03, pos. ndryshimet 104/09, nen.13 b.; ZKP Rep. Kroacisë , nen.361, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e LPP të Kosovës, Gat. Zyrtare e Rep. Kosovës, nr.44/2008, nen.44.

Me dispozita e ligjit për procedurën penale në Mal të Zi dhe Serbi, mundësia për të lidhur një marrëveshje për pranimin e fajit ekziston vetëm nëse personi është akuzuar për vepër penale-ose për më shumë vepra penale në situatat – për të cilat e paraparë dënimi me burg në kohëzgjatje deri në dhjet vjet. Mirëpo, kur zhvillohet procedura në bzhë të Ligjit për organizimin dhe kompetencat e organeve shtetërore në procedurat për krime lufte.

¹⁹¹ Ligji për vepër penale , Sl. List SRJ, nr.70/01, dhe 68/02, Sl. G717asnik777 Rep. Srbije, nr.58/04. posl. ndryshimet 72/09, nen.415-418, Ligji për vepër penale, Sl. List C.G, nr ver. Cit.nr.57/2009 dhe 479/2010, nen. 423-426; Ligji për vepër penale, Gaz. Zyrtare UNMIK, nr. 2003/26, ndrysh. Dhe plotë. Gaz. Zyrtare e Rep. Të Kosovës, nr. 44/2008, nen.448-450, dhe Ligji për vepër penale, Nar. Novine Rep. Kroacisë, nr. 152/08, 76/09, nen.431-434

Formulimi “... nëse ajo nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës...” nga paragrafi 2 dhe 3, është përdorur duke pasur parasysh që ky Statut do të jetë i zbatuar në shtete të ndryshme sovraane, ku disa prej të cilave nuk njohin institutet e theksuara në këtë nen të Statutit, ose e kufizojnë zbatimin e tyre. Për shembull, në legjislaturën e BH nuk ekziston instituti i zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit, ndërsa sipas ligjeve të etniteteve mbi faljen në BH, falja nuk mund të jepet për vepra penale gjenocid, krime lufte dhe as për krime kundër njerëzimit.

Mund të shtrohet pyetja se a do të ishte KOMRA propozues ligjor për zbatimin e rrethanave lehtësuese (siç është në paragrafin 2 të këtij neni), falja e personave të gjykuar (siç është në paragrafin 2), ose të zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit (siç është në paragrafin 3), duke marr parasysh që ligjet ekzistuese mbi procedurën penale dhe ligjet për faljet theksojnë subjekte të tjera si propozues të autorizuar. Grupi punues për hartimin e Statutit, konsideron që një gjë e tillë është e mundshme. Me fjalë të tjera, statuti duhet ti nënshtrohet ratifikimit në parlamentet e të gjitha palëve kontraktuese.

PJESA XIII – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 50.

Përfundimi i punës së Komisionit

Sqarim

Pas publikimit të raportit përfundimtar, Komisioni që do të ndërmerr veprime të domosdoshme që në afat prej tre muajsh, dhe deri te kalimi i mandatit, distribuon dhe prezanton raportin përfundimtarë, të sistematizojë lëndën arkivore në mënyrë që të jetë e hapur për qasje pas pushimit të punës së Komisionit.¹⁹² Me rastin e sistematizimit dhe arkivimit të lëndëve Komisioni do të ketë kujdes edhe për mbrojtjen e të gjitha informatave konfidenciale. Në këtë periudhë Komisioni do të merr vendim mbi disponimin, ndarjen dhe bartjen e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe për të drejtat e mbetura dhe obligimeve të Komisionit ndaj personave të tretë. Gjithashtu Komisioni është i obliguar që të hartojë raportin e gjithëmbarshtëm financiarë, si dhe raportin për aktivitetet e veta, që përfshinë periudhën përgatitore, kohëzgjatjen e mandatit që përfshinë edhe periudhën e shpërndarjes së Komisionit. Këto raporte Komisioni ia dorëzon kryetarëve/kryesive të të gjitha palëve kontraktuese.

¹⁹² Siera Leone, nen. 19.1; Ujdh. E Solomonit, nen.19.1; Keni, nen.45.1; dhe Timori Lindorë , nen.43.1.